

## INTERVISTË ME HYSAMEDIN AZEMIN

Prishtinë | Data: 15 mars, 2022

Kohëzgjatja: 306 minuta

### Të pranishëm:

- Hysamedin Azemi (I intervistuari)
- Anita Susuri (Intervistuesja)
- Renea Begolli (Kamera)

*Simbolet e komenteve në transkriptë të komunikimi jo-verbal:*

*() - komunikim emocional*

*{ } - i intervistuari shpjegon me gjeste*

*Simbole të tjera në transkriptë:*

*[ ] - shtesë e tekstit për të lehtësuar kuptimin*

*Fusnotat janë shtesa editoriale që japin informacion mbi vendbanime, emra apo shprehje.*

## Pjesa e Parë

**Anita Susuri:** Zotri Hysamedin, nëse mundeni me u prezantu, datën e lindjes, vendin, diçka për prindërit e juaj, familjen.

**Hysamedin Azemi:** Po, faleminderit. Unë kam lindur më 15 mars, 1939, në Mitrovicë, në qendër të Mitrovicës përkaj lumit Lushta ka qenë. Tash ai lumë moti nuk shihet, se për hymje në Mitrovicë është i mbulum deri që në atë që bashkohet tona me lbrin e Sitnicës. Lumë i vogël o konë, po tana ka bo, kur binin shirat telashe të mdhaja, dike me vërshu gjysën e Mitrovicës. Qaty e kena pasë ni shpi, dy-dhomëshe me një oborr të madh. Kështu që, kur bike shi i madh edhe aty u bojke nifarë, si teren për neve fëmitë për me lujt nëpër atë ujin aty e me lozë.

Baba im është me prejardhje prej Stanoci i Epërm, qashtu quhet. Ndaji mirë [i drejtohet intervistueses] se njerëzit e përzijnë Stanocin. Stanoci i Epërm janë shqiptarët, ndërsa Stanoci i Ulët kanë rruu çerkezët. Aty janë ata çerkezë që kanë ardhë prej kur u konë Rusia Cariste dhe deri kur u bonë ato situatat që ndryshunë në Jugosllavi e Rusi e krejt. Shumica prej tyne prapë janë kthy në Rusi, një pjesë kanë mbetë në Prishtinë, do kanë shku si shumica jashtë shtetit. Kështu që, atje me sa e di unë nuk ka çerkezë mo, po janë të banumë me kushërinjtë e mi edhe nga katune tjera... se oshtë një... s'di a e dini? [i drejtohet intervistueses] Është një teren shumë i rrafshët e afër ktyne katuneve serbe, ma n'atë anë edhe Sitnica.

Baba ka qenë metë herët pa nanë, vetëm me babën. Edhe i ka pasë dy vllazën edhe e dy motra, ai ka qenë ma i madhi dhe i ka taku tona me punu me i rritë edhe ata edhe... kështu që, ai në nifarë dore ju ka bo edhe si nana e tyne. Kështu që edhe ma vonë u mësu edhe ka ditë me gatu deri te bakllavat. A nanën e kom me prejardhje prej Vushtrrisë, prej familjës Munishi. Ata janë kanë vendas të vjetër, të vjetër të Vushtrrisë. Avni dhe Alush Munishi, Alushi u konë gjyshi, a Avnija u konë daja. Janë kanë goxha mirë, janë marrë me gjo. Kanë pasë thertoren e vet, qebaptoren e vet te xhamia e tanishme, qaty o konë nifarë sokaku, kanë qebaptoren e tyne qysh para luftës.

A gjyshën e kom me prejardhje prej Shkupi, turke. Thom me qëllim këto turke se tona gjuha turke tona u folë në shpi tonë nën një, nën dy shqip. Se na me nanën folshim turqisht, me babën shqip. Nana nuk

dike mirë shqip, baba dike shumë mirë. Po, kurrë, në asnjë moment s'ka dashtë me komuniku me neve turqisht, na i folshim atij turqisht, ai neve shqip. Kështu që, kjo familje osht' e vjetër, aty diku prej Drenice, Llaushe të ardhun, po moti. Por veten e kanë... e kanë pranë edhe janë kanë shqiptarë, Drenicë mo.

Mirëpo, po e tregoj se qytetet po i tregoj Vushtrrinë, Mitrovicën, Prizrenin e këta, janë kanë qytetarë që kanë folë turqisht. Sigurisht ma të vjetrit e dijnë, s'i dini ato, gjuha turke ka qenë njëfarë kohe si tash anglishtja, o duftë me ditë edhe serbi, si serbishtja, edhe te tonë u duftë me ditë me folë turqisht. Për shembull, shumë herë i kom ni në Vushtrri apo Mitrovicë, serbi me serbin ose në Prishtinë kanë komuniku turqisht, ose kanë nisë në serbisht me komuniku e kanë kry në turqisht. Kështu që, qytetari o ditë kur flet turqisht, ai qytetar osht' qytetar. Kush nuk flet turqisht, ai është fshatar, ose siç thojmë na katunar, qyli. Kështu që, janë si dy kategori. Po flas qysh u kanë, qashtu u kanë.

Baba në fillim ka punu te gjyshi jem, te daja si kasap, aty tona e ka marrë qat' zanat. Mirëpo, u njoftu me nanën teme aty si vajza e atina. Atyne ju ka pëlqy, u kanë njeri i pashëm, shumë ma i pashëm se une. U kanë i zhvillum, i pashëm edhe ju ka pëlqy se u kanë i sinqertë, punëtor i mirë. Edhe [gjyshi] i ka pasë katër-pesë çika, ka dashtë me bo [me martu çikën me] ni njeri që në të cilin ka besim. Baba ka shku tona në Mitrovicë, u punësu në minierë xehta... nejtse si punëtor në fillim me i shty vagonat dhe aty ka mbetë deri në pension.

**Anita Susuri:** Në cilin vit u punësu?

**Hysamedin Azemi:** Baba u kanë në minierë qysh prej vitit '37-8. E tona po thom ka punu edhe gjatë Luftës [së Dytë Botërore] në minierë ka punu. Mas... dikun '46 kena kalu në Tunelin e Parë me rrnu. Tuneli i Parë u kanë hymja në zgafellë, u kanë prej Tunelit të Parë, ka hymja që tash ekziston e ma parë në Stantërg. Kështu që, këta, Mitrovica, fshatrat prej poshtit që vijnë ishin Shupkocv e Kutllocv e qekëta, ata hyjshin në minierë prej Tunelit të Parë. Ata prej Mazhiq, Bajgorë dhe këto çka janë në atë anë të katuneve që dominojnë, që shkojnë deri te Podujeva e kanë pasë [aty] hymjen me hy në minierë.

Puna e randë e xehëtarit, me ni... fëmitë... shumë kena qenë gjashtë vllazën me dy motra, na rritën... në fillim veç jena kanë katër vllazën dhe dy motra, e ma vonë nana më ka vdek shumë e re, 41 vjeçare veç. Atëhere katër-pesë fëmi, rroga e xehtarit, s'muj me thonë që jemi kanë shumë fukare, po fukarallak u kanë atëhere për të gjithë. Edhe një ndihmesë shumë e madhe ka qenë në jetën tonë se ... e një gëzim i madh që i ndërton nja katër ndërtesa, dhe sa di hala janë funksionale, me ka katër banesa. E babës tem ja dhanë ni banesë. E na për herë të parë hymë në një banesë, gëzim i madh, banesa me dy dhoma, me kuzhinë, me koridor, me ballkon, me banjo edhe nevojto brenda, që ato s'i kishim në Mitrovicë. U dufke me shku 30-40 metra në nevojto ose m'u la qaty dikun me këto pacërkva. Na ktu erdhëm, uji i nxehtë, me nevojto, me tona të mirat. Kështu që, një rilindje e krejt familjes.

Gzushëm ishim edhe mos me pasë me hangër, i kishim dy dhoma, hej dy dhoma tonat. Në Mitrovicë flejshim në një dhomë gati te tonë. Këtu dy dhoma, kuzhina edhe babën e kam pasë punëtor të madh kështu. Pos xehetarisë, u marrë edhe me... kur dikush nëpër ato katune e njihshin e thirrshin me pre kurbana për shembull, me pre te ata, për dimën me pre. Ai e kish mësua atë zanatin e tona pare s'merrke e merrke jo kokën, jo mushkënitë, jo ploncin, jo qeto sene.

Edhe diçka që na ka shpëtua shumë, kena mbajtë ka dhetë-pesëmbëdhjetë dhi të kuqe. Menjëherë prej banesës dhetë metra u konë mali, perfekt për dhi, dushkajë u kanë. Edhe interesant ata stazën e mësojshin, vetëm ju çelshmin derën asaj ku e kishin, ata dilshin vetë shkojshin tonë ditën, në mbramje u kthejshin vetë. Kajherë u hupke najnjana, po e lypshin e gjejshim, kajherë s'e gjejshim kurrë. Po ato na kanë mbajtë, se e kishim qumështin, kishim djathin i kishim ato. Edhe në dimër baba i prejke nja katër e pesë, terke mish e anej-knej. Kështu që, u kanë shumë gjindës.

Me thanë, tash vdiq edhe nana e atëherë baba s'kish mundësi edhe me punu në minierë me ndërrime edhe me na rritë. Atëhere u duhtë gjithqysh me u martu, u martu prapë me një gru prej... nga Vushtrria. Ajo ish kanë e martume, ka pasë një çikë e një djalë. Djalin e kena marrë na, me gjithë atë njerken jemi rritë. Pati fat që erdh një gru shumë e mirë, e cila neve na ka kqyrë mirë. S'ka mujtë me na zëvendësu nanën, po ishte qytetare... tash unë po thom qytetare edhe jo me thanë, po u konë. Kështu që, me te tona i kem marrë edhe dy vllazën, kështu që jena kanë gjashtë vllazën edhe dy motra. Edhe nuk u kanë lehtë në atë kohë ni xehetar tash m'i mbajtë qysh duhet.

Unë, për shembull i kom veshë [rrobat] deri e kom kry zanatin në Trepçë të vëllaut të dytë, vëllau i dytë, të parit. Kena harrnu me... po, po gjithë jena kanë të pastër, të rregullum, të kepun, qato që ka pasë nana janë kanë të pastra. Kështu që, e tash mos me e zgjatë kështu në detale. Po fillon tash viti '46-'47 kur une po shkoj në shkollën fillore në Tunelin e Parë. Tuneli i Parë u konë shkolla për krejt atë rrethinë, Kutllovci e qato katune që krejt i kanë gravitu janë kanë edhe të Tunelit të Parë jena shku në atë shkollë, ka pasë shumë nxënës. Edhe jam kanë me një klasë me vllain tri vjet më të vjetër, se lufta u kanë, ai s'u kanë [në shkollë]. Kështu që, na me një bankë. Une gjashtë vjet e ai nëntë vjet e diçka, me një klasë.

Shkollën fillore e kom kry në Tunelin e Parë, gjimnazin e ulët kom fillu e kom kry në Mitrovicë. Këtu janë tash ato situatat kur unë si dhetë vjeçar, nimdhetë vjeçar u duhke me udhëtu pesë kilometra në këmbë. Veshëmbathje kishim, por kajhere na u shpojshin ato apangat e Pirotit, e u duhke me shti edhe letra e kartona në to. Por, nuk kishte komunikacion, sidomos dy vjetë e para. Si dhetë vjeçar m'u ka deshtë me shku ka dhetë kilometra në ditje në gjimnazin e Mitrovicës, në qendër të Mitrovicës qaty u kanë, te tregu qaty u kanë. S'di a e kanë, po më duket hala ndërtesa osht'. Një klasë jena kanë shqiptarë aty prej Mitrovicë, na prej Drenice, prej Bajgore ka pasë nja dy-tre. E vetmja klasë në gjuhën shqipe qata që na ishim në qat' klasë.

Mirëpo, në gjuhën shqipe tonë edhe me arsimtarë shumë të mirë, kom kalu aty relativisht mirë. Jom konë nxënës mos me thanë shembullor po i shkëlqyeshëm kam qenë. Maturën e vogël e kom kry në Mitrovicë. Prej aty atëhere mendojsha me vazhdu gjimnazin, po situata ishte e vështirë ekonomikisht, nuk mujshëm me qëndru, se ato mas luftime menjëherë na kena rrnu me do farë bona, pika, *tačkica* [e thotë në serbisht], anej-knej, se une qe njëhere gjithë natën kom pritë për ato pikat, *tačkica* i thojshin atëhere serbisht, janë kanë si bonat e ndryshëm, ato i kena pasë me bletë e ksine, e knej edhe për ushqim. Në fillim, po flas për '45-6-7 e ato domethanë. I kom pritë tonë natën për me marrë një top të vogël kështu, e kom arritë me marrë e jam gëzu shumë.

**Anita Susuri:** Qysh kanë funksionu këto *tačkica*?

**Hysamedin Azemi:** Po ato sipas anëtarëve të familjes, tona janë konë edhe dallimet, xehetari ka pasë ma shumë... rangime, kanë qenë ato edhe për sa ke fëmijë. Unë tash shumë i vogël jam kanë po e di që i kena pasë. Janë kanë, shteti i ka caktu ato, po nuk janë kanë kush e di çka. Po ato janë marrë ma shumë për me i marrë do sene të cilat s'kemi mujt me i ble, se ka pasë shumë edhe tona mos me u pasunu dikush anej-knej, se u tutshim atëhere, ka mujt me marrë veç ai që i ka ato bonat. Mirëpo, ajo s'ka zgjatë shumë, po, po tregoj fillimin qysh ka qenë.

**Anita Susuri:** Zotëri Hysamedin, po du me u kthy edhe te baba i juj edhe te puna e Trepçës, se e përmendët për robërit që kanë qenë, në atë kohë kanë punu në Mitrovicë, në Trepçe.

**Hysamedin Azemi:** Po, në fillim kanë punu kryesisht robtë e gjermantë, na i thirshëm atëherë në fëmini llogorasha se ish llogori aty. E aty në fillim ka pasë shumë pak shqiptarë edhe ata që kanë luftu, do janë shpërngulë, do anej e knej. A mas luftime ka pasë, po jo shumë, do janë kanë të ardhun. Pastaj kanë ardhë prej Bosnje, ma së shumti boshnjakë edhe prej Serbie ka pasë, e Malit të Zi. E situata u kanë shumë ma e randë në minierë, kushtet e punës janë kanë të mjershme, tash është lule... as tash s'ka përparu Trepça aq shumë, po atëherë ka pasë shumë shpesh fatkeqësi, se s'kanë pasë mjete, s'kanë pasë eksperiencia, shembje të minierës.

Edhe çka më ka mbetë përshtypje të cilën... do t'ju përsërisë edhe prapë edhe më vonë, se kam pasë edhe ma vonë me dikë tjetër po që vyen pos juve me ju tregu, se u kanë ajo sirena për alarm, e alarmi në Trepçe kur ndodhke diçka ai alarmi aq bojke si me qajtë *au-au-au* {përshkruan me dorë ritmin e alarmit}, kur bojke ashtu na e dijshim që ka ndodhë naj fatkeqësi në minierë edhe krejt na me nanë e me babë për dorë shkojshëm e dilshim para zgafellës. Mbas një kohe... janë kanë do vagona, janë kanë vetëm me katër shtylla kështu e me dërrasa kështu {përshkruan formën e vagonetës} ku u bajtë materiali, qaty në dërrasa dilke dikush i vdekun, tjetri.

E tash ma vonë e kom përdorë këtë bisedë, do të përsërisë ma vonë krejt. Atëhere, për shembull, unë u gëzohsha se s'ish baba im, shoku jem kajke se ish i tina. Kështu që, u kanë një jetë shumë e randë atëhere, shumë e randë. Domethanë, kushtet janë kanë shumë të vështira, me ndërrime, me tri

ndërrime, fukarallëk mos me mujt. Baba edhe ngjinojke edhe shkojke në ndërrimin e tretë. U kanë një situatë shumë e vështirë, shumë e vështirë edhe punë shumë e randë që hala vazhdon me kanë gjithë miniera si minierë. Mirëpo, u kanë shumë e randë se s'kanë pasë as eksperiencë, s'kanë pasë as inxhiniera, s'kanë pasë as njerëz të fushës xehetarisë. A kushtet janë kanë minimale edhe shumë... vdiq, shkoi edhe u kry puna.

**Anita Susuri:** A ju kujtohet juve ato objektet që i kanë lanë anglezët atje në Staritërg? Për shembull, thojnë se ka pasë pishina, ka pasë...?

**Hysamedin Azemi:** Po, si jo. Staritërgu atëhere u kanë ma mirë se Staritërgu se... edhe në Mitrovicë. Aty ku bile i kanë pasë klubet, Domin e Kulturës, pishinën, dyqane kanë pasë, u kanë shumë ato... shumë i zhvillum për atë kohë. Kështu që, na kena shku, shpesh kena shku atje me u la në bazenin e tyne edhe Staritërgut edhe jo vetëm për atë, por edhe për gjithçka. U kanë si një qytet, sado kudo xehtarë unë, po qato e kanë pasë rrogat, i kanë pasë gjithçka, për dallim prej tjerve që s'ka pasë kurgjo, në katun do tokë e diçka. A xehetaët prapë se prapë e kanë pasë një nivel pak më të madh e më të rujtun. Ato janë s'di tash qysh... ato une, sa e di une janë shkatërru krejt. Jo vetëm se janë kanë ndërtesa të mira për banim, shumë banesa të mira, komfore e edhe jo një banesë, ka qenë krejt ai shpati atje nalt i ndërtum enkas për xehtarë. Ndërtesa, Domi i Kulturës, kinemaja, e çka s'kanë pasë.

**Anita Susuri:** E këto llogoret që po thuni të robëve, ku kanë qenë ato të vendosura?

**Hysamedin Azemi:** Llogori u kanë në Tunelin e Parë...

**Anita Susuri:** A ka qenë si hapësirë përskaaj rrugës?

**Hysamedin Azemi:** Do farë, të rrethume me tela janë kanë do farë baraka të drunit si ku kanë me nejt robët në qato kushte.

**Anita Susuri:** Ju na tregutë edhe një storie për një rob që ka qenë si shok.

**Hysamedin Azemi:** Po, ishte... mes tyre ishte një 20 vjeçar a diçka. Tash e mbaj mend qysh e ka emrin, Bubi e kish emrin ai, e thirrshin Bubi. Ai i ri, fëmijë edhe ai 20 vjeç, e u shoqnosha qaty ku ishin të lirë. S'janë kanë të rujtun robtë kështu me pranga me këto, kishin dy-tre roje, por qaty tona lujsim futboll. E kishin ba ata aty një fushë e lujsin, e tona na si fëmijë të vegjël u shlirojshim qaty me lujt me ta. E lujsim me ta futboll, e ai kishte qejf... edhe ai me u ba i ri si fëmijë edhe na pëlqejke te tonëve edhe kur pat shku mbas disa vjetëve e kena pëcjellë te tonë, e dojsim.

**Anita Susuri:** A kanë shku krejt, çka ka ndodhë me ata, a e dini?

**Hysamedin Azemi:** Po une i vogël jam, veç sa e di une mas disa vjetve ata janë liru e janë kthy në

Gjermani. Çka po di unë, nuk dihet, nuk dihet.

**Anita Susuri:** Tregutë që keni shku në Mitrovicë në gjimnaz për me vazhdu shkollimin, qysh ka qenë Mitrovica në atë kohë? Qyteti, po edhe jeta kulturore për shembull?

**Hysamedin Azemi:** Qato disa vjet Mitrovica u kanë një qytet pak më i zhvillim se krejt qytetet tjera. Jo najfarë ndërtimi, por ka pasë një jetë më të mirë, u kanë Trepça e minatorët. Sa i përket jetës kulturore bash qato tre-katër vjet s'ka pasë naj diçka u kanë krejt fillimi. Na ja nisëm klasat e para me... fillimë me mësu shqip, se krejt shkollat e mesme, teknike krejt u kryen serbisht. Edhe une tana ma vonë kur e kom kry zanantin, serbisht e kam kry, shqip s'ka pasë. Kështu që, jeta kulturore, artistike, veç fillimi u kanë. Mirëpo, ka pasë një fillim. Për fat të mirë, Mitrovica tana filloi m'u zhvillu shpejt, e kish pozitën shumë të mirë me dy lumenjë, Ibri i Sitnicës, jo e degradume si tash. Përskej Sitnicës janë kanë bahçet e mëdhaja, gjysa e Mitrovicës kanë vnu kosh, që "Kimija" qaty që është, qaty janë kanë krejt bahçet deri ngjitë rrugës për Vushtrri janë kanë bahçet që ujitshin me ujë të Sitnicës, qashtu edhe Ibri. Kështu, për qat fillim s'ka pasë diçka që une, njeri me u lavdëru. U kanë një fillim i mirë, ai sidomos me shkollim, kulturë, aty nëpër darsma aty diçka kanga edhe valle e qeshtu.

**Anita Susuri:** Ura e Ibrit, a ju kujtohet a ka qenë me hekura në atë kohë? A ka qenë me dru nuk e di po më duket kështu ma herët ka qenë.

**Hysamedin Azemi:** Vallahi sa e di e hekrit u kanë, s'po jam i sigurtë shumë, shumë kohë ka kalu.

**Anita Susuri:** Qysh ka vazhdu pastaj ajo pas gjimnazit?

**Hysamedin Azemi:** Po qe mbasi baba, vëllau i madh e, ishin në zanat hekur-gdhendës e ky që ke me mu në fillore mësojke për automekanik, baba mendojke që edhe kish qejf me më shkollu se më shkojke shkolla mirë, "Po mendoj", tha, "ma mirë është me e kry një zanat se zanati nuk të lenë kurrë pa bukë, çfarëdo ndryshimi me u ba në jetë, e luftë e, çka të bahet, zanati", tha, "milioner s'bahesh kurrë, po jetën mundesh me siguru me zanat". Meqenëse edhe gjendja familjare ishte e nevojshme se ishim shumë, e një rrogë e xehëtarit atëhere u solidarizova me babën dhe shkova në Zveçan për... e regjistrova për elektromekanik.

Aty shkolla ishte në gjuhën serbe, mirëpo për mu nuk kish problem se na të qytetit e flisnim serbishten te tonë, sidomos në Tunelin e Parë. Në shtëpi folsha turqisht me nanën, me babën shqip, si dalsha në rrugë serbisht. Atëherë dominojshin këta boshnjakët e serbët, ishin ardhë aty që banojshin në Tunel, se shqiptarët kryesisht ishin nëpër shtëpia të veta nëpër katun kështu. Bash xehetarë shqiptarë pak janë kanë, baba jem edhe nashta dhetë vetë që kanë rruu aty. Ma vonë kanë dominu shqiptarët, por në fillim po flas.

Atëhere nuk kisha problem, por e mbaj mend që kanë pasë problem do që erdhën prej Drenice, prej Bajgore aty, ose prej Mitrovice... prej rrethine të Mitrovicës e Vushtrisë, që nuk dishin serbisht. E patën probleme tona me mësu zanatin. E kjo shkollë u kanë një prej ma të fortave të zanatit në Jugosllavi. Bori i Serbisë ka qenë edhe në Mitrovicë Zveçani, ku na kena shku një ditë tetë orë mësim, ditën e dytë tetë orë kena punu me mjeshtër tonë nëpër... në pjesët e Trepçës, nëpër kantiere të ndryshme e kena përvetsu zanatin. Kështu që, na çdo vit jena kanë një ditë në shkollë, tetë ditë... tetë orë shkollë, tetë orë msim.

Kështu që, na nuk dulëm nxansat si edhe ma vonë, se edhe krejt ma vonë edhe tash e kryjnë teknikën, elektroteknikën, po teoritë nashta i kanë mësu po praktikë haber s'kanë. S'dijnë nashta me i lidhë dy poça anej-knej, nashta po e teproj, po praktikë s'kanë pasë. A na kur e kena kry zanatin, kena diplomu, na jena kanë menjihërë mjeshtër të gatshëm. Kena mujt me punu menjihërë ku të dojmë në Jugosllavi që ki kry në Zveçan, a në Bor, ke pasë punë. Mandej, tona qaty... tona une kam lujtë edhe futboll, jom konë për ekipën e të rinjëve të Trepçës. Në atë kohë Trepça u kanë shumë ekipë e fort atëhere e futbollit, kështu që edhe futboll kom lujtë.

Kur e kryva zanatin, domethanë kena pasë vështirësi por e kom kry zanatin. Kom pasë vështirësi për rrugëtim se tana mu m'u shtynë edhe tre kilometra, pesë deri në Mitrovicë, tre deri në Zveçan, udhëtojsha tetë deri dhetë kilometra përditë. Edhe në fillim ato i kena pasë kamiona e tona në atë kamion i kanë qitë këto ulëset e dërrasës, e në ato ulëse u ulshim për me udhëtu për Mitrovicë. Ma vonë u banë do autobusa, do anej-knej. Po 14-15 vjeç me udhëtu përditë ka nëntë kilometra, e nëntë ka tetëmbëdhjetë e njëzetë kilometra e kom pasë vështirë.

**Anita Susuri:** E për Trepçën që thatë që keni lujt futboll, a e ka pasë klubin e vet, qet klub që e ka edhe tash?

**Hysamedin Azemi:** Jo, atëhere o thirrë "Trepça", vetëm "Trepça", këto klube ma vonë. '89-shi u ba kur, kur une kesh (qesh) i kërkum. Atëhere zanatin e kryva me 1958, e në "Trepçe" nuk m'u dok shumë interesant, sidomos që nuk mujsha me u inkuadru në skuadrën e parë të "Trepçës" që ish shumë e fortë. Lujshin emrat e mdhejë të futbollit të Kosovës edhe nejse ma me u profesionalizu i morrën nja dy-tre lojtarë të Rjekës edhe një portier s'e di prej kahit, u përforcunë. Kështu që, une më erdh një kontakt me "Rudnikun" e Hajvalisë, u quajt klubi futbollistik i Hajvalisë u konë "Rudniku", ka qenë edhe një vjet kampion atëhere.

Kështu që, ata më thirrën prej atjehit më thanë, "A don me ardhë me lujt? E ki punën e sigurume, banim, banimin edhe krejt". Mu m'u dok jo si me thanë, çka me nejt tash aty kur s'e di a muj me hy në ekip apo jo. I ri isha po ata ishin dorën në zemër shumë lojtarë të mirë "Trepça". Atëhere u transferova me nja dy shokë, shkumë në Hajvali. Aty u punësova, nisi, nisa të luj aty edhe futboll, edhe u nisa... para meje janë kanë i kom zatetë une vetëm nja dy-tre javë nja dy vllazën, Siçani e kanë pasë mbiemrin, po më doket të Prishtinës që ishin shpërngulë për Turqi. I vetmi shqiptar kam qenë që kom



lujtë futboll aty. E aty miniera e re, kushtet ishin shumë të mira, rrogat ishin ma të mira se atje se s'kishin kuadra.

Prej futbollit s'kam pasë naj interes, po qaty si në do dreka, do darka, do udhëtime anej-knej dishka. Po, isha lojtar i mirë, jo i shkëlqyshëm, ka pasë edhe ma të mirë se une. Po, aty nisa me lujt futboll edhe me punu si elekticist i minierës, qashtu serbisht që i thojshin *rudarski električar*. Kështu që, unë hysha në zgafellë me xehetarë, punojsha brenda, ju ndihmojsha, ata kushtet shumë të randa. Tona i kam pa edhe une vetë për atë pyetje që më thatë, “Me çfarë kushte ke punu?” Une u duhke kajhere me shku zhagas kështu deri te minatori, për me ja rregullu naj pajisje që kish për xehe edhe kur vijsha te ai nuk e njofsha kush është se krejt me xehe ftyra e këto. Edhe teshat tona janë kanë të zhyta, ato na i varshim aty kur dilshim edhe pa u la, s'kem ujë me u la veç.

Une nuk e njofsha, ai thojke, “Huqko”. Mu më kanë thirrë, Hysko, Huqko ma shkurt, “Hajde se marova prej ventillatorit”, kur vijsha nuk e njofsha, veç e fshijke, me dorë veç e hjeke prej syve, e hjeke xehen edhe tona ja shihsha sytë kush është. Me vagona krejt me, s'kanë pasë ato me tërhjekë me... krejt me tu i shty anej-knej. Mirëpo, gjithë kur ja kryjsha atë punë, ai me faleminderime të mëdhaja. A une s'rrisha rahat gjithë i shtyjsha me ata edhe vagonat e këto, se u kanë një shoqni e madhe. Xehetarët e kanë pasë një që “Me fat!” aty shkrun në hymje, edhe janë kanë shumë solidarë, shumë për njani-tjetrin. Janë kanë në gjendje... te tonë, për shembull u bahke naj rast shembje, vdekje e naj xehetarit, asnjani na s'dalshim pa e gjetë, a pa e...

Ose edhe ma vonë krejt e ndjeshim secili thu ti që të ka vdekë dikush naj vëlla, naj babë anej-knej. Shumë një lidhshmëri e madhe u kanë, pa lidhje [bazë] në nacionalitet. Xehetarët janë kanë shumë, shumë solidarë, e kushtet shumë të randa, shumë të randa, që po thom nuk e njifshe njerin kush është, vetëm zanin me ja ni. Mirëpo, aty nuk... nuk kesh aty se tona banojsha aty, menihere na dhanë banesën, ka dy vetë nga një dhomë, ata i kanë maru tona për të vetmit, banojsha me ni shok. Erdh koha lujta pak futboll aty, e kom pasë një aksident se ne lujtëm bashkë me “Vllaznimin” e Gjakovës, atje vëllezërit gjakovarë ma thynë kamën qetu në zog {tregon vendin me dorë}, jo mbi zog. Edhe tona nja ni mujë a dy gati kom pauzu. Mandej erdh koha për me shku në ushtri.

## Pjesa e Dytë

**Anita Susuri:** Në cilin vit keni shku në ushtri?

**Hysamedin Azemi:** E...

**Anita Susuri:** Nashta në '60-tat?

**Hysamedin Azemi:** Për... '60-tën.

**Anita Susuri:** Ku keni qenë në ushtri?

**Hysamedin Azemi:** Domethanë, atëherë u kanë dikush shkojke sipas mbajtjes të familjes, dikush ma shkurt, dikush ma gjatë, une jam shku me 6... '59-tën deri dy vjet, pa 45 ditë. Në Sentë kam shku ma së pari, atje ish edhe ma vonë kam pa kur jom shpërngulë në tjetër garnizon, më besoni që nja gjashtë... 60-70, 60 përqind sigurisht shqiptarë ushtarë. Kështu që, në atë kohë shumica e ushtrisë ka dominu shqiptarët, si të rinjët, si... po unë s'di qysh po thu ti që jena popullata ma e madhe në Jugosllavi, qaq shumë ushtarë ka pasë. Aty kam qenë veç nja ni mujë e diçka, nja ni mujë e gjysë, u kanë njësia për minime e për këto ku kom shku.

Mirëpo, du me ju tregu një ngjarje e cila tash kush e di prej distance nuk dihet, atëhere e kish gjendjen shumë të keqe Jugosllavia me Rusinë ajo në informbyro<sup>1</sup>, e ato. Edhe kishin vrasje të ushtarëve, në rojen e ushtarëve u banë disa, nja dy-tri vrasje. A na kur dalshim në qytet, u duh... dilshim me ato bajonetat që i kena pasë edhe s'kena guxu me nejt në qytet para natës, si... shkurt, para se me ja nisë nata u duhke me u kthy në garnizon. Aty kom qenë tona nja ni mujë në njësinë e rojeve. Interesant, na as s'u tutshim si shqiptarana, as nuk ndodhi [më ndonjë vrasje]. Barem deri sa kesh une, kur nisëm vetëm na shqiptarët, veç neve shqiptarëve na çojshin në roje, nuk ndodhi ma asnji vrasje. A ishim të zgjutë, a dishin ata që u banë naj ndryshim a? Nuk e di! Gjithëkund i kanë pasë ato informatat, e kanë ditë kush o roje e anej-knej, a këta që u vrajshin a i nxajshin në gjumë, a s'di çka? Por, në qat' mujë që kesh une nuk ka pasë asnji vrasje.

Për fatin tem, mas ni mujë e gjysme u tubumë atje në atë, na tubunë, komandanti tha, "A ka kush këtu naj zanatli, naj elektrikist diçka?" Une e çoj dorën, "Une". U lajmrova. Tha, "Hajde në zyre te une. A ka edhe najnjo edhe najnjo? S'ka". Kur shkova në zyre po më vetë, "Ku je, prej kahit je?" Po i tregoj. Ai e dike, mirëpo dojke me ni, se e kishin krejt informatat kush je, çka je. Tash foli une, "Djali i xehetarit, e kom kry zanatin në Trepçe. Jam elektrikist i diplomum, kom punu në minierën e Kishnicës te Prishtina". "Domethanë, ti koke mjeshtër?" Thashë, "Valla ish duftë me kanë". Tha, "A ke qejf me shku dikun tjetër edhe si ushtar, por edhe me punu këtë punën tane?" Thashë, "Po, qysh jo, siguri... sidomos kisha pasë qejf" thashë, "ku ka liga e parë e futbollit e me kqyrë lojë e futbollit". "Eh", tha, "bash qatje po shkon", tha, "shkon për Novi Sad".

Meniherë të nesrit, qysh ata ti jepshin qato teshat anej, ta jepshin biletën e për me nxjerr biletën, ta jepshin ushqimin për një ditë a dy ditë, edhe u bajshe shkojshe me u lajmru atje. Shkova në Novi Sad u lajmrova, ata më çunë në skaj të Danubit u konë te Petrovaradini quhet vendi, cila pjesë e Novi Sadit është po qatje është kalaja e Petrovaradinit. Danubi i ndanë, veç ura aty e Danubit. E aty ish një punëtori e madhe e garnizonit për mirëmbajtjen e kerreve të ndryshme të garnizonit të Novi Sadit, i cili për... shumë i madh edhe gjysa garnizonit tona këtu, gjysa ishin shqiptarë... une s'di prej kahit janë kanë gjithë ata shqipëtarë, shumë ushtarë shqiptarë.

<sup>1</sup> Byroja e Informacionit, qëndron për Byronë e Informacionit të Partive Komuniste dhe të Punëtorëve, forumi ndërkombëtar i lëvizjes Komuniste i themeluar në vitin 1947. Pas dëbimit të Partisë Komuniste të Jugosllavisë nga Kominformi në vitin 1948, ata që dyshoheshin për simpati ndaj Moskës u ndoqën pelanisht si Kominformistë.

Fati jem meniherë të nesrit m'i dhanë teshat ndryshe anej-knej që ata i kishin marrë këpucët me ato goma... me hekra, s'i dini ju [i drejtohet intervistueses]. Këpucët i kanë pasë si thuma, krejt këpuca e ushtarit u kanë me thuma e mbulume që mos e u prish e që me thurë shumë. E tona aty i mora këpucët me gomë, që une u gëzova vallahi për to, se si elektrikist atje nuk bojke me ata të hekrit *tak e tak e tak* {onomatope}. Si mathja e kalit por me thuma të vegjël por krejt të qitne në këpucë, si tash me pa. Ajo ma nuk ekziston sigurisht, ndonjë muze ndoshta e ka asi këpuce.

Kështu që, m'u plotësu dëshira, bojsha atë fiskullturën e mëngjesit edhe qato që kishim na orën politike çdo mëngjes si ushtar, gjendja anej-knej edhe shkojsha. Punëtorja ishte krejt afër aty, punojsha tetë orë me atë... mjeshtri ishte civil, punojsha me to. Ai kur u shoqnu mirë kajherë shtune e dille më thirrke te ai i ndihmojsha privatisht pak, e ai më jepke pak do pare, drekë të mirë e këto. Shkojsha me kqyrë këtë futbollin, ligën e parë Vojvodinën, në ligë të dytë ish Novi Sadi. Kështu që, gjithë kisha loja. Këtu vetë lujsha për garnizonin e... se u kanë garnizoni i fortë i Novi Sadit, e aty kanë lujtë edhe disa lojtarë të ligës së parë. Se i kishte mangat Beogradit e tona i çojshin aty në Novi Sad.

Lujshim me do ekipe të fshatrave anej e knej shkojshim, kur shkojshim atje ai çdo lojtarë e merrke... i venit e merrke një ushtar me veti, ishim mysafirë të tyne, na bajshin muhabet. Atëhere, sidomos Vojvodina u kanë shumë pozitive ndaj ushtarëve e neve, s'kanë bo dallime se ata janë kanë pasardhësit e gjermanëve aty edhe një popull krejt tjetër edhe sot ashtë Vojvodina krejt diçka tjetër. Serbia është Serbi, a Vojvodina, se ata edhe vehten e njohin ma serbë me të kalumën sesa serbët, edhe s'i pranojnë serbët që janë më autoktonë se ata. Janë shumë popull i shkollum, i edukum edhe tash e kanë zhvillimin shumë të mirë.

Kështu që, gati... domethanë 21 mujë e gjysë kesh ushtar në Novi Sad. Kalova mirë, falë asaj që i thojsha edhe babës, "Shyqyr që më ktheve me e marrë zanatin", se me naj profil tjetër isha mbetë atje në Sentë". E kom kalu shumë mirë, më dojshin, jom kanë shumë komunikativ edhe në ushtri, te tanë shoqnia më kanë dashtë. Kështu që kaloi, dy vjeç gati edhe u ktheva në Kosovë.

**Anita Susuri:** E në atë kohë qysh keni udhëtu, për shembull deri në Kosovë, a ka qenë treni apo ka qenë... ka pasë autobusa?

**Hysamedin Azemi:** Jo, treni.

**Anita Susuri:** Qysh ka qenë treni, për shembull i asaj kohës?

**Hysamedin Azemi:** Po, varet. U kanë klasa e parë e klasa e dytë (qesh). Klasa e dytë janë kanë vagonat qeshtu me ulëse të drunit e me këto. Shpejtësia s'janë kanë të mëdhaja po ka qenë linja goxha e rregullt Kosovë, tona Beograd e në atë anë, se ka qenë edhe treni i shpejtë që u thirrke i cili shkojke prej Budapest, Novi Sad, Beograd edhe u qujke treni i shpejtë, *brzi voz* [Srb.: treni i shpejt] i thojshin ata. Kështu që, treni u kanë goxha i rregullum, se tona shkojke për Kosovë, Fushë-Kosovë, Shkup e më tutje. Kështu që, mirë, për atë kohë ka qenë mirë. Por u udhëtu shumë, ka tetë orë, dhetë orë, dymdhetë orë. Prej Novi Sadi me ardhë une qashtu m'u ka duftë ka dymdhetë-tremdhetë orë.

E kom një periudhë kur nuk shkova në “Hajvali” edhe pse më thirrën, por prapë me ftesën e Klubit Futbollistik të Obiliqit u thirrke klubi i... si tash si “Kosova” që është e ka pasë klubin, po është thirrë “Obiliq”. Ajo ishte një skuadër bukur e mirë, u konë jo si “Prishtina” ka katër-pesë klube, por qaty në mesin e këtyre klubeve si klub goxha i fortë. Domethanë, qetu në mes tabele e kish rendin gjithë edhe pak kajherë ma nalt, kajhere më poshtë. E më thirrën me lujtë edhe me u inkuadru në [Bashkësinë] Elektro-ekonominë e Kosovës e cila ishte formu për ndërtimin e termocentraleve e këto. Ajo e kishte vetëm një minierë të qymyrit, këtu në katunin e parë qetu te elektranat që është, s’po më bjen në mend tash.

Aty ishte miniera, por Elektro-ekonomia, termocentralet, ndërmarrja ish formu për investimet për ndërtim të elektranave. Atëhere ata më punësun mu aty, këta të klubit, isha punëtori me numër tremdhetë. Ishin aty krejt ara, livadhe, misri, temelet i hapshim të elektranave edhe pjekshim misër. Eh, filloi ndërtimi, bukur mirë shkojke, kish pare atëhere të sigurume, edhe këto ishin do firma kroate të ardhun, ndërtimtari me këto nga Ramiz Sadiku i jonë ka marrë pjesë shumë, sidomos tymëtarët ata, e të tjerë kanë punu. Na disa që ishim punësu aty, menjëherë u inkuadruam në ekipe që montojshin. Në elektranat e para që u ndërtun me elektranat numër 1, 65 megavatsh.

Stabilimentet elektrike të parët janë kanë në Kosovë me tension të lartë me 110 kilovolt edhe largpërçuesit e lidhur tona ma vonë prej aty me Mal të Zi, me Serbi, domethanë me Mal të Zi e me Serbi edhe për Kosovën, edhe me Maqedoni. Ça... kujtimi im më i mirë është që qato stabilimente me do punëtorë e kom udhëheqë edhe e kom montu krejt une, nën udhëheqjen time. Nji prej problemeve u konë që lidhjet që u bojke prej ndëpresërit deri te rindarësi që e ndanë rrymën, u duhtë me e qitë me aq preciz që gati me centimetra. E lidhke ai, ai i huaji si u kanë ato prodhimet zvicrrane e nalt edhe poshtë, edhe ja bojke një gjysëm-hark që me pasë elasticitet që kur e çelën që mos me u këput qeto, se tensioni ishte 110 kilovat.

I hupa une nja njëqind metra, qesi teli s’mujsha me ja qëllu, s’dijsha qysh me e ba. Një punëtor i thjeshtë më mësoi. Tha, “Hysamedin, lidhe, mate” tha, “sa duhet. Lidhe”, tha, “këtu e këtu e merre” tha, “prej kakisë, a prej bërlllogut atë... preje një copë drunit edhe me to”, tha, “munesh me e bo qysh të dush”. Edhe tu e faleminderu atina, une nisa me atë *tak, tak, tak, tak* {onomatope}. Kur erdh ai zvicerrani po kqyrë, “Kush i bani këto?” I thashë, “Une”. “Qysh?” I thashë, “E kam mjeshttrinë, e kom qe aletin këtu”, tha, “Vazhdo!” E vazhdova deri që u kry stabilimenti, se në mbikqyrjen e të huajve krejt. Por, une me duartë e mia me shokët e mi e kena montu krejt qato.

Kjo si është si kuriozitet po tregoj, por u zhvillu, u ndërtu elektrana, nonstop merrsha pjesë në to. U ba, filloi me punu elektrana e parë me 65 megavat. Ma së pari kesh si elektricist kujdestar me ndërrime, punojsha me tri ndërrime. Për çdo prishje që kishte diçka më thirrshin, përndryshe s’kisha naj punë shumë fizike, po sidomos ndërrimi i tretë. E sa i përket kuadrave është intersant me tregu, i vetmi shqipëtar elektricist jam kanë une qatëhere në fillim të elektraneve po flas. Edhe u kanë një turbinist i cili ka ardhë prej Bosnje, atje ai kish punue e tona kur fillunë elektrari u kanë prej këtyre katuneve të

Obiliqit edhe ai u kanë edhe e kena pasë një inxhinier të diplomum, ja kom harru emrin valla, u kanë edhe profesor. Tre shqiptarë, asnjë tjetër. Krejt, punëtorë fizikë kështu sa të duash, po këta që ishin me zanat, që punojshin turbina, që punojshin në stabilemente elektrike, vetëm unë, ai si turbinist.

Mirëpo, shpejt, shpejt ma vonë tana nisën me ardhë kuadra e sidomos ju ka pa hajri qe qendra e Obiliqit, shkolla që e formoi Elektro-ekonomia si të veten edhe aty tana u shkolloshin tana profilet elektriciist, agjistrator, bageristat, krejt i kena pasë na na shkolla, e cila u financojke prej Elektro-ekonomisë. Atëhere ia nisën me u ba kuadrat e reja, nisi kadaldalë mas Elektro-ekonomia ka dhanë bursa ka dy-tre mijë i kena dhanë. Edhe i kena dhanë bursa për gjuhën shqipe, s'kena kqyrë, se na vijshin. E kryjke e bajshim përkthyes hajt, veç me marrë se kishim pare boll, elektrana për atëhere rrijke mirë edhe na vyjshin, e bomë... kështu që edhe ma vonë edhe ma shumë u zhvillu.

Mirëpo, une isha i intersum jo veç qaty si kujdestar elektrik, por dojsa edhe punë tjera me punu. Edhe punova tona edhe në... si laborator ka qenë për tensionin e ulët për... me stabilimentet e ulëta të cilat punojshin elektranet. E aty tana jom kanë në specializim në Frankfurt në fabrikë, gjashtë mujë kom qenë atje në specializim, vetë i treti.

**Anita Susuri:** Në cilin vit?

**Hysamedin Susuri:** Ajo është viti '63. Atje tona jo fabrika Hartmann and Braun u quhke, s'di sigurisht ekziston, ato ishin stabilimentet e krejt që i kishim, ishin stabilimentet prej qasaj fabrike. Kështu që, ato, bashkë me shumë shokë e me ta edhe me durë të mija i kam montu. Atje tona i pash edhe qysh prodhohen edhe aty tona një problem të vogël e kena me pasë me, me punëtorët që punojshin e që ishin prej Jugosllavie, shqiptarë s'pat po kish kroatë, e serbë, e s'di. Na tre e kishim një inxhinier edhe na ishim dy si elektriciista, e tona pjesën elektrike që e montojshin na e ndamë në tri pjesë, "Unë këto, ti këto", ai inxhinieri në fund i lidhke edhe i kontrollojke. E ata i bajshin disa ormana, si ormana veç mrena me pajisje elektrike. Ata i bajshin dy-tre, na i bajshim pesë a gjashtë.

E na aty s'kishim naj... na i kishim meditet e tona, nuk kishim rroga aty as kurgjo, na jepshin do pare kiske njëfarë xheparaci [Srb.: pare xhepi] kështu, po na kurrfarë levërdije s'kishim, pos që e mësojshim zanatin, nuk kishim të pagueme aty, a këta me normë ishin. Po më afohen një ditë një sindikatë e tyne, po thotë, "Kolega bre", thotë, "šta radite?" Thashë, "Edhe une jam sindikalist atje në [Bashkësinë] Elektro-ekonomi". "Ti", tha, "po e dini çka po na boni?" Thashë, "Jo". Tha, "Do të na leni pa punë". "Çka është problemi?" Tha, "Edhe na mundemi me i bo ka katër a pesë sikur ju, po na duhet me punu kush e di me vjet këtu. Ju", tha, "e kryni këtu e shkoni, po nalne", tha, "pak dorën në qoftëse bon". Thashë, "Po more". E nisëm tona na e zvogëlum ritmin e nuk i bojshim pesë a gjashtë, i bojshim sa ata edhe ma pak, se patëm me i marrë në qafë njerëzit, se ishim ma eksperta se ata edhe e dijsim organizimin.

U ktheva prej Frankfurtit pas gjashtë mujve. Atëhere vazhdova prapë në këtë zanatin tem, po tona shkova për... isha në komandën elektrike. Ku komanda e rretës u qujke, aty ku shpërndahet energjia, aty edhe si dispeqer edhe si komandojsa kur me hy elektrana e kur me dalë, me kyç një largpëçues

për Shkup, a për knej a... këtu me kyçje me çkyçje, u kanë shumë vend i ndishëm edhe më thanë që me kalu aty me punu. Kalova aty edhe e udhëheqsha rrjetin edhe kisha kontakt me dispeqingun e Beogradit, Malit të Zi, Maqedonisë. E komunikojshim kur me hy, që u duhke me hy e me dalë e, me rritë tensionin, me zvogëlu, krejt ato u duhke ato aparatet, çdo orë u duhke me marrë gjendjen, veç kur tu punë në karrigë, punë kështu me mençuri me punu se rreziku është, lujshë me tensionet 110 kilovolte, kyçje, çkyçje.

Atëhere ma zor ishte ndërrimi i tretë, ka ora tre-katër, qatëhere guri flen, më merrke gjumi, po mos me fjetë mujshë me fjetë sa të dush, po me ndohë diçka naj kyçje, çkyçje ose u duhke me marrë edhe gjendjen çdo orë, goxha punë e randë se për shkak të ndrrimeve, me tri ndërrime kur punojsha. Prej aty tona, une isha goxha revolucionar gjithë. Më zgjedhën për kryetar të Sindikatit për Elektriko-ekonomi, i pagum me rrogë, edhe aty kam qenë gati dy vjetë kryetar i Odës edhe asi... Sindikatit. E më dojshin punëtorja se une jam kanë, s'jam tutë me i thanë edhe drejtorit edhe kujna çka kom mendu. A, në futboll vazhdova me lujtë për "Obiliqin" edhe disa vjet. Edhe aty kesh si ju thashë i vetmi shqiptar. Ka qenë njëfarë Hashani portier, po vetëm shkaqe tona ka lujtë u kanë portier tona i "Prishtinës".

Mirëpo, erdh koha pak edhe me... jo martesa, jo kjo edhe e lash futbollin. Me '74 u martova me një mësuese të Trepçës qatje, vajza edhe ajo babën e ka pasë mësues. Ai ka qenë mësuesi i parë në Bajgorë atje baba i saj, Ibrahim Koka, kjo Drita Koka ka qenë, kjo bashkëshortja jeme. Këta janë familje e cila janë konë Sinovlast katun afër Peja e Istogut, tybe ne disha. Të cilët në '12-tën i kanë përzanë malazezët. Janë shku në Shqipëri, Zogu iu ka dhanë Mamursin, se Mamursi përpara u kanë zhvletë kënetat anej-knej, ku kosovarët atje janë shpërngulë. Në ato kënetat i kanë terë, anej-knej, se edhe ai s'i ka dhanë fusha ma afër ja ka dhanë Mamursin, bile sot ka atje familje shqiptare... kosovare në Mamursë, por edhe janë në, në... Durrës, se Durrësi është aty afër. Ju e dini ku është Mamursi? [i drejtohet intervistueses], qaty afër.

E në '42 ka lindë ajo në Shqipëri e tona në luftë '43-tën diçka këta, baba i saj kthehet në Kosovë. E ndërkohë malazezët ikin prej atyne se këta janë përzan si kaçakë<sup>2</sup>, se këto harrova me tregu. Krejt katuni është shpallë prej ish shteteve sërbe si kaçakë edhe i kanë përzanë ata në realitet prej atyhit. E tash këta kur janë kthy, malazezët kanë ikë, kanë ikë malalzezët. Mirëpo, çka po ndodh tash? Politika shkon si era. Apet kur kthehen këta e '45-tën çlirimi anej-knej, e jom mundu me i ndihmu ma vonë si politikan po s'kom mujt kurgjo me bo, mbet si tokat e kaçakëve. Kjo është interesante për juve [iu drejtohet intervistueses], si hulumtues.

Atëhere këta s'kishin çka me ba, prapë tash edhe pushteti i ri, këta, "Ato janë tokat kaçake, na s'mundem me i përzanë këta, këta e kanë të drejtën e vete malazezët". Ma vonë edhe ata janë privu, ai katun tash është i shkretë. S'ka kurgjo aty veç temelat, shpijat e ktyne që janë konë nuk rron kërkush.

<sup>2</sup> Njësite të jashtëligjshme, banditë, të njohur edhe në rajone të tjera të Ballkanit si hajduk apo uskok, të konsideruar nga shteti si kriminelë të thjeshtë, por shpeshherë ithtarë të një agjende politike të çlirimit kombëtar.

Pat ardhë i ktyne prej Shqipërie vetë aty diçka me ba por jo. Kështu që, kur u martova thashë edhe tona nisi jeta pak ndryshe, e lash edhe futbollin. Banesë s'kisha u duhsha me pagu me qira aty në Obiliq te njani, se kur erdha, kur luajsha futboll qata dy-tri.

Para se me u martu kish banesa sa të duash, unë s'dojsha. Thojsha, “Çka po më vyen banesa?” E kisha dhomën me një shok qaty, hala janë ato dy ndërtesa në Obiliq si të hyn në anën e djathtë, tash kush i dihet kush banon. M'u doke i lirë me marrë banesa me ba me to se mora, tana kur më vyeti nuk kish momentalisht... nejtë, nja dy vjet kom banu privatisht, mas dy vjete ma dhanë një banesë dy dhomshe. Vazhdoi jeta tona kur me diçka që kurrë nuk e kom mendu që do të bëhet edhe s'e kam dashtë politikën. Po, qato vite tash po filloj... fillova me u ba politikan, as s'kam dashtë, po jeta po të çojke.

## Pjesa e Tretë

**Hysamedin Azemi:** Ëë... është si... në atë kohë isha une '65 a s'di tash datën taman, u mbajt kjo Konferenca e Dytë e Lidhjes së Komitetit të Jugosllavisë. Atëhere Komiteti Qëndror i Jugosllavisë u përbajke prej 140 anëtarëve, ka 20 kanë qenë prej republikave edhe ka pesë prej krahinave anëtarë të përhershëm të Komiteti Qëndror të Jugosllavisë. Une atëhere si punëtor i ri, elektrikist, ka ra shorti s'di kush, qysh, çka, isha edhe isha aktivist atëhere i Sindikatit në Obiliq, e jam propozu edhe jam zgjedhë në Kongresin e Jugosllavisë për anëtar të përhershëm.

Aty u kanë Sinan Hasani, po më duket vallahi s'di a edhe nja tre katër po s'më bijnë në mend tash, Ilia Vakiqi për shembull prej Mitrovicës edhe këto, vetëm pesë jena kanë anëtarë të përhershëm. Mirëpo në ato momente nuk ma kanë vnu mu veshin shumë kta udhëheqësia e Kosovës, “Çka Hysamedini punëtor anëtar”. Po por rrallë u mbajke ato konferencat, pjesën e dytë u zhgjidhshin delegatët sipas temave që i kish konferenca. Aty ishte tema për qetë rreth nacionalizmit, sidomos si situata jo bash e mirë në Kroaci po edhe në Serbi nisën me vlu disa parlamente nacionaliste, sidomos në universitete do profesora në... të Beogradit.

Atëhere ata udhëtojshin me tren, që the ti qysh udhëtojshin [i drejtohet intervistueses], e ai treni e kish një vagon special për këta, me shtrata me krejt kështu, po, qato kabinat. A une udhëtova me klasën e dytë, pa kurrfarë kontakti, ata mu nuk um kontaktojshin hiç, te udhëheqësia e Kosovës, atëhere u kanë Fadili [Hoxha]<sup>3</sup>, Mahmuti [Bakalli]<sup>4</sup>, e qeta. Ishin ata kryesorët e pas Luftë edhe që ishin në funksione

<sup>3</sup> Fadil Hoxha (1916-2001), lideri partizan komunist shqiptar nga Gjakova, i cili mbajti një sërë postesh të larta në Kosovë dhe Jugosllavi, duke përfshirë postin me rotacion të Nënkrjetarit të Presidencës Federale, posti më i lartë udhëheqës në Jugosllavi nën Titon, në vitin 1978-79. Ai doli në pension në vitin 1986, por u përjashtua nga Lidhja e Komunistëve me akuza për nacionalizëm.

<sup>4</sup> Mahmut Bakalli (1936-2006) ishte një politikan shqiptar nga Kosova. Bakalli e filloi karrierën e tij politike në organizatën rinore të Lidhjes së Komunistëve të Kosovës, duke u bërë përfundimisht lider i saj në vitin 1961. Me ngritjen e gradave, ai u zgjodh në Komitetin Qendror të kreut serb të partisë dhe në Presidiumin e Komiteti Qendror i Lidhjes së Komunistëve të Jugosllavisë.

kryesore. Une me një hotel të Beogradit qaty u vendosa e mora një gazetë e kqyrsha për me e inkuraju [diskutim] “Politikën”. Në atë “Politikë” shkrujke për nifarë profesor Gjuriqi, i cili ish shumë nacionalist i keq, i cili diskutojke nëpër ato grupet e Serbisë e profesorave edhe ku shumë i kritikojke shqiptarët e Kosovës, nacionalist i kullum.

Unë u ula qaty në hotel me to e bana nifarë diskutimi, e aty tash në këtë konferencën ishin caktu kush prej cilës parti ka me disku, kështu që nuk kish diskutant të lirë që mun... që unë s’kom ditë, [ishte] të parën here une me shku, kurrë... na s’jemi në nivel të Jugosllavisë. Po une nuk e dijsa që osht’ qashtu edhe për to ish kanë e caktume, se ai Vakiqi e s’di edhe nja... s’e di cili prej shqiptarëve kam harru. Edhe une tash nisi konferenca kesh me ta u ula qaty, diskutimet, Titoja<sup>5</sup> e udhëheqke mbledhjen, Biro e këta kryesorët Bakariqi, Kidriqi e krejt këta aty rend, si gjithë në rendin e parë. Tito kryesojke.

Une e bana plan që menjihere me marrë me lyp fjalën, si u kry fjala hyrëse, s’ka lidhje kush u kanë, unë meniherë lajmrona se dojsa me disku kur është Titoja aty, se ai nuk rrijke gjithë se ai kryesojke, po kohë mbas kohe dilke me pushu anej-knej. Qashtu edhe u ba mes katër-pesëve po thotë, “E ka fjalën Hysamedin Azemi, punëtori i [Bashkësisë] Elektro-ekonomisë së Kosovës nga Kosova”. Une po bahna kishe s’pe shoh kërkon. Mahmuti po kqyrin këta të Kosovës mes veti, “Kush e di çfarë sherri na bani ky”, tha (qesh), “ky s’din kurgjo, punëtor o”. Une isha punëtor, s’di politikë. E marrë une fjalën, dal. E kom dikun në “Rllindje” është krejt edhe në ato të Obiliqit e kam une, se Obiliqi e ka pasë gazetën e vetë mujore, [aty] tekstin e plotë që e kam disku,

Po kryesorja për ju me thanë, teza kryesore ishte që unë po e pyes Titon, “Deri kur? Ju gjithë i pari do të nisni problemet e këto, a këta shokët këtu me dorë ata që rrishin aty bashkarisht e këto, mas juve tona te tonë atë temë pe marrim për me zbatu anej-knej, nën një. E dyta, pse propozoi që në këto funksione”, po flas për vitin ‘73, po ‘73, me disku tash ti një shqiptar, një punëtor me i dhonë Titos e kongresit e konferencës propozime. A une isha Hysamedin Azemi, “politikan i madh” pa u kanë kurrë në politikë. E dyta thashë, “Mirë ish kanë qeta shokët e juve, ata janë edhe kryetarë në republika, krahina, janë edhe në kryesi partisë, edhe në kryesi të shtetit e pse ma mirë ish kanë ata me u kanë kryetarë atje edhe dy tjerë me pa që me konë tre-katër veta jo njani, thashë kur... qysh munet njani” thashë, “me i punu krejt gjithë [këtë] punë? Veç një punë është e madhe. E dyta, e treta”, thashë, “deri kur që po luftojmë”.

Tema ish luftimi i nacionalizmit që na klasa punëtore po dahemi pak filozofi, jo përnime edhe tash klasa punëtore ndahen, por të holla për shtetin, me tatime me krejt ato. Thashë, “A knej”, thashë, “na nëpër fakultete të ndryshme këta po na helmojnë rininë. Si për shembull”, thashë, “rasisht e lexova dje në ‘Politikë’<sup>6</sup> që ky profesori Gjuriqi a e mbaj mirë mend mbiemrin”, thashë, “mundet me ba qaq

<sup>5</sup> Josip Broz (1892 - 1980), i njohur si Tito, ishte udhëheqës i Jugosllavisë komuniste. Ai kishte shërbyer në role të ndryshme nga 1943 deri në vdekjen e tij në 1980. Ai luajti një rol të rëndësishëm në bashkimin e grupeve të ndryshme etnike të Jugosllavisë, dhe udhëheqi vendin gjatë një periudhe relativisht stabile, duke zbatuar një formë unike të vetëadministrimit socialist.

<sup>6</sup> “Politika” është gazetë ditore e botuar në Beograd, Serbi, që nga viti 1904.



aktivitete ku një popull si shqiptarët don me i degradu me i sulmu e mi anej-knej...” edhe do sene tjetër, qito tri sene janë kanë, Gjuriqi, kta edhe deri kur ai se Titoja i vërteti problemi, kur shkojke e mbajke një mbledhje dikun e kritikojke e lypke ato, tona këta te tonë mbas tina, po asnjani nuk ishte që i paraprijke këtyne punëve.

**Anita Susuri:** Që i jepke zgjidhje.

**Hysamedin Azemi:** Po, a une tona e kom pa në inçizim deri jam ulë une [ka pasë] aplauz edhe ai edhe aty. I vetmi në atë konferencë që kam diskutu jashtë atyne që janë delegu. Këta të mijtë u idhnunë sidomos Mahmuti u idhnu, Fadili tha, “Leje djalit tha, se boll mirë ka folë”. Se une aty edhe në fund thashë, “Nacionalizmi duhet me u luftu gjithëkund” edhe u dukke me thanë edhe në Serbi e knej, po edhe në Kosovë. Tana u bana nervoz thashë, “Unë”, thashë, “që nacionalizmi nuk o veç Gjuriqi, ka edhe në Kosovë. Ti çohu edhe trego a ka, a s’ka”, edhe ja mshela debatin. E qashtu u kry konferenca, tana gazetata e dhanë ato... “Filan punëtori e diskutoi, e tha kështu...” se tjerët ishin krejt këta politikanët. E tona në hotel, një maqedon ja kom haru [emrin], ishte ambasador po më vetë prej kahit je qeshtu. Tha, “Ku punon, çka punon?” Tha, “Vallahi, zor e ki”, tha, “ki me pasë tash kur të shkon në Kosovë”. “Pse?” Tha, “Kanë me të kritiku, kanë me të thanë...” thashë, “A di çka? Unë nuk jam kurrëfarë funksioneri, une jam elektrikist. Tash danat edhe shafcigerin, ato vidin, s’munet me ma marrë kërkush”. Eh, tha, “Atëherë s’paska gajle”.

Prej atëherit tona nisën këta, nisi politika jeme për të cilën nuk isha... atëhere nisën me më angazhu. Na fali keq kryetari i Sindikatit të Kosovës, në Komitetin Komunal isha i rregullisht anëtar me gjithë atë... u lutke me pasë punëtorë, qashtu u kanë politika atëhere që me pasë punëtorë në këto organe e ndryshme. Tona une elektro-ekonomist aty ngat edhe kështu llafazan pak edhe kishe, kishe trim anej-knej edhe isha në Komitetin Komunal, si shumë shokë tjerë si janë kanë atëhere dhe nisën me më thirrë tona në mbledhje të ndryshme. Para asaj nuk u më thirrshin as në konsultimet e ndryshme, qe në rrugë kur shkum hiç ata me atë kerrin e fjetjes anej-knej, une me tren anej-knej, nisën me më afru me...

**Anita Susuri:** Afru.

**Hysamedin Azemi:** Kur u bojshin konsultimet e ndryshme pak ma e gjanë, më thirrshin edhe mu si anëtarin e përhershëm i konferencës së partisë dhe qashtu nisi aktivitetet e ndryshme.

**Anita Susuri:** E a ju qortun, a ju thanë najsen që ke folë?

**Hysamedin Azemi:** Ja, s’mujshin se teksti ke shumë i mirë, atë se qysh une me i thanë Titos deri kur ti këto? Edhe për qato ata u idhnuan, edhe u idhnuan pse e përmenda atë Gjuriqin. Pse kush jam unë tash Gjuriqin me përmend? E përnime kush isha une? Isha... për politikë kërkushi, një punëtor në komandën e rrjetës punojsha, e çojsha rrymën për Shkup e për Kosovë e për Beograd e për knej, edhe ni futbolleri i Elektro-ekonomisë qaty.

**Anita Susuri:** Besoj ju kanë dhanë shumë rëndësi, se atëherë punëtori edhe ka qenë një shtresë shumë e respektume.

**Hysamedin Azemi:** Po, po, po. Po, e vërtetë po tona aty si hypi i bani, dy-tre ditë aty ka shkrujtë aty për atë diskutim, se kërkush ashtu diçka s'ka thanë aty. Krejt janë përgaditë tekstet për me rregullu qysh ashtë në Kosovë, Tita edhe Komiteti Qëndror i Jugosllavisë, qysh në Serbi, qysh në Kroaci, kanë pasë telashe se atje goxha problem u konë, u patë bo kjo punë. Titoja atëhere në Rudo, po më dokët e ka mbajt një fjalim para kësaj edhe tona kur mbajke ai dikund fjalë, e populli e përkrahke. Na mundemi me folë çka dojmë, po e përkrahke edhe populli edhe punëtorja e dojshin e përkrahshin e qashtu. Tash erdh një kohë, pas qeto dhetë e kusur vjetëve e sa, dymdhetë e sa në Elektro-ekonominë, kaloj në Komitetin Komunal të Prishtinës, pasi që pata aktivitete edhe si kryetar i Sindikatës të Elektro-ekonomisë, por edhe në Komitetin Komunal jam kanë në disa... anëtar i Komitetit Komunal edhe kom qenë relativisht aktiv edhe punën që e bajsha në Obiliq si...

Sekretar i atëhershëm ka qenë njëfarë Dushko Listiqi, ai kontaktoi me mu. Kishte me zgjedhë dy zavendës-sekretarë të Komitetit Komunal. Më pyeti a jam i interesum, une i thashë, "S'di çka me të thanë", i thashë, "me politikë s'kam pasë qejf kurrë me u marrë. Me futboll, me elektro-ekonomi edhe jam gjindë mirë qaty, a me politikë", thashë, "s'kam pasë se une qato që e mendoj qato e thom" thashë, "edhe shpesh here njerëzit s'po kanë qejf me i thanë sy drejtë edhe tona veç po shtohen kundërshtarët me thanë, mos me thanë armiqtë". Edhe tash edhe atëhere s'kanë pasë, s'kanë qejf njerëzit me ju thanë në sy ato që duhet, une jam kanë njëri prej... më kanë njoftë shoqnia jeme që çka mendoj qashtu e thom. S'do me thanë që e kom pasë gjithë drejtë, po e kom thanë mendimin tem.

Tha, "Unë kom nevojë për ty me ardhë atje në Prishtinë në Komitet si përfaqësues i Elektro-ekonomisë e këto". U pajtum. Fola me bashkëshorten, ramë dakord që... "Qysh të pëlqen, ti kqyre vetë, qysh të dushë. Une jam përkrahëse e jotja, në çdo punë e çka punon ti më ke krah [mbështetje]". Kështu prej qatëhershit e deri në fund të jetës saj e kam pasë ni përkrahje shumë të madhe, edhe ajo shumë don me thanë kur e ki përkrahjen dikon si bashkëshorten, a dikon tjetër. A une e kom pasë bashkëshorten edhe bashkëshorte edhe shok. Pranova, u mbajt konferenca qajo zgjedhore, u zgjedha. Ka pasë probleme për zgjedhjen teme tek një pjesë e udhëheqësisë së Kosovës, s'ka nevojë me përmend kush.

**Anita Susuri:** E pse?

**Hysamedin Azemi:** Pse, thojke, "Ai është i mirë, flet drejt, e kqyre drejt e krejt. Po na jena Prishtinë, qytet me universitet. Neve na vyjnë njerëz kuadra me shkolla, të shkollumë anej-knej". Jo për tjetër, po që une isha punëtor, e nuk ja mushsha synin atyne. Me konë gjallë e kisha thanë kush, po një prej udhëheqësive kryesor të Krahinës. Mirëpo, ky kambënguli, kambënguli. E une s'e kom ditë, ma vonë e kom ditë ato. Kambënguli që me më zgjedhë edhe u zgjedha. Bashkë me mu u zgjedhë edhe nifarë profesor Nagavci, ai gjakovar u kanë, edhe une dy zavendësa jena kanë në Komitet Komunal.

Aty ka pasë edhe atëhere, se Prishtina gjithë ka pasë probleme ma shumë se... qytet me universitet, me ndërmarrje të ndryshme, u dukte me shku nëpër ndërmarrje me diskutu, me përjashtu, me kritiku, e me ato... E tona ktina i konvenojke me më pasë mu aty që për terren ma shumë, për ndërmarrje jam marrë. Po une tona ma shumë u merrsha me universitet, se profesori. Kjo, kom pasë aktivitete kryesore nëpër ndërmarrje, nëpër qeto, e tash erdh situata që u keqësu, nisi me u keqësu situata politike në Kroaci, në Serbi. E u konë edhe zhvillimi i thojshin Lëvizja Masovike - *Mas Pokret* i njoftun i Kroacisë, nacionalizmi në Serbi edhe Titoja si gjithë, që kom folë edhe ma herët, u duhtë ai tash si gjithë me kërkun që udhëheqësia e Kroacisë edhe e Serbisë me u shkarku.

Në Serbi u kanë njëfarë Marko Nikeziq edhe nifarë Llatinka Peroviq. Ky Nikeziq u kanë Kryetar, a Llatinka Peroviq u kanë Sekretare. Osht' një politikane e shquar, hala po më dokët është aktive edhe që ashtë në moshë shumë e aftë, kështu shumë [kuadër] e aftë politike edhe krejt, por u kërkun me u largu. Në Komitetin Qëndror të Serbisë, Kosova edhe Vojvodina i kanë pasë ka dy antarë, u kanë gjithë një sërë dhe një shqiptar. Shqiptari ka qenë Orhan Nevzati, një aktivist i mirë e një prej, po më duket u kanë edhe Kryetar i Rinisë së Kosovës, jurist. Mendimin tem, shumë djalë i aftë u konë, politikan i mirë, i aftë, ai t'u pasë shoqni shumë mirë me Llatinkën, prej tina s'kanë kërkun dorëhekje, ai jep vetë dorëhekje. Dorëhiqet prej Komitetit Qendror t'u mos... domethanë nuk u pajtu me këtë politikën e Lidhjes Komuniste të Jugosllavisë për shkarkimin e... e tyne.

Mirëpo, Komiteti e krejt organet tjera mbetën pa ndryshime, aty këtu do u larguan por jo kështu pompoz si këta dy, se ishte gjysma e mandatit e u kënaqën që bonën ndryshime vetëm Kryetarin, Sekretarin edhe një anëtar i cili Kosova me dhanë se ky Orhani dha dorëhekje. Une isha anëtar i Komitetit Qëndror të Serbisë në atë kohë, e atëhere vjen ky sekretari i tij thotë... "Ku je?" "Te Mahmuti". Thashë, "Çka batë bre? A u murët vesh?" Tha, "Po more", tha, "u murëm vesh". Tha, "Shumë mirë. Kush po shkon atje?" "Aiii", tha, "kush? Palidhje". U mahitke. "E zgjodhën njo qaty", tha Mahmuti, "Na, hajt." "Ani de", thashë, "s'ka gajle, kush?" "Kush?" Po thotë, "Shko te Mahmuti nalt." A zyret tona ishin në katin e parë. Qaty u kanë Komiteti Komunal e Komitet Qendror, Sindikata, Rinia, Lidhja Socialiste, jo si tash nëpër qytet [të shpërndarë] te tonë, te këto të madhen [ndërtesë] janë vetëm dy ministri edhe kryeminsitri, a tona ministriat i kanë nëpër qytet ato. Na krejtë jena kanë qaty [me një ndërtesë].

**Anita Susuri:** Cila ndërtesë?

**Hysamedin Azemi:** Ndërtesën ku është tash kjo për sport a për çka ashtë aty? Që ke bujqësia, në qendër, në qendër, qendër ndërtesa e Komitetit, qajo u kanë në qendër.

**Anita Susuri:** Ministria e Kulturës.

**Hysamedin Azemi:** Qajo po, aty jena kanë krejt këto strukturat krahinore. Ajo e Prishtinës ka qenë te stadiumi, ajo ndërtesa katër-pesë katëshe, qaty u kanë Komiteti Komunal, po edhe aty jena kanë krejt strukturat politike në atë ndërtesë. Aty shkova i thashë, "Çka... pse me shku te Mahmuti?" Tha, "Shko de, shko se ty po të propozon". Thashë, "Hajde, mos lujë, une me shku veç..." pak bona edhe ironi. Thashë, "Une menxi u pranova për zavendës këtu, une punëtor, çka mundem në Komitet Qëndror të

Serbisë?” Thashë, “Me, me profesora me doktora, me Komitetete të Jugosllavisë”, në atë kohë. Tha, “Hajt, hajt, shko fol me Mahmutin, tona bisedojmë”. Shkova te Mahmuti. Mahmuti tha, “Qeshtu qeshtu, situata ashtë qeshtu, Orhani u tërhjekë”. Na kena bisedu shumë edhe me Serbinë, se tash u duhtë me bisedu edhe me ta, se ata dojshin dikon me pranë që edhe ata p’e dojnë.

Do anëtarë të Komitetit që i kishim na nuk ishin në sy të mirë se ishin aktivista, une s’isha... s’kisha pasë kurrfarë aktiviteti që ata me më çmu, as mirë as keq. Ishin do që, që nuk ju pëlqejke Komitetit Qëndror të Serbisë atëhere, një prej... qashtu e kuptova që janë ra dakord edhe ata që une me konë. Por edhe isha anëtar i Komiteti Qendror, nuk u duhke tash me u zgjedhë dikush, se ai funksion ishte anëtari i Këshillit Ekzekutiv të Kryesisë të Komitetit Qëndror të Serbisë, njëkohësisht isha edhe anëtar i Komitetit Qëndror edhe i Kryesisë edhe i Këshillit të Ekzekutivit, tre funksione barabartë. Ishim tremdhetë vetë me Kryetarin e Kryesisë, Kuvendit, Qeverisë ishin qata faktorë, 14-15 që ishin në krye të Republikës. Qashtu u kanë edhe në Kosovë, në krye të Kosovës qashtu u formu udhëheqësia.

Thashë, “S’di”, thashë, “une mendoj që nuk jam une ai profili për me shku atje. Une di diçka me folë anej-knej, po” thashë, “une nuk e kam nivelin me nejt atje me profesora, me doktora të ekonomisë, juridike e krejt këto. Une nuk kam dijeni qaq, të malit...” tha, “Neve nuk na vyen as profesora, as doktora, as eksperta, por neve na vyen njerëz të devotshëm që dojnë me punu e që... i zbatojnë politikat e Partisë e këto. Na mendojmë që më i përshtatshmi je ti, se edhe s’kena nevojë as me zgjedhë tash dikon të Komitetit Qëndror të cilët tash duhet me u shkarku dikush ti me shku e knej. Kështu e kena të gatshëm, veç zgjedhesh te Komiteti Qëndror i Serbisë edhe kryhet puna. Krejt ka me qenë mirë, qe edhe une jam këtu, na jena këtu të ndihmojmë, s’është problem. Unë besoj”, tha, “që kemi me pasë sukses”. Thashë, “Mirë, ama a bon”, thashë, “deri nesër të kqyri edhe me dikon”. “Me kon?” Tha. Thashë, “Me këdo, veç me gruan nën një. Edhe me kqyrë, po kqyri”, thashë. “Ani”, tha, “po nuk ka shumë mendime edhe nuk ka refuzim”. “Ani, hajt pra”.

Shkova, bisedova edhe prapë bashkëshortja ma bani, “Qejf s’kom”, tha, “me shku me rru në Beograd, jo.” “S’ka tash, s’don me thanë që rri”, thashë, “kjo gjysë mandati osht’. Në qoftë se rri edhe një mandat atëhere”, thashë, “mundemi me kqyrë qysh me ja ba”. S’kish qejf, ajo ish veç një, prindërit e kanë pasë ato edhe s’dojke me u largu prej nane e babe, veç fëmija i hasretit. Mirëpo, ra dakord. Si gjithë ma bani, “Zgjidhje e jotja osht’, une jam me ty”. “U bo”. Të nesrit i thashë, “Po, po pranoj”. U banën ato kontaktet, u taku, u bo Komiteti Qëndror i Serbisë u mbajt. U zgjodha për një mandat anëtar i atij edhe u transferova për Beograd. Eh, masi nuk dojsha njihere, ata menihere mendojshin qysh meniherë kishin plan që une me vazhdu edhe mandatin tjetër edhe thanë “Me ta dhanë banesën atje”. Thashë, “Kqyri edhe një here”. Banova nja dy-tre muje në hotele në Beograd, “Trio” u kanë një hotel. Ma dhanë një apartman aty, mas dy-tre muje ma dhanë edhe banesën në Beogradin e Ri. Një banesë si soliterat tonë [në Ulpianë] edhe bash qesi edhe qesi ndërtimi u kanë atëhere edhe në Beogradin e Ri edhe këtu edhe ni sistem i ndërtimit.

**Anita Susuri:** Ndërtesa të reja.

**Hysamedin Azemi:** Po, të reja. Një banesë e papërdorun, e re. Une s'e mobilova, veç sa për një shtrat e diçka, se nuk kisha as dëshirë me nejt. Edhe mendojsha me qat' gjysë mandati me u kthy, gjithë e kom pasë dëshirën me u kthy në Elektro-ekonomi.

**Anita Susuri:** Ju keni shku vetë, a me bashkëshorten?

**Hysamedin Azemi:** Vetë, se s'e dijsa une tash me shpërngulë gruan për dy vjet e tona ktheje mbrapa mbas dy vjete, banesën me lanë, banesën me marrë e këto. Mirëpo, jo m'u lavdëru por u gjinda shumë mirë. Isha komunikativ, më dojshin shumë, prej portieri aty, Huçka, Huçka, te tonë më dojshin të gjithë. Isha mirë une me portere, me ata të kuzhinës, me ata të restaurantit, me sekretarëshën me këtë, une komunikojsha si shok, jo... qashtu e kom pasë stilin e bashkëpunimit. Erdha une qashtu avash se këta në katin e nantë, aty u kanë edhe Komiteti Qëndror i Jugosllavisë, në të njëjtin ndërtesë Beogradin e Ri, nisa me punu ma caktun zyrën, sekretarëshën. Shofer s'kena pasë, po e kena pasë garazhën e Komitetit Qëndror, në udhëtime me kërkesë ta caktojshin shoferin të çojke.

Kështu që, në pune edhe prej pune udhëtojsha me tramvaje me autobusë. Beogradi i Ri po veç e kom pasë larg, po e kisha edhe veturën teme, po veturën teme tona ma mori gruaja. E, veç fillimi tash ma dhanë diqysh, une u pata mësu gjithë edhe në Elektro-ekonomi ku punoj a u çelë orari në ora shtatë, unë pesë minuta para orës shtatë jam në punë. Edhe në Elektro-ekonomi kur jam kanë edhe këtu kur shkova orari ishte prej shtatve, nejtse për do do, po për neve nuk vlejke orari i caktum këtu. Mirëpo, qysh isha msu une para shtatve shkojsha, shkova në Komiteti Qendror në punë ja nisa.

Ditët e para, mirëpo atje këta anëtarë s'e kishin bash obligim me ardhë në sallë, vijshin në tetë, vijshin në nëntë, varësisht a kish terren dikun a kish me shku meniherë mëngjes dikun në naj takima, Beogradi i madh, Serbia e madhe kish aktivitete. Këtu nuk e kanë pasë atë [orarin e përpiktë], mirëpo na në atë punë po, prej shtatve deri në tre. Kur ka po kqyri une s'është ajo aty hi une në zyre ka ora tetë po e ni erdhë zyrtarësh se e nijsha që po komunikon me do, kur erdh dikush foli me dikun e niva që po flet, une nuk reagoja, kur shkoi ai që foli e shty pak prej krahun [e derës], edhe thotë, "Ouu shoku Hysamedin, ju këtu jeni a?" Thashë, "Po, une". Ajo kishte burrin ambasador.

Thotë, "Më falni, une s'kom ditë që jeni ardhë", thashë, "s'ka problem", thashë "një çaj nëse bon, s'ka problem". Tha, "Filani, ke nejt deri pak parëz, të lypke une i thashë hala s'keni ardhë". Thashë, "Veç të mirremi vesh diçka", thashë, "une orarin e punës kështu e kom, une kom me ardhë gjithë, kur nuk vi këtu atëherë jam në rrugë ose jam në ndonjë takim, ju", thashë, "e keni udhëheqësinë e juve, mundeni me ardhë qysh jeni mësu". Jo i erdhi keq ajo e u mërzi e ngrata. Tona e msova deri sa kesh atje në qat' mandatin e parë me ardhë para shtatve, a kurrë përpara s'ka ardhë para shtatve. Edhe, nejtse kish punë atëhere në Serbi se u ba ndryshimi i kuadrave, këta që ishin mbetë në Komitetin Ekzekutiv krejt ishin me një farë barre, nuk ishin të sigurtë as për punën, u tutshin si krejt. Ra krejt Kryetari, Sekretari, ata mbetën, po barra e përgjegjësisë e kish barrën i kishin ngarkesa anej-knej.

Kështu që, mu barra më ra që me shku nëpër Komitete nëpër Serbi marrshim si te tonë, se ma së pari ai dojke që une si shqiptar me shku atje. Si ata kishin probleme nëpër Komitete të tyre, se edhe ata bojshin do pastrime atje e ma besë... ma besë më kishin në mu edhe që thojshin që jam i drejtëpërdrejtë edhe që nuk anoj për kërkon. Çka kam une me anu për ato a këto? Kështu une isha i Kosovës, shqiptar që jam ardhë para disa ditëve a mujve edhe që sigurisht do të... do të flas drejt edhe do të mbaj anën e atina që ka të drejt, se aty tona u pastroshin edhe nëpër Komitetet ato. Kështu që, dojshin shumica lypshin me ardhë. I thojshin kryetarit, “Këto me na çu, Hysamedinin, Hysamedinin”.

Qashtu që në shumë Komitetete kom qenë, kërkush s’më ka bo probleme, më pranojshin këta. Çka kanë pasë në zemër? Ma vonë e kena pa na çfarë kanë pasë, po qatëhere në qato momente ata ishin shumë korrekt me mu, por edhe u duhshin me u ba se une shkojsha gjithë si epror. S’kanë mujt bash edhe me më nënçmu edhe me më nxonë, po u sillshin mirë. Mendimet e mia, propozimet e mia i pranojshin korrekt, nuk kundërshojshin. Ish puna që isha shumë i angazhum, kështu që isha në grupin e elektro... në këtë grupin e ekonomike. U mytsha me ekonomi, jo Zastava, jo kjo. I çojsha edhe aktivistat e ndryshëm, kom pasë rast edhe Millosheviqin<sup>7</sup> me e çu. Ai ishte atëhere si... në Bankën e Beogradit kishim probleme me këtë fabrikën e e Zastavës, ajo ishte drejtëpërdrejtë i informum me rusë.

Ai kryetari ishte shumë i lidhun me Rusinë e me këto, por mu m’u duhke me ba najfarë shkarkimi anej-knej. E tona shkojke edhe Millosheviqi në terren atëhere. Atëhere edhe vijke në Komitet me raportu se jo mu po... që nuk tha Hysamedini por isha anëtar i Komitetit Ekzekutiv që u marrsha me ato punët ekonomike nëpër Serbi, Serbi, e Vojvodinë, e Kosovë duhet por për Serbi. Edhe e di mirë që aty tona kish problem, po e shkarkumë atë drejtorin e Zastavës edhe u zgjedh tjetri edhe puna e u doke s’kam pasë problem. Kanë mendu këta në Komitet që kam me pasë probleme, që kam me pasë kundërshtime, që s’kanë me ndigju anej-knej.

Mirëpo, tona qato kërkesat e Komitetit i realizova edhe në Kragujevc. Kështu që, aty u ba një çmim shumë i mirë prej Kryetarit, Sekretarit për atë punë që e kryva. E kryvi Komiteti, une veç i... i kisha vendimet, po u duhshe me zbatu ato. A nuk ishte e lehtë me shkarku një drejtor të atëhere të Zastavës, se ai ish në tona lidhjet, shumë, shumë i fortë. Mandej kam bashkëpunu me organet, shkojsha në organizata edhe ndërtimore sidomos, e edhe organizatave tjera punuese. U angazhojsha kryesisht me ato edhe kom pasë edhe fjalët hyrëse të ndryshme, kom pasë referate, konferenca, kom kalu shumë mirë. Kështu që, edhe dëshira tona [pastaj] u shpreh edhe në Komitetit Qëndror të Serbisë edhe Kosovës që une të rizgjedhna në Kongresin që pasoi. Prapë.

**Anita Susuri:** Edhe dy vite të tjera?

**Hysamedin Susuri:** Jo, mandati ka qenë katër vjet.

<sup>7</sup> Slobodan Millosheviqi - Srb.: Slobodan Milošević (1941-2006), udhëheqësi Jugosllav ngritja e të cilit në pushtet filloi në 1987, kur në Lidhjen Komuniste të Plenumit të Jugosllavisë ai përqafoi kauzën e nacionalistëve serbë të Kosovës dhe menjëherë më pas u bë President i Serbisë dhe revokoi autonominë e Kosovës.

**Anita Susuri:** Aha, katër vjet.

## Pjesa e Katërt

**Anita Susuri:** Domethanë viti '74 kur u ndërrua kushtetuta... po mendoj kur u fillua kushtetuta, ju ka zatetë atje apo?

**Hysamedin Azemi:** Domethanë, po flasim për kohën kur, janar '73-ën, me 1 janar jam shku atje edhe deri në korrik 1978. Kështu që, këto ndryshime që po i thuni ju, une kom qenë atje edhe... atëhere m'u duhtë definitivisht me u marrë me grunë që m'u bajt për Beograd. U shpërngula në Beograd. Banesën në Prishtinë e dorëzova Elektro-ekonomisë. E atje tash fillova... se gati vetëm une edhe nja dy [tjerë] e përsëritën [mandatin], une edhe nja, tjerët erdhën krejt të rijë në Komitet... në Këshillin Ekzekutiv që erdhi krejt garnitura e re. Une isha i vetmi, a vet i dyti, s'jom i sigurt, që vazhdova. Këta tjerët shkun nëpër detyra të ndryshme të tjera, në Komitet erdhën krejt të rinjët. Erdhi Vllashkaliqi për Kryetar, erdhi aty Ivan Stambolliqi<sup>8</sup> për Sekretar, meqë une kom kalu shumë shumë mirë, ai u kanë kumar e shok me Millosheviqin.

Millosheviqi ka shku gjithë mas tina, ky e ka tërhjekë në politikë, e kumari kanë pasë. Ma së mbrami ai e ka futë në gropë të gëlqerës në Vojvodinë, se gjithë u kanë ky kryetar, sekretar, tona ai u konë në Beograd, kryetar i Beogradit. Ky Stambolliqi u ba tona në... në Parti Kryetar. Ai ka ardhë për Kryetar, gjithë mas tina, ky Kryetar Kryesie, ky Kryetar Partie. E tona deri që e largoi edhe prej Kryesie edhe murr hovin e ardhjes në... Fushë-Kosovë, e krejt ato tona që ndodhën. Mirëpo, unë për flas për fillimin kur s'o konë hala në ato mundësi e funksione, por ka punu në atë drejtim gjithë tu i shku mas Stambolliqit edhe tu e pëkrah Ivan Stambolliqin.

Në... tash atje erdh gruaja por s'kish punë, çka me punu? Ata më thojshin ku me futë nejt institucion si nëpunëse anej-knej, "Çka punon?" I thashë, "Është mësuese." Tha, "A mundet" tha, "me punu?" Thashë, "Mundet edhe serbisht, po nuk shkon bre", thashë. Tha, "Na e kena një problem", tha, "në Beograd të Ri, në Topçider<sup>9</sup> deri këtu që del e kena një profesor i cili herë punon e herë s'punon, e i jep fëmijëve, shqiptarëve gjuhë shqipe edhe histori, a kish mujtë ajo?" Thashë, "More, pse jo?" Po flas me grunë. Thotë [ajo], "Pse jo, se çfarë problemi ka."

Edhe kontaktova me këta në Kosovë kush s'dashti me i ndihmu as për program, as për çka. Mirëpo, kjo e bani vetë programin, mësuese ish e kish programin. Aty u duhke me punu me qita fëmijët që ishin klasat filllore, edhe i kish dy orë, një orë shqip, ni orë historinë. I boni ajo një prog... programin e për

<sup>8</sup> Ivan Stambolliqi - Srb.: Ivan Stambolić (1936 - 2000) ishte politikan serb. Ai ishte anëtar i Lidhjes së Komunistëve të Serbisë dhe shërbeu si President i Serbisë në vitet 1980.

<sup>9</sup> Topçider - Srb.: Topčider është park malor dhe lagje urbane e Beogradit, kryeqytet i Serbisë.

qato dy landë, librat e ato krejt i siguroi edhe filloi me punu në Beograd të Ri në Topçider. I grahke veturës mirë edhe ma muri veturën, e se u dukke me shku në Beograd të Ri edhe Topçider. Edhe jepke tona, njerëzve tonë që punojshin atje, sidomos në organe politike edhe tjera, po kish edhe tjera profile ka dhetë-pesëmdhetë fëmijë vijshin aty me mësu gjuhën.

Kështu që, u pranu si mësuese e rregullt, e pranunë si tona ato mësueset e tjera që kishin programin plot, a këto... po kjo e plotësojke që shkojke edhe në Topçider edhe këtu në dy shkolla edhe ka punu deri në fund që u kry... u kry mandati i jem atje që u kthym për Beograd. Ka punu domethanë katër vjet, domethanë ka dhanë fëmijëve të shqiptarëve kryesisht funksionerave të ndryshme, histori edhe gjuhë shqipe. Mos me folë na tash që s'u kanë, gjithë u kanë kështu, s'u kanë bash atje atëhere pagujshin shkollën, pagujshin transportin kur dojke me shku me mësu shqip edhe histori, a ua mundësojshin edhe transportin edhe krejt. Unë po flas për qato vite, nuk po hyj tona çka ndodhi qysh ndodhi ma vonë. Domethanë, ajo punojke atëhere, u rregullu pak puna se ajo punojke.

E tash vjen një situatë kur une tona '75, me 19 mars më lindë djali, Agroni. Kjo ashtë një histori e luftës tonë bashkë me grunë teme nimdhetë vjeçare. Nimdhetë vjet s'kena pasë fëmijë. Nimdhetë vjet u mjeku gjithkrah, ma së mbrami në Beograd, në Klinikën e Beogradit. Mirëpo, ma së shumti më ka ndihmu Klinika e Lublanës, profesor Horvati, i cili u kanë shumë i njoftun atëhere si gjinekolog. Me ndihmën e Lublanës edhe mos me ia hup meritën edhe Klinikës së Beogradit mas nimdhetë vjet më lind djali, edhe gëzimi jem ma i madh në jetë. Mas nimdhetë vjetve bash aty.

Atëhere u detyrova tash konë me marrë, qysh me marrë? Nana e vet u fliju me ardhë me na kqyrë djalin, nana bon për veti çkado, burrin e vet e la në Mitrovicë [Gjakovë]. Ajo erdh me rrnu me neve në Beograd, vetëm me rujt nipin, qashtu që edhe atë problem e zgjidhëm mirë. Ajo punojke, nuk e kish orarin e gjatë, po nanën e kish me veti. Tona edhe mbrapa kur u mërzitke, s'u mërzitke me djalë e me e ju plotësu dëshira nimdhetë vjeçare me u ba me fëmijë. Mo s'kena pasë problem, ish problemi qashtu natyror që... mirëpo, kryesorja djali lindi edhe në Beograd.

Atë kohë, une edhe isha edhe tu e kry fakultetin e shkencave politike edhe qatëhere e kom kry edhe fakultetin, e u diplomova si, u emërova si politolog i diplomum. Aty u barazova, pak ma vonë, por u barazova me ata kundërshtarët që thojshin s'kam shkollë, s'kam fakultet, e s'kom këto. Po i ranoj pak a? S'ka gajle. E, tash puna shkon si shkon, aktivisti problemet e mëdhaja u bojshin, për shembull veç vizitalet tregoj kur hala në Jugosllavi u zgjedhke Titoja, pa u vet Titoja s'u bojke kurgjo e kur isha për atë "Librin e kaltër" të ashtuqjtun, s'di a keni ni ju? [i drejtohet intervistuesës] Ajo ashtë libër famëkeq që e ka shkru këta... Serbia që e ka pasë për nacionalizmin e këto u quajt "Libra e kaltër", të cilën tona e ka shfrytëzu edhe Millosheviqi, se ai është prodhimi i Akademisë së Shkencave të Serbisë. A ma vonë edhe tash, ajo libra vlen për politikën e atëhershme, po ato tona e ka zbatu Millosheviqi deri në përpikni.

Na ishim, atëhere shpesh u takoheshim atje në në villën e posaçme ku kishim mbledhje, mirëpo politikanët e Kosovës e Vojvodinës ishin unik atëhere edhe tonët, krejt. S'kena pasë probleme, serbë, shqiptarë njejtë kena veprum njejtë kena mendu. Edhe, edhe kjo Vojvodina edhe Kosova kështu që aty



tona e shihshin ato sene se na përnime na mas kushtetutës '74 e këto na ishim *de facto* republikë. Tona i kishim të pavaruna me poilici, me ushtrinë e kena pasë të përbashkët krejt Jugosllavia, por këto organet tjera i kena pasë edhe krahinat si republikat edhe pjesëmarrja në kuvendin e Jugosllavisë, po gjithë me proporcion ma të vogël se tjerët, 20 Serbisë deputetë, pesë të Kosovës, pesë Vojvodinës edhe qeshtu.

Mirëpo, jena kanë prezent edhe në organet shtetërore, politike edhe me ato nenet 300-301 janë konë edhe me atë kushtetutë '74, po, e atëhere Serbia nuk mujke shumë sene me i pru ndi me pa pëlqimin e Kosovës dhe Vojvodinës edhe qajo u konë tona brenga kryesore e Serbisë edhe lufta e përgaditun e tyne që kur të shkon Titoja, se nisi sëmundja anej-knej, që ata me rikthy krejt ato edhe me luftu... për një Serbi unike e të madhe qysh e kanë planifiku. Mirëpo, shumë sene ato nuk shkojshin ashtu. Na u mirshim vesh u duhke na pritshim ata shkojshin te Titoja në Brione, vijshin të nesrit e apet biseda, luftë, Vojvodina, Kosova me ta, kritika të ndryshme të mëdhaja me ta ishim edhe aty do që ishim me Titon, të cilët edhe ata ishin në anën tonë por nuk ishin shumë. Deri që Titoja tha, "Qiteni ato në bërrllog edhe u kry puna", u hjek ai problem. Por në kokën e tyne, në politikën e tyne Serbia mbet si bibla ajo libër për gjendjen për Kosovën edhe për krejta ato tona çka kanë ndodhë në Kosovë.

Ivan Stabolliqi u kanë shumë ma i drejtë edhe ma i mençur, ai thojke që, "Ma mirë është na me shqiptarë me u marrë me vesh edhe me bashkëpunu edhe me jetu bashkë se sa me... m'u kundërvu me ardhë deri tek konflikti". Mirëpo, Millosheviqi bashkë me Kishën Ortodokse, me këto organet tjera ndryshe mendoj edhe ndryshe veproi. Erdhën deri në atë situatë e cila tona ma vonë e dijmë se qysh eskaloj.

**Anita Susuri:** Pasi jeni kthy prej Beogradit, qysh ka hi pastaj karriera e juaj këtu?

**Hysamedin Azemi:** E tash une kur u ktheva prej Beogradit, erdhi koha me u zgjedhë prapë Kongresi i ri, une refuzova me nejt mo, edhe që këta dojshin shumë më propozojshin që me mbetë prapë edhe Serbia edhe Kosova. Kosovës, ata prej shehri që propozojshin, po une nuk isha, nuk dojsa, nuk kisha mendimin edhe gjithashtu edhe gruaja ma nuk dojke. Thojke, "Du Agronin me rritë në Kosovë, se rritet këtu e tona më jet këtu, qito menxi e linda" edhe une isha shumë i interesum me u kthy. Edhe ndodhi një... bash në atë kohë kur nuk u kry kjo, kah fundi i mandatit, po gati ishte edhe Kongresi edhe krejt edhe kandidatët tjerë ishin bo. Une nuk pranova që këta tjerët që ishin prej Serbie u çuditshin se ata menxi pritshin me ardhë prej qyteteve të vogla në Beograd. E tona kishin qejf me mbetë në Beograd, se jeta në Beograd ndryshe, thojshin që p'i çojmë në shkolla të ndryshme, nëpër sauna të ndryshme, nëpër teatro të Beogradit. Kishin qejf me nejt me çdomos, bojshin... gjithçka ishin në gjendje veç me mbetë në Beograd.

A thanë, "Ti po don me u kthy në Prishtinë". "Po, unë po du me u kthy në Prishtinë". Në Elektro-ekonomi ka qenë drejtor në atë kohë njëfarë Besart Berisha, një... një afarist shumë i fortë i Pejës. Por, ai, po fill mbas vdiq, atak në zemër, vdiq. Në atë kohë bash kur une mendojsa me u kthy, qashtu u lidhë edhe situata. Mbasi Besart Berisha vdiq, atëherë u liru vendi në Elektro-ekonomi për

drejtor gjeneral. Mirëpo, në politikën Kosovës u kanë qashtu që kur është drejtori shqiptar në Elektro-ekonomi, në Trepçe është serb ose malazez. Në... në atë kohë u kanë Veli Deva, atëhere pat shku drejtor i Trepçës. E tash u duhke në Elektro-ekonomi me u zgjedhë serbi drejtor, a zavendësi shqiptar.

Atëhere ata më ofruan mu këta të Komitetit, Komitetit e qeta Grupi kadrovik, që në çdo nivel janë kanë [të përfshirë] kryetari i Partisë, Kryesisë këta janë kanë Komisioni kadrovik për nivele. Ata thojnë se, “Ma mirë ish kanë”, tha, “masi Hysamedini s’po don ma me metë atje. Tash pse nuk e çojmë për zavendës-drejtorin në Elektro-ekonominë? Në qoftë se pranon, se ai e njef elektro-ekonominë pioner i Elektro-ekonomisë, qaty ka punu dhjetë-pesëmdhjetë vjet e njef, e njofin, e njef e Elektro-ekonominë”. Se ky serbi që u propozojke, shumë njeri i mirë, inzhinier, por as s’dojke me u marrë me politkë, as haber s’kishte, s’dojke shkurt. Veç anën teknike [dojke], nuk u përzijke në politikë me e vra. Toma Fabiq, u kanë një qytetarë autokton i Prishtinës, vendas. Atëhere une pranoj me gjithë qejf se s’kom llogari që për drejtor, zavendës-drejtor, po thashë, “Edhe ashtu kom dashtë, kom pasë qejf me u kthy në Elektro-ekonomi”, pranova.

Tash u kanë këto zgjedhjet edhe diskutimet. Mirëpo, tash na, na Elektro-ekonomi u bam menjherë, nisi njëfarë opozite e shqiptarëve se atëhere u bo... u bom na boll shqiptarë atje në Elektro-ekonomi. Tona s’kishim serbë me i bo dikun, tona kishim sa dush inzhiniera, jurista, ekonomista e krejt, ma u pasurum me kuadra. E ata, një pjesë e tyre lakmojke ata me u ba drejtorë, “E tash qysh Hysamedini me ardhë për zavendës-drejtor, elektriçist, a na këtu [ne mesin tonë serb] kemi ekonomista, jurista e këto”. Mirëpo, ata nuk dijshin që formalisht i kisha plotësu kushtin, që s’jom mbetë une elektriçist me profesion edhe dhjetë-pesëmdhjetë vjet, po kom avancu. Ndërkohë, une e kom pasë të kryme edhe për inxhinier të organizimit të punës. U kanë një fakultet s’di a e dini [i drejtohet intervistueses] edhe tash nashta ka.

U kanë i Novi Sadit për organizimin, unë dilsha inzhinier jo i diplomum, dy vjeçar inzhinier i organizmit të punës, ato e kisha pasë kry, ato e kanë pa çelë Novi Sadi në Prishtinë një degë. Po në ndërkohë une edhe kisha diplomu, isha politolog i diplomum, e kisha diplomën të kryme, veç ata se kanë ditë. S’jom dalë une në gazeta me thanë e kryva fakultetin anej-knej, po politolog. Mirëpo, ata pak tona janë turpëru se tash në Këshillin e Punëtorëve e ky me qëllim ka ba lojë njëfarë Sekretari, një malazezi, t’u thanë, “Na kena me shku në zgjedhje, kandidat është Hysamedini për zavendës, Toma për kryetar, për drejtor gjeneral. “S’kena” tha, “Toma” se te tanë e pranojshin edhe shqiptarë e serbë edhe që ish serb e pranojshin se ishte ekspert, nuk u përzijke kurgjo në këto sene.

“Po, Hysamedini krejt në rregull, po nuk e ka kualifikimin. Me status, me status nuk mundet”, ai thojke, “Mirë, mirë”. U kanë malazez ai sekretari, thotë, “Krejt i ka, me status e krejt ka me u ba.” E tash po ia nisë Këshilli Punëtor i Elektro-ekonomisë. Po zgjidhet Toma për drejtor gjeneral e ato rend u kry, e tash për zavendës-drejtor propozohet Hysamedin Azemi. Tash biografia, “E ka kry këto, e gjimnazin, e qysh shkon ajo, këto, këto, ka punu në Komitet, ka punu në Komitetin Qëndror të Serbisë e tash është... ka kry shkollën e mjeshtërvë”, se e kom në Obiliq që e pata tre vjet edhe shkollën për mjeshtër e shkolla e

lartë jam kanë mjeshtër i lartë, “i elektrikës që e ka kry për organizimin e punës edhe tha është... ka kry fakultetin e shkencave politike në Beograd është politolog i diplomuar”.

E tash këta u shfrynë këta do që u përgaditshin me kundërshtu zgjidhjen time, se kinse nuk kom fakultet. Në statusin e Elektro-ekonomisë ka qenë që drejtori gjeneral mundet me u zgjedhë nën një, elektro ose inxhinier i maqinerisë see u kanë qasi kombinati, po edhe ekonomist edhe jurist. A për zavendës-drejtorin duhet me pasë fakultet, në status nuk shkrun as këtë fakultet, për drejtor gjeneral, po, decidiv ka mujt me u zhgjedhë vetëm inxhinieri, njani ose në degën tjetër ose jurist ekonomist. A zëvendësi vetëm u dashtë me pasë fakultet, edhe nejse eksperiencë pune, jo tash naj fillestar me ardhë i cili s’e din [punën]. “Pos tjerave e dini që është një prej dhetë punëtorëve të parë të Elektro-ekonomisë cili ka punu edhe e njef Elektro-ekonominë e ato anej-knej”, e tash zgjedhja bohet një zëri, që ata turpërohen edhe kurgjo nuk bojnë. U zgjedha për zavendës-drejtor gjeneral.

E tona aty shumë punë të mëdhaja kishim, qatëherë u kanë zhvillimi, ndërtimi edhe ktyne elektranave tjera tri here 200 megavat të ndërtume, tona Kosova Bm ndërtimin e Kosovës B. Gjithëkun kom marrë pjesë kryesore si përfaqësues i Elektro-ekonomisë, sidomos ku ishin politike, se ai për ekspert u konë shumë ekspert, ai kryetari, drejtori. Po këtu këto punët tjera krejt mi ka lanë mu, me kadrovik, me bankën, me këshillin ekzekutiv së Kosovës, nëpër banka, nëpër këto shkojsha unë me eksperta, se në bankë nuk shkojsha une si përfaqësues, po e kisha drejtorin e financave, ekonomistin, juristin e krejt këto. Por, une ato sene i lujsha edhe politikën në elektro-ekonomi e përcjellsha, e tona aty këtu a kom pasë mundësi me kalu krejt Evropën, se ishin këto për shembull për Kosovën B u konë Franca me Gjermaninë, gjeneratori u kanë i Francës, kazani i Gjermanisë. Kontakte edhe mas nënshkrimeve, probleme të ndryshme gjithë janë shku nëpër Francë e Gjermani, e s’ka vend ku s’jam kanë.

Këto deri që edhe kom qenë edhe në Amerikë nja dy here, një here kena pasë një program për prodhimin e gazifikimit, se na ishim gjigand mos të harroj këtë me thonë. Na ishim qymyr edhe me energji, po na e ndërtojshim me gazifikimin, ndërtojshim fabrikën e azotikut, na u bojshim Kombinantin energjeto-kimik të Kosovës, kishim 13-14-15 mijë punëtorë, në gjirin tonë ishte edhe boksidi fabrikë... ai miniera e boksidit atje në Klinë, ish Feronikeli, Feronikeli u kanë, une s’di kur u nda tona, se u nda. U kanë në Bashkësi me Elektro-ekonomimë, se Feronikli u vendos me u ndërtu për qata që ish në gjirin e elektro-ekonomisë, ku na tona kishim energji, ajo harxhon shumë energji si tash që s’po punon, s’di a po punon e, që s’po ka energji.

Për qato ishin kuadrat e Elektro-ekonomisë për shkak resurseve si i kish Elektro-ekonomia edhe kur u ardhë situata që a me u ndërtu a... se patën shumë kundërshtime në ndërtimin e Feronikelit, se e kishte Shkupi Feronikelin po, nuk, nuk patën sukses nisën me prodhu edhe prodhun hekër, a Feronikelin na garantojshim që ka me pasë sukses, ka me prodhu nikël, edhe luftrat e mëdhaja janë ba edhe në Jugosllavi edhe Serbi, a me vazhdu Feronikeli, a me mbetë? Na, Kryesia e atëherëshme e Elektro-ekonomisë në këshillin përfundimar ku u... me udhëheqsinë e Kosovës kena bisedu, kena propozu mos të ndalet me Feronikeli me u konzervu, po me u ndërtu, edhe ky drejtori edhe une edhe stafi jonë atëhere.

Feronikeli ka nisë me u ndërto me shumë probleme, po u ndërto. Me probleme me Rusët, Rusët tona janë largu me tjerë i ka Feronikeli edhe kena arritë që me u prodhu feronikeli. I pari qasi fabrike që ka pasë, në Jugosllavi s'ka pasë prodhim të feronikelit. Kështu që, u kanë kanë pas lufta, dilema të mëdhaja i kena pasë me Kosovën në elektro-ekonomi. Gjigand jena kanë në çdo pikëpamje ekonomiksht edhe kadroviksht edhe si te dush me qindra kena pasë jurista, ekonomista, kena pasë inxhinera të çdo profili. Ambullanta jonë u kanë ma e fort se çdo klinikë e Prishtinës, se e kena pajisë, kena pasë mjekë specialista tona lloji, tona plot do mjekë specialista edhe i kena lshu me shku edhe në fakultet edhe në QKUK, kishim mundësi edhe e zhvillojshëm.

Tona ato degët e kishim qendrën shkollore në kuadër të Elektro-ekonomisë, u aftësuan tona te na krejt, shumica shqiptarë, serbët krejt ma pak, ma pak, edhe remontet i bojshin vet me ndihmën e konsultimeve ekspertëve të ndryshëm, po. Po krejt remontet i bojshim na edhe në krejt në... këto mihjet sipërfaqësore edhe në elektrana, u aftësua u banë qindra, njerëz me fakultete me eksperienca, gigand u ba përnime.

Aty e shtruan atëhere deri diku Ramiz Sadiku, Trepça. Po ti në Obiliq kur shkojshin në mëngjes me dhjetra autobusa transporti tonë prej Mitrovice, prej Podujeve punëtorët kanë me udhëtu në Elektro-ekonomi. Tona çka erdhën domethanë kam qenë edhe me këtë programin për amoniak në Amerikë, në Karolinën e Veriut. Atje ma së pari jena kanë në konsultim se ata dojshin me provu... amoniakun me prodhu prej qymyrit Amerika, por dojshin me bo eksperiment te dikush. E atëhere masi na ishim, e bojshim qat' punë e ndërtojshim gazifikimin, për fat të keq s'kena pasë sukses. Amoniaku ka rrjedh po s'ka mujt edhe tash sa veç ndërtesa a ekziston aty, a nuk ekziston.

Në krye të qatij komisioni që u merrshin me këto kom qenë unë, aty kam pasë eksperta sidomos të fushës së shëndetësisë. E në Karolina është drejtori i qasaj insitutit North Carolina, u konë gjithë me ngat institutit, kryetar i nderit është zgjedhë kryetari i Amerikës që qaq Amerika i jep randësi... u konë besoj që edhe tash është, i jep rëndësi po mendoj...

**Anita Susuri:** Qatij institutit?

**Hysamedin Azemi:** Jo, po pastërtisë së arjit e ekologjisë e këto shumë i kushton [kujdes] Amerika. Edhe atje tona e kena pasë një simpozium në Miami Beach, edhe tona jena kanë nëpër do qytete. A herën tjetër kom pasë biseda me eksperta e mi në bankën ndërkombëtare në Washington edhe aty jam kanë në New York, Washington, Los Angeles. E këto edhe në Washington jena kanë bisedat e, këta drejtorja e banka... banka ndërkombëtare. Kështu që, kom pasë shumë aktivitete me Kosovë u bojshim absolutisht prodhuesi ma i madh në, në Jugosllavi, në Kosovë. Ma vonë na kalun ato po, po, qatëhere, në qat' moment na e kishim me dy Kosovën B. Me 600 edhe knej 600 i kishim ka 1200 - 300 megavat energji elektrike, i... i prodhojshim. Kështu që, kishim energji *wolt*, kur tona aty kena pasë edhe une isha edhe anëtar i bordit kryesor të Bashkësisë Elektro-ekonomisë të Jugosllavisë si zavendës-drejtori. Edhe aty e kena pasë po du me cekë posaqërisht që na blejshim energji, po mendoj

si Jugosllavi, ish-Jugosllavi, Serbi, Kosovë, këto. Blejshim energji prej Shqipërisë, se Shqipëria kish energji sa dush pa kurrfarë harxhimi s'kish.

Ata e kishin aty ktu dikush sobë, se shporetit i thojnë sobë, se ati të shporetit i thojnë sobë. Nuk kishin shpenzime e i kishin bo elektranat, e po na energji blejke Jugosllavia, Bashkësia Elektro-energjetike e Jugosllavisë, blejke energji prej Shqipërie edhe ma së shumti për diçka, për Mal të Zi, po Maqedonia s'kish rrymë, atëhere energjia shkoi në Shqipëri, Mal i Zi, Kosovë, e tona në Maqedoni. Na e bëmë një kërkesë që me këtë Bashkësinë e "Jugerli" u qujke ajo serbisht, Bashkësia Elektro-energjetike e Jugosllavisë që me bo ni largpërçues Shqipëri-Kosovë. Kështu që, energjia mos shetitë tash rreth e rrotull se u bojshin shpenzime, se rryma, edhe rryma është transport. Siç është transporti hekurudhor, e këto krejt janë shënume si transport. Si hin rryma prej Shqipërisë në Mal të Zi deri o në Mal të Zi, Mal të Zi prej Malit të Zi në Kosovë, prej Kosovës në Maqedoni u bohke e kushtueshme energjia.

Eh atëhere Këshilli Drejtues të cilin kisha ndiku edhe isha kryetar i Këshillit Drejtues të Elektro-ekonomisë të Jugosllavisë, u morëm vesh që mu ba largpërçuesi Vau i Dejës - Prizren. Largpërçuesi 110 kilovoltësh, e kom udhëheqë si zavendës-drejtor gjeneral i Elektro-ekonomisë. Ai u kanë projekt i Jugosllavisë, Bashkësisë "Jugerlit" qashtu u thirrke ai, Bashkësia Elektro-energjetike, po nën financimin e asaj po na bijke neve me hise na me udhëheqë se ish në territorin e Kosovës. Kështu që, atëhere une u emërova edhe si njeri i cili e udhëheq këtë punë, ndërtimin e largpërçuesit Vau i Dejës - Prizren, Shqipëri.

## Pjesa e Pestë

**Hysamedin Azemi:** Në Amerikë isha me një grup ekspertësh, nja gjashtë, shtatë ekspertë të cilët, thashë, po punojshin për këtë projekt. Kështu që, ishte një problem i madh se prodhimi i gazit, e prodhojshim gazin mirëpo për ma tutje, kishim problem se na dojshim me prodhu amoniakun. E mirëpo ai projekt nuk shkoi qysh duhet. Prandaj ne, si thashë në Amerikë atëhere shkua me një grup ekspertësh, si thashë në North Carolina. Prej North Carolina shkum në shumë qytete dhe të Amerikës edhe normalisht në Washington, në Washington, në Bankën Ndërkombëtare [Botërore]. Atëhere ishte edhe ky Riza Sapunxhiu, i cili pat qenë një kohë drejtor gjeneral i [Bashkësisë] Elektro-ekonomisë me të cilën pata punu si në Elektro-ekonomi, ai ish për një pjesë të Ballkanit, drejtor ekzekutiv në Bankën Ndërkombëtare të... Botërore, edhe aty u pritëm shumë mirë prej tina, i shpjegua për qeto programet që e kena me amoniak e me këto.

Eh... mandej, prej aty u tona kthym prapë në New York e në... u kthym në Jugosllavi edhe në Kosovë. Kështu që, ishte një program shumë interesant por kurrë nuk u zbatu, nuk mujtëm ne pra. Një moment kena prodhu pak amoniak, por ai ishte shumë një teknologji specifike ku duhet diciplina e madhe energjetike, s'guxon me u ndal rryma, s'guxon kjo, s'guxon ajo. Shkurt dështoi, dështoi amoniaku, mbet azotiku si e prodhojshim azot, këso plehëra azotike. Kurse ajo pjesa kimike dështoi. Kështu që, ni situatë ke boll kaotike atëhere, se u duhke kiminë me ndalu, nuk ka, gasifikimi pak punojke dhe ato

kryesisht e vujshim për feronikel, se prodhimi i feronikelit tona u bazojke në gaz edhe në energji të madhe e cila u duhke me u ba.

Kështu që, situata krejt ndryshe tona u bo, vazhdojke energjetika. Kjo, feronikeli me probleme të mëdhaja vazhdoi edhe u kry edhe u prodhu nikëli i parë. Edhe sot hala mundet me prodhu, po apet tash ka probleme me energji, edhe u konë në kuadër të Elektro-ekonomisë. Prandaj kjo gzasifikimi nuk pat... nuk pat sukses. Edhe që na si Kosovë e kena ndërtu infrastrukturën, gaz pak shumë din në popull se shumë vjet po kalojnë njerëzit s'po dijnë. Për shembull, nuk din shumë njerëz se gaz-përcjellësin e kena në Mitrovicë, Zveçan edhe Shkup. Po ajo nëntokë është e pashfrytëzume, po ama teknikisht une... tash me u shfrytëzuar ajo une nuk di, por osht' gaz-përçuesi i ndërtum, rrin nëntokë po ngase nuk, nuk patëm fat me bo gazifikim edhe ato vetëm gypat janë ndër tokë deri Zveçan edhe deri në hekuranën e Shkupit.

Kështu që, është një situatë kur shumë aktivitete kish atëhere Elektro-ekonomia, ishte gjigand përnime i madh, me kimi e me ngrohëtoe e me termoncentrale me këto. Mirëpo, situata ishte ashtu qysh ishte edhe jeta vazhdojke ma tutje. Unë isha atëhere si zavendës-drejtori, pastaj u ba ndryshimi edhe Ilaz Kurteshi për kryetar të [Bashkësisë] Elektro-ekonomisë. E tona u ba ndryshimi edhe atje edhe ai erdhi për ma shkurt, se ai s'më priti për me vazhdu me u ba kryetar në Partinë [Komuniste] e Kosovës e tona erdh në krye të Elektro-ekonomisë.

Atëhere u bo si një farë reforme, u bo ni Kryesia me kryetarë, tona edhe distribucioni u bashku u ba krejt bashkë e patëm tona si Kosovë, prodhimin, bartjen edhe distribucionin. Se bartja ka qenë deri vonë në kuadër të Serbisë, a distribucioni domethanë tensioni i ulët edhe prodhimi jena kanë bashkë, a ajo bartja u kanë jashtë sistemit energjetik të Elektro-ekonomisë. Mirëpo, atëhere krejt këto janë hy në Elektro-ekonomi edhe tona jena ba një fuqi bajagi e madhe energjetike.

Mandej, aty tona meta une në këtë... ekipen e re në Kryesi, si ni prej anëtarëve, jena kanë tre a katër anëtarë të Kryesisë. Ilaz Kurteshi ke kryetar, une ma shumë u merrsha me nënkryetarë për organizime për kadrovike këto jena kanë edhe dy-tre nënkryetarë tjerë. Kështu që, erdhi situata që me bo edhe ndryshime të ndryshme kadrovike, se Ilazi u kthejke në Parti, aty ishin edhe do kandidatë tjerë mes tyre edhe une isha. Mirëpo u zgjodh dikush tjetër, jo që u pritke prej te tonëve që une do të zgjidhna po u... u zgjidh njo tjetër, sepse edhe atëhere gjithë ka pasë edhe ka edhe grupe edhe klane edhe ato. Une isha një njeri që punë-shtëpi, nuk kisha as nëpër kafe s'ka mujt me më gjetë kërkush, as nëpër do rrugë tjera, por punë-shtëpi, familja-puna qato e kom pasë ashtu.

Atëhere, u ba njëfarë marrëveshje që une me u largu prej [Bashkësisë] Elektro-ekonomisë me shku me naj funksion tjetër edhe propozimet ishin të ndryshme, jo me shku në Parti për Sekretar Ekzekutiv, jo çka. Une nuk pranova, se nuk dojsha me pranu. Thashë, "Une para gjashtë-shtatë vjetëve jom kanë në Republikë, Komitetin Ekzekutiv, anëtar i Kryesisë edhe Këshillit Ekzekutiv të Republikës, edhe tash me u ba një prej Sekretarëve", se ishin... qashtu organizimi Partisë ke, isha një prej anëtarëve të Kryesive për që udhëhiqtem për shembull marrëdhënje ekonomiko-shoqërore e këto, edhe kish një sekretar, sekretar që u qujke për ato, një lloj sekretari. Thashë, "Jo, une s'jom i interesum, une jam i interesum

si... i pengoj këtu dikujna. Atëhere më kthyni në Elektro-ekonomi në elektrana, ku kom punu prej fillimit edhe njoh punën edhe muj punu edhe s'kërkoj as kurrfarë vendi udhëheqës. Po du me u kthy atje me punu”.

Atëhere, tona goxha u banë do farë mosmarrëveshje, marrëveshje në nivel të krahinës, e ku, e çka. Aty, shkurt nuk më dojshin do me mbetë tash atyne në Elektro-ekonomi, se i kishin interesat ata do tjera. Shkurt e dijsin se çka mendoj une edhe e thom, nuk duroj kurgjo padrejtësi anej knej... edhe nuk i, nuk um... nuk i pëlqejsha ni grupi të... punëtorëve jo, punëtorët me i vetë isha numër një, por nuk u vetke as qatëhere punëtori as tash. Qekjo paria... po u caktojke filani e po u propozojke e udha e mbarë. Edhe u bo tjetërkush kryetar i Elektro-ekonomisë, une atëhere mbeta, hala isha një prej nënkryetarëve, nuk pranova me shku në Partia e këto. Thashë, “Nuk jam i interesum. Une du me u kthy në Elektro-ekonomi. Me mbetë në Elektro-ekonomi, me mbetë në Elektro-ekonomi, por në elektrana. Aty jom prej fillimit e tona”.

Mirëpo, në ndërkohë hapet mundësia se kryetar i Odës Ekonomike, ka qenë një i Gjakovës, nifarë Kusari, ai ekspert i i... gjakovar, ai zgjidhet në Gjakovë për një ndërmarrje gjakovare, tash s'po më bjen mend taman, për drejtor gjeneral edhe vendi ku u kanë qenë ai mbeti vakant. Atëhere ata, këta të nivelit krahinor më ofruan me u bo, “A e marr... a don me u ba kryetar i Odës Ekonomike?” “Po”, thashë.

**Anita Susuri:** Në cilin vit ka qenë kjo?

**Hysamedin Azemi:** Kjo është viti 1984 deri '86, '84 deri '86 u propozua për kryetar të Odës Ekonomike të Kosovës, une edhe ashtu isha kryetar i Kryesisë, si përfaqësues i Elektro-ekonomisë aty. Isha, po edhe toni ky Kusari shkoi në... për një drejtor gjeneral po harroj tash, po më duket kombinatin e Gjakovës. Une erdha për kryetar të Odës Ekonomike, të parën herë. Domethanë është viti '84 deri '86 kom qenë.

**Anita Susuri:** Po du me ju pyet pak për vitet e '80-ta, atëherë kur kanë qenë demonstratat, ka qenë një periudhë pak e vështirë. Qysh e keni pa ju, qysh e keni përjetu ju qato?

**Hysamedin Azemi:** Eh, po tash, me të thanë më duket vetja atëhere, është ajo periudhë kur jom kanë në Elektro-ekonomi po si nënkryetar me Ilaz Kurteshin e me këta. U kanë një gjendje shumë e vështirë e shumë kaotike. Une isha i angazhum boll. Atëhere jom kanë edhe anëtar i Komitetit Qëndror të Serbisë edhe kështu që në atë, në ato... demonstratat e '81-ës po thuni ju a? [i drejtohet intervistueses]

**Anita Susuri:** Po.

**Hysamedin Azemi:** Po, po aty shumë randë situata ka qenë. Na ishim atje në, në shënjestër goxha të madhe, se ishim gjigantë [ekonomik], ishim me ndikim të madh. Atëhere aty ish... edhe bashkë me Ilaz Kurteshin jam kanë. Une si një, një prej nënkryetarëve. Na kena pasë shumë situatën e randë, se

ata erdhën e u stacionun me tanke në udhëkryqin e Elektro-ekonomisë, bashkë me Ilaz Kurteshin edhe une me to kena dalë para tyne atëhere m'i ndalë e me bisedu e këto. Mirëpo, situata veç që s'ka eskalu e me sulmu në puntorinë. Shumë situata ka qenë e keqe, e randë. U banën ato demonstratat qysh u bonë. Kërkesat diqysh nuk mujshe me i thonë që nuk janë, ishin kërkesat për... na i thojshim që kërkesat janë të studentëve, për menze e për këto, po ajo nuk dul ashtu, po dul ndryshe. Po edhe vetë këta tonët që ishin organizatorë dojshin me thanë që nuk osht' ajo, po na jena për kërkesa politike për... për Kosovën Republikë e për krejt ato sene. Kështu që, me... për pak e kena ndalë na, bashkë me Ilazin, me hi ata me ushtri nëpër Elektro-ekonomi. Dojshin me demonstroi fuqinë ushtarake që e kanë.

**Anita Susuri:** E pse me ndërhy aty?

**Hysamedin Azemi:** Kurgjo vetëm me bo trazime në Kosovë, kontrolla kishe me dalë. Tona asaj atëhere jena kanë edhe në... kom qenë njihere edhe në Beograd te Millosheviqi me këtë Sekulliqin, Sekretarin e Komitetit edhe me këtë... ky Jusuf Zejnullahu, se ai ishte atëhere si qeveri edhe me Sekulliqin atëhere jena kanë, lypëm me shku te Millosheviqi. Kur shkum atje, ai, këtë Sekulliqi u kanë Sekretar atëhere. E herë e dojke, here s'e dojke, s'e dojke diçka se nuk i shkojke diçka për qejfi. Edhe kur shkuam atje, ai thotë, "Mundeni me ardhë këtu, por Sekulliqi jo." Ishte Jusuf Zejnullahu, une, edhe ky Sekulliqi edhe Rrahmani edhe ai thojke, "Ju, hini", tha, "ai s'mundet me hy" ky Sekulliqi. Une qaty në korridor, domethanë thashë, "Une pa të nuk hi. Në qoftë se ai nuk hin, as une nuk hi. Ti mbaje mbledhjen ndaq me këta". A dera qeshtu si çeltë, ai ulun atje në zyre, Millosheviqi. E pa që s'do të hyjë une, atëhere tha, "Hajt *udite* hyni", tha, "te tonë".

**Anita Susuri:** Kjo u kanë ma vonë ndoshta.

**Hysamedin Azemi:** Po de. Edhe tona ai thotë, "Kjo duhet me u ndalë. Duhet me këto. Na me u shty". Thashë, "Ti që shkon me ushtri e me polici, edhe une do të jem para popullit tem". Tha, "Të shkelim edhe ty". I thashë, "Shkelëm!" Deri qatje që ish, larg shkojke ai. Prandaj, tona une edhe tek dorëhekja s'kom dashtë me ndigju hiç ato sene që, që i thojke ai. Shumë u kanë në gjendje gjithçka me bo edhe nuk e dojke ato. Na i tham mo atina që, "Situata po eskalon, na s'mundem me u organizu edhe s'bon kështu me u... në Kosovë me u ba çka po bohet". Ai tha, "Ndashi me u ba, mirë, mos dashi", tha, "edhe juve". Thashë, "Une i dal përpara tenkit". Tha, "Edhe ty të shkelim". Shumë arrogant ka qenë, shumë. Edhe tona u kthyem mbrapa, edhe krejt tona situata shkoi qysh shkoi. Ato, tona, Fushë-Kosova e krejt këto sendet e ndryshme.

**Anita Susuri:** Po kthehemi edhe një here pak te viti '84 me postin e ri që e keni marrë.

**Hysamedin Azemi:** Ah, po. Posti i ri, une e mora me gjithë qejf se ish punë me ekonomi, isha aty e njëfsha Odën, se isha anëtari i kryesisë së Odës shumë vjet edhe aktivitetet i kishim hala relativisht të mira, hala nuk ishin ato problemet të cilat ma vonë u shfaqën. Dhe ku këtu jena kanë gjithë, po qaty pari, që me tregu: sistemi u kanë qashtu që Oda Ekonomike u kanë Oda e Afarizmit, nuk ka pasë



kurrfarë lidhje direkte as me Odën Ekonomike të Serbisë, por drejtë për drejtë me Odën Ekonomike të Jugosllavisë.

E dyta, u konë apolitike. Për shembull, une s'kom pasë të drejtë me marrë pjesë në Sindikata e Parti në udhëheqësi anej-knej si kryetar i Odës, nuk ke pasë të drejtë. Aty na kishim aktivitete me Parti, me Sindikat, po anëtarë, a kryetari u duhke me qenë totalisht apolitik. Mandej, në të njejtën kohë kryetari i Odës ish edhe anëtar i kryesisë së Odës Ekonomike të Jugosllavisë. Kështu që, une aty jam kanë shumë aktiv edhe në Odën Ekonomike të Jugosllavisë edhe në Odën e Kosovës.

Kështu që, në '84-'86-tën a, nuk ka pasë najfarë tollovia të mdhaja anej-knej, se ishte ajo kushtetuta, ishin do ingerenca të Kosovës i kish, veç që nuk u qujke Republikë edhe ish njëfarë mundësie e zhvillimit të madh, ish Fondi për... për zhvillimin e [krahinave] jo të zhvillime në të cilën Serbia merrke ma shumë pjesë që Republika ma e madhe. Edhe atëhere u ndërtuan fabrikat e ndryshme, na s'kena pasë komunë që s'ka pasë naj fabrikë, se u konë Fondi për zhvillimin e pa të zhvillimeve, s'di a keni ni për ato [i drejtohet intervistueses]. Edhe në bazë të atij Fondi na edhe ndërtojshim fabrika të ndryshme në tonë Kosovën.

Kështu që, ajo, krejt i kishin me organet Serbia edhe pa Vojvodinën, edhe pa neve s'ka mujt kurrfarë ligji as kurrfarë zgjedhje s'ka mujt me bo pa dakordimin me neve, se ishin qato do farë neni 300-301, i cili tona u kërkua me u ndërru. Edhe kur u ndërru, që në baza të tyne edhe Serbia e muri pushtetin edhe në Kosovë edhe u banë ato eliminimi i kuvendit, krejt tona mbrapa çka shkoi.

**Anita Susuri:** E pas vitit të '86-'87, thatë që deri '86-tën keni punu në Odën Ekonomike, apo?

**Hysamedin Azemi:** Po.

**Anita Susuri:** Qysh ka vazhdu tani, a keni kalu në Elektro-ekonomi?

**Hysamedin Azemi:** Pastaj prej Odës... jo... po! Jo, une jes jashtë Elektro-ekomomisë edhe met kontrata me Elektro-ekonominë qysh parën herë kur shkova në Komitet. E atëhere me ligj kom pasë të drejtë me pasë kontratën, kur m'skadon mandati në atë organ ku përzgjedhna, kom pasë të drejtë me u kthy. Po une në ndërkohë nuk u ktheva, se pa u kry ky mandat më propozun për kryetar të Lidhjes së Sindikatave të Kosovës. Kështu që, prej vitit '86 deri '88 kom qenë kryetar i Lidhjes së Sindikatave të Kosovës. Qaty tona dy... dy vjet.

Puna si Sindikat, qeto mbrojtje e drejtave punëtorëve, jena kanë shumë ma aktive edhe në atë kështu që... që Sindikati ka pas rol në atë sistem goxha të madh, s'ka mujt fort Sindikati bash do sene m'u zgjedhë edhe nej ndryshimi i madh aty nuk ka pasë në, në Sindikat. Pas... tona njejtë u kanë ajo edhe si kryetar i Sindikatit, automatkisht une jom kanë anëtar i Kryesisë Sindikale të Jugosllavisë.

Tona edhe atje i kom pasë aktivitete. Kom udhëheq delegacione, për shembull Sindikatat, Kongreset e Sindikatit të Rusisë, Mongolisë, kom udhëheq delegacionet e tyne edhe knej aktivitete qato në ato

Sindikatat e tyne. Kështu që u konë në një periudhë ku edhe zhvillimi i Kosovës ka pasë edhe me këtë kushtetutën e re, krejt ndryshe. Mirëpo, tona po vjen koha tjetër.

## Pjesa e Gjashtë

**Hysamedin Azemi:** Tash prej Sindikati po vjen koha po rrij une në Komitetin Komunal të Prishtinës, maj 1988, ni vjet jam kanë aty me kërkesën e shumë... s'kam pasë dëshirë me shku se situata nuk ish mirë. Ishin bo boll, probleme kish boll. Edhe atje edhe u konë njëfarë Ragipi, njëfarë profesori aty kryetar i Partisë bashkë me një serb sekretar, i cili u kërkoi me dhanë dorëheqje. Nuk kishin punu si duhet sipas vlerësimeve të organeve të ndryshme.

Atëhere më thërret mu ky kryetari i partisë që [Azem Vllasi](#) thotë, "Ish duftë me shku në Prishtinë për Sekretar Komitetit. U hamenda, nuk kisha qejf aty. Sa di une u konë propozimi edhe Isa Mustafa aty, se u kanë një prej sekretarëve, por ai mençëm s'kish pranë. E une rash si viktimë, "Duhet, situata është qështu e qështu. E Prishtinës na i vyn një njeri i cili ka me folë njëfarë pune aty anej-knej", edhe pranova. E qaty e bona gabimin tona në këtë rrugëtimin tem politik, që pranova. Prej distance tash me kqyrë s'u deshtë me pranë, po qe e pranova.

Erdha në një situatë kur nisën krejt këto ndryshimet e ndryshme, demonstratat, kërkesat, nënshkrimi i profesorëve, formimi i partiave të ndryshme, Rugova me këtë Shoqatën e shkrimtarëve, largimi prej Shoqatës letrare të Serbisë. Ajo krejt vijke Prishtina... ja cokatke krytë Prishtinës, se krahina ishte në nivel, këto komunitet tjera s'kishin asi probleme. Problemi ish në Prishtinë, se shkrimtarët e Rugova ish në Prishtinë, profesori, universiteti ishte në Prishtinë. E krejt ato tash vijshin edhe në kokën teme të asaj... ato krejt, ato kërkesat e ndryshme që u bonën edhe që thashë edhe për demonstratat edhe për këto e tona ndryshimet tona të kushtetutës, qetyne neneve 300-301, e të tjera.

Krejt mu më nxuni qat' afat, aty ku ishe zjarrmi kryesor ishte në Prishtinë. Ma lehtë e kish gjithkush edhe në krahinë te tonë, se ata lypshin angazhim prej Prishtinës, prej meje. Lypshim edhe prej meje çka me ba me Shoqatën e xehtarëve, çka me bo me ata profesorët që nënshkruan peticion, profesorë, 110 profesora të universitetit. Mirëpo, thashë, "Ju... ata janë profesorë të universitetit, janë Prishtina, por janë të universitetit të Kosovës, merrni ju". Dojshin me më shti une tash me... me u marrë me ta, m'i përjashtu prej Partie. Une nuk pranojsha, thojsha qashtu.

Thashë, "Edhe nëpër Serbi po kanë mendime të ndryshme njerëzit, se merre në Komitetin Krahinor le t'i merr në përgjegjësi". Edhe s'i kom marrë përgjegjësi kërkon prej atyne profesorave edhe që s'ka lidhje do vijshin edhe te une, "Çka të bojme, qysh të bojme?" Po une s'i kom marrë në... m'i përjashtu, se lypshin m'i përjashtu prej Partisë. Situata erdh deri qaty që... tona njeri s'dijke çka me bo me ato situata.

**Anita Susuri:** A ju kujtohet kur kanë fillu marshet që i kanë largu disa politikanë, Kaqushën e Azemin e këta? Ka fillu aty njëfarë, si lloj rebelimi pak prej njerëzve punëtorë, me marshe prej Trepçës, fillimisht minatorëve, pastaj...

**Hysamedin Azemi:** Me fotografia Titos e me...?

**Anita Susuri:** Po. Qysh ka qenë krejt kjo periudhë, ku jeni kanë krejt atë periudhë?

**Hysamedin Azemi:** Po, une... une që jom kanë në Komitet Komunal.

**Anita Susuri:** Po, po mendoj çfarë pozite keni qenë? Qysh ka qenë për juve ai përjetim, qajo krejt qysh është zhvillu? Prej prespektivës së juve.

**Hysamedin Azemi:** Patjetër. Na dojshim me i ndihmu punëtorëve, ata erdhën me flamura me fotografia të Titos e krejt knej. A knej mbrapavija ishte krejt diçka tjetër. Kështu që, edhe [Kaqusha \[Jashari\]](#) edhe Azemi... ata thirrshin, “O Kaqushë, o Azem anej-knej”, a knej në... në anën tjetër e shajshin Azemin. Kaqushën jo, por Azemin po. Po, është një... edhe aty mendojsa që po don me i ndihmu punëtorëve, po don me i ndihmu krejt. Ju s’e dini, krejt atëhere janë kanë policia e krejt Jugosllavisë u kanë këtu. Ju jeni të rinj [i drejtohet intervistueses], po baballarët e juve e dijnë. Prej qendrës e deri në Veternik, krejt polici u kanë edhe u kanë polici prej krejt Jugosllavie, edhe kroatë edhe sllovenë edhe malazezë e serbë e të Vojvodinës e krejt.

E nuk u kanë atëhere lehtë me u... me u gjind në atë situatë, se ata arritën që me bo Jugosllavinë për veti kundër neve. Kinse na tash shqiptarët po dojmë me rrëxu rendin e Jugosllavisë, që s’kish lidhje. Por ata e shfrytëzuan, Serbia. Janë kanë mjeshtër me shfrytëzu situatat që ndodhshin për aspiratat e tyre. Edhe kështu që ajo... këta u munduan kishe me u rikthy në politikë, po populli e dijsin kush janë.

**Anita Susuri:** E masi që i kanë largu Kaqushën edhe këto, qysh ka vazhdu masnej politika edhe në Prishtinë po edhe kështu në nivel qëndror?

**Hysamedin Azemi:** Po tash, atëhere veç ajo shkojke ka largimi total i te tonëve. Po ajo, edhe Kaqusha edhe ky janë, nuk janë largu vetë janë përjashtu. Edhe Kaqusha vetë në një bisedë të juven po më duket tha, “Une s’kom dhanë dorëhekje, po më kanë largu”. Po ato e kanë largu edhe shqiptarët edhe serbët e kanë... përnime u kanë... propozimi, kërkesa e Serbisë, po organet partiake të Kosovës e kanë përjashtu. Kur janë kanë shumica shqiptarë, ku janë kanë edhe do shokë e jarana të saj. Largimi i këtina... i këtij...

**Anita Susuri:** Vllasit?

**Hysamedin Azemi:** Vllasit. Ai kur u largu, ai... kur s’don kërkush kurrë me thonë le ato, ai është ai që ka thanë kontra-revolucioni në Komitet Krahinor. Interesant, as Mahmuti ky... ky o problem, kush u

konë? Tha, “Do të rinj, të rinjët e kanë thonë.” Ai Mahmuti s’e ka thanë, e ka thanë ky, kontra-revolucion e ka thanë. A tona dul që, veç se s’kajke në Kryesinë e Jugosllavisë. “Ju po më largoni mu prej Partie, a une jam ai që e kom... kom qiru hesapet me nacionalista, irredentista në Universitetin e Prishtinës”. Ato kërkush s’e thotë në Kosovëm s’don me thanë. Edhe e dijnë mirë që kush e ka thanë... kush e ka thanë e kush e ka ba ato.

A Kaqusha, ai shkoi e bani Kaqushën kryetare si pion. Më falni, po ajo aty u kanë veç figurë, krejt ka bo çka i thotë grupi i Azemit edhe që i ka pasë do aty. Edhe konkluzionet kur i bojke ai ia propozojke. Kjo niherë s’ka pasë aftësi, s’u kanë në politikë, u kanë pak në Sindikatë, u kanë në ndërtimtari, s’ka pasë kurrfarë vije. E më vonë meniherë, përiherë kryetare e partisë e me u ulë tash për ndryshimet kushtetuese me doktorat, profesorat e Kroacisë, Serbisë, Maqedonisë s’u kanë kollaj. Ajo thojke kurgjo... do ndryshime.

E prej Sindikatit u propozova të shkoj në Komitetin Komunal të Prishtinës, ku u kërkujke ndryshimi i kryetarit e sekretarit të atëhershëm. Jo bash me qejf e pranova, shkova në... në Komitet Komunal, bashkë me njëfarë Zhika në Mitrovicë që u kanë, u kanë vendas këtu i rrethit të Prishtinës. Edhe dihet ato vitet tona ‘88-‘89, vite shumë të randa, shumë... me shumë ngjarje politike të ndryshme. Une edhe aty u munova me vnu njëfarë rendi pak, po, po, ishte shumë zor se edhe i kish marrë dorën kjo... qysh me thanë, kërkesat e Serbisë.

**Anita Susuri:** Politika serbe.

**Hysamedin Azemi:** Politika e saj me hjek autonominë. Çunë kry tona atje shumë edhe serbët në Fushë-Kosovë e në ato... tona ma shumë u merrsha me qato punë, me mbledhjet e ndryshme. Une tana i kisha ata kryetarë, jam shku edhe në Fushë-Kosovë, u kanë njëfarë Keqmani, njëfarë, qeky Odalloviqi edhe do farë lidera të ndryshëm atje, cilët hyjshin si kapadai. Shkova në një mbledhje në Fushë-Kosovë, Kryesinë e Partisë tyne, pa ja nisë se kesh edhe me këtë Sekulliçin, hyn njani. “Kush je ti?” Dikush po thotë, “Nifarë Keqmani”. Thashë, “Çka punon ti këtu?” Tha, “Qe te ky Komitetit jonë këtu i... i këtij dega e Lidhjes edhe une jam anëtar”, thotë, “Anëtar je, por nuk je në Kryesi. Këtu jam une”.

“Kush të ka thirrë?” Po ma bon ky Sekulliçi, “Mo mos bon problem, të rrijnë qaty kurgjo s’na... nuk na pengon”. “Jo, jo”, thashë, “na pengon edhe mirë. Kjo mbledhje u ba me kërkesën teme, une jam Kryetari i Partisë së Prishtinës, ti je Sekretari i Komitetit Krahinor. Une ty të nderoj, a Keqmani nuk është anëtar i Sekretariatit të kësaj dege edhe nuk ka të drejtë me ardhë këtu, se na i kena do sene që i bisedojmë na”, thashë, “a po del ti, a po dal une?” “Ma bre Huqko, *nema*”. “S’ka *nema* ose...” Edhe e detyroj me largu prej atyhit edhe ato edhe qat’ farë Odalloviçin. Tash osht’ i njoftun në Serbi qai që ish për këtë të vdekurit tonë që ashtë qai Odalloviçi. A dini që po mirret në emër të Serbisë për... [i drejtohet intervistueses për ta pyetur].

**Anita Susuri:** Për të humburit.

**Hysamedin Azemi:** Për të humburit. Edhe atje njifarë kallaugji i tyne, qasi sene. “Tash deri jam une kryetar i Partisë këtu, ka me konë qysh tham une ose ju mundeni me vazhdu, une po dal po shkoj”. Atëhere ai duli e mbajtëm mbledhjen... mbajtëm mbledhjen, po ata me qata kërkesat e veta që kishin, “Duhemi me u shpërngulë, po shpërngulemi, bohemi e drej e...” Erdh Millosheviqi me Azemin, shkun atje në Fushë-Kosovë me i ndalë. Ata e ofendojshin Azemin çka s’i thojshin. Ky tha, “Mos keni gajle, s’guxon kërkush me ju prek”, Millosheviqi. Edhe krejt qato tollovijat e ndryshme, na s’ishim plot... s’kishim fuqi me u kundërvu, se këta e bindën edhe krejt republikat tjera që Kosova p’e shkatërron Jugosllavinë, jo Serbia, që Serbia po ka të drejtë, pa pasë hiç. Kështu që... shumë, shumë situata të vështira kena pasë. Ma së mrami tona u ba edhe ajo te përmendorja e atyne, ai takimi...

**Anita Susuri:** Gazimestan.

**Hysamedin Azemi:** Në Gazimestan. Une s’kom pranë me i bo shoqni, as s’kom qenë as s’kom... unë jam kanë në zyre. Ai i ka mbajtë ato mbledhjet e veta, s’kom pranë. Edhe tona po vjen situata tu u vështirësu, deri te ajo situatë tona kur po vijnë ditët e ndryshimit të atyne neneve e deri te marrja e autonomisë të Kosovës. Une s’kom qenë atje në ato se unë jam kanë... nuk jam kanë deputet për [me u përfshi në] votime, po, po kom marrë pjesë si anëtar i Kryesisë. Për shembull, një s’e kom ni kërkun, kërkush me e përmend.

Une do ta përmendi të parën herë te ju, që ato janë kanë propozimet e janë konë edhe në... nëpër organizata punuese, nëpër tona organizatat, ndryshimet e kushtetutës të Kosovës. Por nenet kryesore qato 300-301, ku me të cilat nene edhe u murrë autonomia e Kosovës, nuk ka qenë në diskutim. Ato e futi Serbia kur u bojke finalizimi i atyne propozimeve, e futi në qata... në atë dokumentacion. E e para... para se me dalë në kuvend, herën e fundit para kuvendit nja një javë e diçka u mbajt ni mbledhje, për të cilën s’kom ni une, dikush prej këtyre politikanëve kanë marrë, nashta që kanë marrë shumë dokumente, argumente, se une, se une jom kanë në Komunë Krahinore.

Kërkohet që një takim urgjent me u ba, Kryesia e Kosovës, Kryesia e Partisë edhe të... prej Serbisë. Një numër i [anëtarve të] Kryesisë e Partisë në Gërmi mbahet një mbledhje prej qetyne njerëzve. Në këtë mbledhje kom marrë edhe unë pjesë si anëtar i Kryesisë, si kryetar Partisë së Prishtinës jom konë edhe anëtar i Kryesisë së Lidhjes Komuniste të Kosovës. Aty jam konë në diskutime shumë të gjata shumë hershme, jonë kanë krejt qeta që e rrehnin gjyksin, s’pi përmendi, i dini. Aty u bonën diskutime të ndryshme.

Nën një, unë shpesh m’u duhke edhe me dalë se nonstop Prishtina naj problem kishte, më thirrshin në telefon. Prishtina kish problem, jo Komiteti Krahinor. Prishtina ishte qendra, krejt Komiteti Komunal i Prishtinës u lypke. Në ato, për hirë të vërtetës, të dy kanë vdekë por do t’i përmendi, është Nebi Gashi, është ky... tash po hupi prej mendjes i... u konë i këtij... s’po më bjen në mend, veç pak qysh... i Gjilanit ka qenë anëtar i Kryesisë, se s’po punon truri (qesh).

**Anita Susuri:** S’është problem.

**Hysamedin Azemi:** Ë?

**Anita Susuri:** Se ju kujtohet ndërkohë.

**Hysamedin Azemi:** Edhe une, na... tre jena kanë kundër, jo nuk u votu aty. Po me diskutim u shihke kush është për, a u aprovua me shku a jo. Me një lloj si aklamacioni. Une aty në diskutim shkoj indirekt i thom se atëhere ishte, ish njëfarë propozimi që ndërkohë do të ndërrohen edhe kushtetuta e Jugosllavisë e Serbisë e krejt. Atëherë, une propozova që këto nene të cilat nuk janë kanë hiç në diskutim në popull, mos t'i... tash të aprovojmë se masi kanë me u ba diskutimet në ndryshimet kushtetuese në Serbi, Jugosllavi qatëhere duhet t'i marrim në... diskutim.

A në realitet qato dy nene ishin qata që Serbia i dojke, se qato i mundësojshin që Serbia me e marrë autonominë e Kosovës edhe... edhe Nebi Gashi edhe une ashtu diskujtojshim. Nebi Gashi u kanë anëtar edhe kryetar i Kryesisë një kohë edhe u kanë anëtar i Kryesisë, Nebi Gashi. Eh, Shefqet Mustafa, ka qenë i treti, i cili ka qenë anëtar i Kryesisë së Kosovës të cilën e kryesojke Remzi Kolgeci si kryetar, a në emër të Partisë ishte Rrahman Morina. Por Rrahman Morinën e thirrën ndërkohë urgjentisht në Beograd. Për ditë, herë shkojke herë me helikoptera, anej-knej. Mbet ky Kolgeci te dy kryesitë a ky... ky shkoi, Rrahman Morina shkoi për Beograd.

Kështu që, aty tona u morë njëfarë “amini”, në të cilën Kolgeci del në telefon e po flet serbisht, po thotë, “Shef, u kry puna.” E une jam konë i njoftun pak që kom ditë edhe me dalë jashtë takti edhe me shajt edhe s’di çka. Plot ishin edhe gazetarë aty, plot sa të dush. E kurrë ni gazetar nuk u dalë kurrë në Kosovë me thonë të vërtetën, se shkojshin nëpër kafe me ta, pijshin hajshin edhe sene. A Hysamedini kurrë s’u shku në kafe, as me gazetarë, as me kond.

E ni, e njëj këta gazetarët, thashë, “Kujna bre po i raporton, shefit a?” Une, mendimi jem është që tu i dhonë raportin Millosheviqit që u kry puna, u kry puna. Une tona e shajta i thashë, “Boll mirë u kry puna. E kryve detyrën e shefit a? Qito edhe ti... ju i keni pasë edhe krejt e rrehin gjyksin, a qaty janë kanë në qat’ mbledhje, a na tre jena kanë. Jonë, ajo munet me u gjetë, se semogramat ekzistojnë. Ju si historiografë mundeni me gjetë ato, qat’ mbledhjen e Gërmisë të fundit, ku Kryesia e Partisë e Kryesia e Kosovës me të Serbisë e kanë pasë mbledhjen e fundit për ndryshimet e kushtetutës.

**Anita Susuri:** Kjo u kanë në ‘89-tën...

**Hysamedin Azemi:** Po, po, po.

**Anita Susuri:** Paraprakisht, po du me u kthy te greva e minatorëve një mujë më herët. Ku e dini, kanë kërku dorëheqjen e juve, Rrahman Morinës edhe Ali Shukriut. Domethanë, qysh ju ka ardhë ky lajm? A e keni prit diçka të tillë edhe pse ata e kanë... kanë kërku ju me dhanë dorëheqje.

**Hysamedin Azemi:** Që don me të kallxu, une jam befasu shumë kur ka ndodh ajo, se, le të flet kush çka do, kundërshtarët e mi i kom pasë une kundërshtarët mrena, se këto... e kanë pasë një tutë që me

ardhë me CV-në teme, me fjalorin tem, me angazhimin muj me ju marrë qito funksione të larta të Kosovës, Kryesinë, a Partinë. Une në disa mbledhje, është edhe në një dokument ku në një mbledhje ku une diskutoj në “Rilindje”, që kërkoj edhe prej Serbisë mos me m’bo mu “shqiptarë të mirë”<sup>10</sup> se une jam si shumica e shqiptarëve, as nuk jam... i mirë i keq, qai që jom.

Edhe nuk du që tash une... dikush me u marr me mu me... me kombinat me tyne politike e kuadrove, se nuk pranoj. Edhe une i kom thanë edhe qetyne shokëve, mos t’ju përmendi emnat, “Nuk jam i interesum për asnjë post të kryetarit. Jam i interesum si të më kalon qeky mandat këtu, me u kthy në Elektro-ekonomi”, edhe me kry si... si thojnë pleqtë me shku në vend të fundit e ku do të vdes në Elektro-ekonomi. “Edhe nuk kom ambicie me u ba asnjë kryetar, e mos u tutni prej meje. Mos më shantazhoni mu se nuk jam... une s’du, se muj me u bo”. Muj me u ba se u bojke. Kryesia e republikës të propozojke këtu kryesia bijshin dakord... ose u tutshin edhe u bojshe edhe që s’dojshin me të ba, u bojshe kryetar, ose çka po di.

Mirëpo në një bisedë une që e pata në universitetin e Prishtinës, në dekanat, une fola gjerë e gjatë për ato edhe kqyrsha sado me i... u munojsa me i mbrojt edhe universitetin edhe profesorat e këto, bojsha do farë ksi. Kush e di, tash s’po di prej tashit, prej distance me thanë... në diskutim e sipër, hyn mur qajo fjalë që janë manipulu, dojsa m’i mbrojtë ato. Qe ti më vete qysh erdhën [i drejtohet intervistuesës], ata erdhën, ata erdhën prej Mitrovice me fotografi, “Tito... autonomi”, krejt këto po thirrshin Titon. E thirrshin ato, po une dojsa me i ndihmu. Po a e pave, a e keni pa ju në televizion dikun që e qesin me vite, qeto xehetarët me flamur e me fotografi e? [i drejtohet intervistuesës] Ato nuk ekzistojnë tash me u qitë dikun në Kosovë, ju nashta s’i keni pa kurrë [i drejtohet intervistuesës].

**Anita Susuri:** Fotografi kemi pa.

**Hysamedin Azemi:** Fotografi po, po qajo a e keni pa që po duken. E tona mendojsa, kur po vijnë ata me fotografi anej-knej. Une dojsa, mendojsa që hala Jugosllavia, hala është shumë e fort, edhe u kanë e fort. Dojsa me i mbrojt, xehetarët, edhe në kontekst të diskutimit e thom edhe qito, qito që janë manipulu xehetarët. Edhe e fundosi karrierën time politike, gjithë ato mundime që i kom ba.

**Anita Susuri:** Prej kujt ke mendu që janë bo?

**Hysamedin Azemi:** Politikanëve tonë, prej politikanëve tonë të Kosovës janë manipulu edhe janë marrë tash ata. S’kishin kaqik vetë me, me bo qesi far gjeste, e shtini tash xehetarët... qashtu mendojsa une prej distance. Tash o lehtë me folë, qysh e the, pse e the. Momenti politik kritik ke qashtu që mu ajo më pshtoi, tash s’e kisha thanë kurrë. Edhe s’mendoj që u kanë bash qashtu, po edhe thashë qat’ fjalë e tash ku është e vërteta tjetër? Une i kom pasë shokë të... kryesorëve, Bahriun kryetarin e Partisë atje, [Burhanin \[Kavaja\]](#) edhe këtë...

**Anita Susuri:** Azizin?

<sup>10</sup> “Shqiptarë të mirë” janë quajtur të gjithë ata shqiptarë që kanë bashkëpunuar me institucionet serbe në Kosovë pas heqjes së autonomisë më 23 mars, 1989.

**Hysamedin Azemi:** Azizin e kom pasë vendas të mirë edhe shok. Une si u ardhë letra... letra e parë që u ardhë, une s'di ku tona ka hup rastësisht, edhe une jam kanë aty në Komitet. Emri jem nuk ka figurë, u kanë vetëm këta dy janë kanë. Ndërkohë, kontaktet shkumja anej-knej, të nesrit kur janë shku ky...

**Anita Susuri:** Kolgeci?

**Hysamedin Azemi:** Kolgeci e Shuvari e krejt këta, qaty bashkë që ishin. Tona u hi emrin tem aty e kanë shti, jo xehetarët, po e ka shti dikush prej qetyne jaranave që kanë dashtë... une me konë i sulmumë prej xehetarëve edhe prej atyne edhe në realitet ata dojshin me më likfidu si kandidat. Si kundërkandidat i tyne për shumë vene ku ata aspirojshin edhe arritën. Hyni [në listë emri im], kur përnjeherë une jam çuditë kur e kom dëgju, se une s'kisha kohë me nejt me ta, këta rrijshin te tonë bashkë.

Erdh Shuvari, me Shuvarin anej-knej e shkojshin, une s'kisha kohë se në Prishtinë, u kallke Prishtina në tona anët gjithë, jo këtu problem, jo këtu problem, jo në Fushë Kosovë problem, jo në konvikte problem, krejt hijnë në krye temin këto. Ata bojshin muhabetin Komiteti Krahninor, çka me bo edhe une s'muj me humb shpirtin me thanë kush, po emrin tem xehetarët të parën herë s'ma kan qitë. Burhani është gjallë, s'di a don me pranë, ai ka vdekë Bahriu, s'di a është gjallë. Une i kom thanë, "Kur të doni une jam i gatshëm me dhanë dorëheqje". Mirëpo, çfarë problematika u bohke, kopilia, shkojshin atje me minatorët edhe Shuvari edhe këta, bisedojshin.

Tona e kom pa edhe njëherë pak edhe Shuvarin në televizion, ku po i thotë atyne [minatorëve], "Që kam me dhanë dorëheqje". Shuvari thojke për ata, po sa [i përket] kërkesave politika e ato duhet me bisedu, e për qata ata mbetën veç dorëheqjen neve treve a ato me bisedu, s'po hjekin dorë minatorët prej kërkesave, republika e krejt ato, po po lypin na tre me u hjekë, a me bisedu tona për këto senet tjera. Edhe Shuvari i tha atina, "I pëlqej që këta le të shkojnë, po për ato sene politike duhet me bisedu me, me struktura me krejt atje". Edhe aty i thom edhe Bahriut edhe atyne njëqind here, "Kur doni une jepi dorëheqje". "Jo, Husko... nuk o niherë koha". Gjithë ma bojshin, "Nuk është koha, s'duhet me dhanë dorëheqje".

Knej i thojke Shuvari edhe këta i thojshin atyne, "Kanë me dhanë këta dorëheqje". Tona përditë u takojshim në mbramje deri në gjysë nate, thashethanave në Komitetin Komunal... asi Krahninor. A aty, "Jo me dhanë dorëheqje", e pash që, që nuk shkojke edhe i thërras une këta apet edhe njihere, edhe Burhanin edhe këta të... Atëhere thom, "O *zemljaka* [vendas], une du me dhanë dorëheqje, s'kam nevojë me mbetë këtu kur krejt populli çohet". Jo xehetarët, u çu krejt shqiptaria në botë, prej Amerike anej-knej. Bashkë me ta edhe emrin tem, gjithë, Hysamedin Azemi, Hysamedin. Lësho televizorin, Hysamedin Azemi, merre gazetën Hysamedin Azemi. Mo dojsha me u çmend mo. Duhet me kallxu, dojsha me u çmend. E dijsa veten e kom ba qat' gabim, po nuk jam bre qai që ja du të keqen.

Nuk du që me gjetë xehetarin një gisht [me damtu aspak], se une isha djali i xehetarit. Baba im xehetar aty 40 vjet, une vetë jom konë xehetar... mjeshtër elektrik në Kishnicë. Jom hi me xehetarë jom dalë me xehetarë. E kom pa qysh kur e fshijke fytyrën vetë e ata... i hjeke ato xehen e ato prej fytyrës. E une,



për një gisht të tyne e kisha ba. Edhe tona... mirëpo e muri ajo atë hovin e vetë, domethanë s'di a e kuptoni është... u konë një ofendim që thom që janë manipulu, jonë mashtru domethanë që thotë shqip, që thojshin. Une e kom përdorë qat' fjalë, tu e mendu me i ndihmu këtyne, po une në realitet aty s'i kom ndihmu atyne po as mu, mu jo se jo, po as atyne, as politikës të Kosovës [asaj] shqiptare. Tash prej distance kollaj është tash me folë, ka bo gabim e ka bo anej-knej, se anej-knej, u dashtë ashtu, u dashtë kështu, hajde tash e... e kom... e kom bo qat'.

Ai është gabimi jem, a harrohen mijëra diskutimet të tjera të cilat i kom pasë me Drazha Markoviçin, me Millosheviçin nëpër Komitetet Qëndror kur jam kanë, krejt atë, krejt ato janë harru veç mbahet mend që Hysamedin Azemi ka thanë, "Xehetarët janë manipulu". Edhe përnime në atë gjendje qysh ke, qysh u bo, krejt ajo situatë e çka dojke Serbia me shfrytëzu ato, u kanë gabimi jem shumë i madh, trashanik, i pafalshëm, edhe sot më bren qysh e thashë. Por e thashë, jo me ndonjë mbrapavijë kundër popullit, kundër xehetarëve, po me një vijë tu mendu me qetë kokë atëhere shumë ma herët, tu mendu që po i ndihmoj xhetarëve. Qaty është po s'disha as ku e kom krytë prej problemeve, prej krejt atyne.

Ajo tash me matë fjalë, nuk e mata fjalën e hangra. E tash kur vijshin këtu, aty apet... tona çdo mëngjes e mbajshim situatën e Kryesisë, ata që punojshin aty jo Kryesia e Komitetit Krahinor, me qita të parët anej-knej, me qeta gjithë Remzia e këta, anej-knej, qaty edhe diskutojshim çka me ba, gjithë aty edhe Shuvari edhe këta, "Jo me dhanë dorëheqje", une e pash që është loja kundër meje.

**Anita Susuri:** E pse ata s'dojshin ju me dhanë... me dhanë ju dorëheqje?

**Hysamedin Azemi:** Kush?

**Anita Susuri:** Këta në kryesi që kanë qenë ma...

**Hysamedin Azemi:** Jo kryesia tona tregoj që kryesia dojke, po qita të mdhejtë, Shuvari e këta nuk dojshin se... se, nuk dojshin, se i kishin tona. E une e kom marrë vesh që ky u konë një takim i cili u përgaditke, njëfarë mitingu i madh para... në Beograd, Dizdareviqi, Millosheviqi. Ku Millosheviqi e çon krejt Serbinë në këmbë që thotë, "*Ne čujem vas*" [Srb.: Nuk po ju dëgjoj] {vendos dorën tek veshi} kishe çka po kërkoni, anej-knej, ku e përmend edhe Azem Vllasin e krejt këta. Ka pasë me u mbajt nja dhetë ditë, a një javë ditë... qato ditë, edhe shkumja e jeme, jo vetëm si une, edhe une, po edhe kryetarit të Partisë të Prishtinës i ndryshojke shumë punët në Serbi edhe në Kosovë.

Jo tash une me thanë që jom kanë e dikush, po kryetari i Prishtinës, dorëhekja e jeme e parevokushme, shkumja prej Partisë me lanë partinë si me lonë krejt ishte një... shumë hendikep i madh edhe për Millosheviçin edhe Serbisë, për planet e tij të cilat i kish pasë ai, për të cilat une s'kom ditë. Bashkë me përkrahjen e Dizareviqit, atij boshnjakut që u kanë Kryetar i Kryesisë së Jugosllavisë anej-knej. E tash në këtë punë... kur une e pash, kalunë nja pesë a gjashtë, nja shtatë ditë, sa kalunë?

**Anita Susuri:** Prej mbledhjes a?

**Hysamedin Azemi:** Prej, prej... për greva, greva që vazhdojke. Une përditë Bahrisë e ktyne me i thonë, “A ta jepi dorëheqjen?” Ata tu i thonë atyne, “Jo, jo, thuni mos te jep dorëheqjen”, une s’e kom ni kërkun, po ata më thojshin, “Po këta shokë rreth teje mendojnë që s’duhesh me dhanë dorëheqjen”. Une tona mo e pash lojën edhe të këtyne shokëve të mi, po e pash edhe lojën e... e Kryetarit të Partisë Jugosllavisë, kishe që kërkush s’u konë, njëfarë kërkushi që ka luft majtap [shaka], ka luft majtap me to edhe Millosheviqi. Ishin konë ata apat në biseda atje, edhe atje tona i paskan thonë ktyne xehetarëve që, “Kanë me dhanë tash dorëheqje, me shkrim kanë me... me dhanë, e ju me dalë prej zgafelle”. Ato tona i kom kqyrë edhe une në televizor, ata s’kanë pranë, “Pa na çu me shkrim, na nuk dalim”. A mu as Rrahmani, ma me Alinë as që jam pa ma me ato, ai rrijke në Beograd s’guxojke me ardhë as këtu, as s’guxojke me ardhë as fizikisht. Kurrë kërkush, as ky Sekretari nuk um thojke mu që duhet me u ba qajo letra.

Tona po shoh që Rrahmani ka çu një letër në emër të vetë për veti, kërkush mu s’më ka folë as ka kërkun me mu me bo qat’ nënshkrimit e xehetarëve që edhe une me nënshkru që po jepi dorëheqje. Po kanë bo pazare me ta, krejt t’u luftë kryesisht me mu. Me mu mendojshin që une tash muj me... ty mu, ty më mbrojtë kishe mu, tu e mbrojtë vete. Une kur e kuptova atom erdhën këta prej Mitrovice, [Stipe] Shuvari<sup>11</sup>, ky e, ky e, e ulum qaty në zyre të kryetarit Rrahman Morinës. Aty tash po bisedojmë qysh kanë kalu anej-knej, e ky po tregon anej-knej. Thashë, “O kryetar”, i thashë ktina, “kjo lojë duhet me u ndalë”, thashë, “ju po shkoni” thashë “atje, po premtoni xehetarëve diçka tjetër, po vini këtu e mu po më thoni mos jep dorëheqje”. Atyne po i thotë që... që ka me dhanë dorëheqje edhe une edhe Rrahmani edhe ky.

Thashë, “Kjo nuk o në rregull”. A thashë, “Une jom djali i xehetarit, une...” thashë qato që ma përpara i thashë, “jam... si fëmijë, kur sirena bojke *auu-auuu-auuu* {me duar bën lëvizjen e sirenës} në Trepçë e dijsim që anej ka tragjedi. Jom dalë me nanë e me krejt për dore, e në hymje të minierës, në pllatinë”, se u thirrke pllatinë ajo... qajo karroca me katër rrota ku e qitshin gjenazen aty të vdekun. Thashë, “Une”, thashë, “jam qasi fëmijë që shoku jem kajke baba ish ai, a une u gëzojsha se nuk ish baba jem. E për një gisht të xehetarit”, me nderë me thanë edhe juve, p’e thom edhe në televizion, “une ma së pari ja kaj nanën dikujna këtu” që ishin ata shokët, “për një gisht të xehetarit, njëherë e likuidoju tona edhe veten e likuidoju për një gisht të xehetarit”.

“Aii bre” tha, “edhe une jam kanë edhe une jam djali i xehetarit”, Shuvari. Thashë, “Për ty nuk di që je kanë, për veten e di edhe e dijnë krejt bota që jom djali i xehetarit edhe s’kom pasë kërkush me më ndihmu në karrierë, s’jom kanë i asnjë familjes së njoftun”, asnjë shoqate as gjakovarëve, as gjilanasëve, as Prizren anej-knej, veç taman Azemi. Tonë janë çuditë, “Prej kahit dul ky Hysamedin Azemi? Djali i një xehetari atje kërkushi, as nuk është një familje e njoftun, as luftëtare, as... shkrimtare,

<sup>11</sup> Stipe Shuvari - Srb.: Stipe Šušar (1936-2004) ishte një politikan dhe sociolog kroat i cili konsiderohej të ishte një nga politikanët komunistë më me ndikim në Lidhjen e Komunistëve të Kroacisë në Republikën Socialiste të Kroacisë gjatë Jugosllavisë dhe më vonë në Kroacinë moderne.

as akademike, u bo tash udhëheqës në Beograd, këtu Elektro-ekonomi, e anej-knej”. Jom bo, por përkrahje të kërkujna, vetëm me punën teme, me sinqeritetin tem.

I thashë, “*Druže predsedniče* [Srb.: shoku kryetar], kjo lojë ka me u nalë”, thashë, “ti shumë...”. Tha, “Këta shokët e tu po më thojnë që njeri i mirë, punëtor i mirë, besnik, e shumë je trim e... i thu çka të don e anej-knej, çka mendon e anej-knej, mirë po” thotë, tha “une me ty me të kallxu se këta” tha “s’po dojnë me të kallxu, veç” tha, “shumë i pa përshtatshëm”. serbisht tha, “*Nezgodan za saradnju*, shumë i pa përshtatshëm je për bashkëpunim, po thojnë këta shokët e tu.” Qaty para tyne.

E thashë, “Për qato edhe une thashë qato, që me nda një gisht një xehetarit, une boj qato”, që ju thashë mos te përsërisë tash. “E une prej qëtij momenti”, thashë, “po ju thom natën e mirë, e une këtë problem do të zgjidhi vetë”. Edhe dal prej Komitetit edhe shkoj në shtëpi pa përcjelleje, s’kom pasë une përcjelleje. Shkova në shtëpi.

## Pjesa e Shtatë

**Hysamedin Azemi:** Kur shkova në shtëpi e mora telefonin e i thirra anëtarët e Kryesisë. Une nuk guxojsha me i thonë pse, por na i mbajshim mbledhje vonë si gjendje e jashtëzakonshme që e mbajsha kur t’i thirrsha me telefon vijshin në mbledhje Kryesia, tremdhetë anëtarë të Kryesisë. I marr në telefon, “Çka o rend dite?” Sidomos nuk dojsha m’i tregu serbëve se e dijsa që ata më sabotojnë, nuk vijnë në mbledhje. Thashë, “Gjendja politike aktuale këto, qato i kena, se kena me pru ni vendim”. Eh, i thirra rend me telefon, serbë e shqiptarë krejt. E caktova mbledhjen në ora nëntë, pa e ditë, pa e ditë hiç këta. Tona këtij... edhe e caktova mbledhjen edhe nuk ju tregova që për çka, çka kom rend dite. E bona njëfarë teksti të dorëhekjes, nashta e keni lexu najhere a jo? [i drejtohet intervistueses]. Edhe çohna, nuk flej gjithë natën, gja normale. Gruaja qaty rrijke me mu, ma bojke kajherë edhe ka një kafe. S’jom kanë marakli as i kafës, as i duhanit, as i rakisë. Që thojshin këta, “Ti s’je për kafe, për këto anej-knej, s’je as për udhëheqës.”

**Anita Susuri:** (qesh)

**Hysamedin Azemi:** Veç qeshtu, punë {mbyll sytë me duar}, shtëpi, si babush. Nejse, e thirri mbledhjen. Në mëngjes vij në Komitetin Krahinor drejt e tek Sekretari, ma së pari atina i thom Toma Sekulliçit, “Qeshtu qeshtu, qeshtu kom vendos, e kom thirrë këtë Kryesinë, në ora kaq e kom mbledhjen edhe puna po kryhet”. U konë serb, por serb nacionalist, jo i prishun. Nacionalist për Serbi, po, po shumë i drejtë. I ngrati, për qato Millosheviqi here e qitke, here e hjeke anej-knej. E pata punu une me to kur jom kanë të parën here si elektriçist, ky u konë drejtor i Kishnicës, qeky Sekulliçi. E jena njoft qysh atëherë, shumë njeri...

I dojke serbët, ani more nacionalisti ai osh’t... ai që e don të vetin duhesh me respektu, po pse tash ai me dashtë shqiptarin ma shumë se serbin ose muj me thanë po i du njejtë edhe serbët. Jo bre, vëlla, veç munesh me rrejt. Tha, “Me konë, *dogri* [vërtetë] me të kallxu krejt këtë shtypje që e ki ti në opinion

botëror...”, se ju të reja jeni s’e dini [U drejtohet të pranishmëve], po s’ka pasë lajm bre që s’na përmendke, s’ka pasë gazetë që s’na përmendke, me Deutsche Welle, me [Zëri i] Amerika, “Dorëhekje, dorëhekje, dorëhekje”. Xehetarët përmendshin njëhere, se ke njëhere ajo për opinionin botëror ke ajo xehetarët çka bonë, deri që edhe ata, tona edhe gjesti i... i sllovenëve që i përkrahën e krejt ato.

Edhe vërtetë u bo ni lajm botënor, xehetari, jo tash na tu hupë. Tona u përmendshëm edhe na që lypim dorëhekje, se jo na që u bomë, po u bonë xehetarët edhe tha, “*Dogri* [vërtetë] me të kallxu”, tha, “as une s’kisha mujt”, tha, “me... me majt ma në shpinë gjithë këtë kritikë e kërkesë. Në vend teje”, tha, “edhe unë qashtu të isha kanë une me serbë”, tha, “edhe kisha dhanë dorëhekje”. Mirë, shkova prej tina te Rrahmani, edhe Rrahmanit po i thom qeshtu. Edhe Rrahmani po më thotë qeshtu, qeshtu, po thotë, edhe mos me humbë prej shpirti, [ai] u kanë ma trim, ma shqiptar, ma patriot se shumë të tjerë. Une mendoj, kom punu me to.

Po, diçka u konë... një, ka pasë naj problem tona ma vonë a kom ni, kurrë s’e kom vërtetu, ka pasë naj problem në nivel jugosllav a diçka, s’di po më doket e kanë mbajt diçka në dorë, Serbia. E dyta, gruaja e tina... gruaja e tina, këto s’e din kërkush se ai u dekë, gruaja e tina s’di a u dekë. Edhe une dhe Rrahmani, erdha une po thom, “Rahman, qeshtu qeshtu, qeshtu”, thotë, “Husko edhe une”, tha, “do të jepi dorëhekje, unë po të besoj që s’kem... je shumë në zor edhe nuk o lehtë me bajt ato”. “Mos ashtu, jo këto bre”, thashë. Une i kisha djemtë e mi të axhës e i kisha të afërm, u çohshin kërkoshin dorëhekjen teme, familja më të ngushtë.

Qaq hini në popull edhe tona kurrë s’ja kom marrë për të keq. Tona kur u zatetsha, “O le bre, se t’ishe konë edhe ti, a ti”, thashë, “edhe une t’kisha lyp dorëhekje”. Se u bo ni opinion, u bo, të mijtë ma të ngushtit kërkoshin dorëhekje. Në mbledhje të Obiliqit, djali i axhës tem, këto, lypke dorëhekjen teme, po thom qeshtu, ai, “Dorën në zemër se edhe une”, tha, “do të jepi dorëhekje”, edhe besoj që kom insistu që edhe ky me dhanë dorëhekje, ky...

**Anita Susuri:** Ali Shukriu?

**Hysamedin Azemi:** Mirë, Ali Shukriu. N’ato tu folë ato, thashë, “Une e kom thirrë mbledhjen prej telefoni”. “Telefonin”, tha, “e kom pasë”, tha, “kryetar do gri mes veti ni telefon”. Special u konë, si tash që e ka Putini me Amerikën anej-knej. Edhe Jugosllavia e kanë pasë, qeta ma të mëdhejtë, kryetari i Serbisë me të Kosovës, me këto të Jugosllavisë e kanë pasë telefonin. *Xërrr* {onomatope} ai telefon ai po e çon, ja bojke ky zemër gruas. “Çka ka të re? Çka u ba?” Ky tha, “Qe Husko erdhi këtu”, tha, “do të jep dorëhekje, e ka thirrë Komitetin”. “Çka bre?” Po thotë ajo aty. U nijke krejt, se ai me qëllim e lijke me ndi une. U nijke telefoni se ishin qeshtu {afrohet me trup}.

Tha ajo, “Veç sa e kryva telefonin me shëfin”, me Millosheviqin, shëfi ishte Millosheviqi, “ai më ka thanë me bo çmos ti mos me dhanë dorëhekje, qe qitu para vetit e kom Kokin.” Se Kohan e ka pasë djali i tij emrin. Për vajzën s’po më bjen ndërmend, a Jehonë, a s’di. “Kokin këtu, une çika i kom helmin të përgaditun, qat’ moment që jep ti dorëhekje, kem me... hajde me na gjetë edhe me na varros”, ky

thojke.... Veç na dy ishim aty në telefon, ajo në atë telefonin special edhe ky në telefon special. U prish ky i ngrati, thashë, “Çka u bo? Rrahman, mos jep ti. Thuj barem që jo”. “Shuj mos të nin ajo” {bën me dorë në shenjë të shuaj}. Ajo nuk dike që jam une aty. E lutke ky, “Mo bre”, tha. “Le ti”, tha, “Hysamedinin. Hysamedini është shpiun i Shqipërisë, i Sigurimit”.

Për qato kur ju thashë une edhe për gruan teme, Dritën, ju thashë që ka lindë atje. Tha, “*Ti dobro*, ti mirë e din që ai grunë e ka”, tha, “të Shqipënisë. Ai është t’u punu me Sigurimin, që janë tu ba hulumtime për to që është shpiun. Mos e ngo ti, shpiun është i Shqipërisë! Mos gabo me dhanë dorëhekje! Ai le të...” U kanë njëfarë gruje serbe ajo, u kanë Buba Morina, njëfarë Bube, “Me të nanës”, tha, “ço në rrotë të samës Huskën”, tha, “ti mos jep dorëhekje.” E tash, a ka ndiku qajo, a që e kanë pasë diçka në grusht ato Serbia? Ai lëshoi pe, nuk dha dorëhekje. Më vjen keq, se kur shkum poshtë tona, u kry ai muhabet, e msheli ai telefonin. I tha asaj, “*Ajt nemoj da brineš ti, ima vremena* [srb.: mos u shqetëso ti, kom kohë], ashtu tha “po mendoj”, i tha, “po mendoj po kqyri”, tha, “nuk ka... mos bon budallaki... dorëhekje po jep Hysamedini se une, une kom thonë që do të jepi, po s’don me thanë që jepi!” Dojke me ja pushu asaj atë... ato, i meshlën telefonat.

Na shkuam poshtë se çdo ditë e majshin në mëngjes si ni kafe me pi, edhe biseda gjendjen, nuk kishim procesverbal me rend dite, po as jo Kryesia që është krejt normale, po ata që punojshin si profesionistë. Aty tona une thashë, Rrahmani ato, thashë, “Rrahman, une kom dy fjalë që nuk kom kohë me nejt”, thashë, “shokë”, thashë, “une kom vendos me dhanë dorëhekje të parevokueshme. E kom thirrë prom natën Kryesinë në teme, e kom caktu mbledhjen, veç dashta me ju informu që une tash e kom mbledhjen e do të jepi dorëhekje”. Rrahmani më përkrahi, edhe Rrahmani edhe aty tha, “Ke të drejtë se edhe une mendoj me dhanë edhe ky, edhe tha për këtë që do të jep dorëhekje”, e tha, “kështu që ajo punë...” Ja nisëm me diskutu anej-knej, shqiptarët tonë thojshin, “Po, shumë mirë ke bo”, serbët, “Kërrqysh”.

Mu më shtinë tash në sendviq shumë të palakmueshëm, kurrë s’uj me harru. Tash dilke serbët po më mbrojnë, shqiptarët po më sulmojnë. Deri edhe dove veç ja u disha, “Ti...” thashë. Dove [si] Kryetari i Rinisë u kanë njo, tona u kanë edhe kryetari i bankës anej-knej, “Leje... ti, ti je metë më thanë çka duhet me bo?” Thashë, “Une po ju thom te dyve, kjo ashtë e drejta jeme, une kom vendos personalisht edhe ato kom me bo. E dyta s’po më interson hiç, as juve shqiptarët që me dhanë, as këtyne serbëve mos me dhanë. Unë nuk du me u bo...” tona ato e kom përsëritë edhe në Komitet, “Nuk du me konë Kryetar i Partisë as i serbëve, as i shqiptarëve. Masi s’ujm me u bo... me konë qysh kokna konë deri tash edhe serbëve edhe shqiptarëve, edhe romëve, une për qato nuk du me konë mo kryetar. Edhe mos harxhoni fjalë e mos u munoni. Pini kafe”, thashë, “ditën e mirë, une shkova”.

Jam kanë pak përnime jo i përshtatshëm për do, do momente anej-knej, kom ditë edhe në të samës anej-knej, po kur më vijke qëtu {prek hundën}. U çova, ata nisën... vazhdu, u çova shkova në Komitet. Komiteti, “A jemi gati?” “Po janë ba *dneni red* [srb.: agjenda], “*Dnevni red zna se*” [srb.: agjenda dihet], i thashë Sekretarit. A me to isha shokë i mirë *dogri* [vërtetë] me të kallxu u kanë djalë i mirë. Tona u konë edhe Kryetar i Komunës, kurrë s’ka bo probleme, as shqiptarëve as kurgjo. Venali, do venali janë

konë... këta këtu janë konë ardhacakët të ndryshëm të rrezikshëm, serbë të rrezikshëm. Këta venalitetë janë kanë ma të butë edhe ata i kanë mbajtur këta si pijuna. Në pushtet janë kanë krejt ata që kanë ardhë prej Like, Kordune anej-knej, jo serbë venali që... qe ky Sekulli i janë kanë dy-tre [në pozita], krejt postet i kanë mbajtur serbët që janë ardhë, ardhacakët.

Tash thashë, qeshtu, qeshtu, pranoi. Thashë, “Ti duhesh me konë, me më zavendësu, kryes detyre edhe kurgjo tjetër, veç po të luti mos e refuzo” tha, “S’ka problem, u bo”, kur po thojnë do, po lajmërojnë thot, “Pritni tha edhe pak, se po vijmë prej Beogradit, a bon me shty edhe pak mbledhjen?” “As një minutë” thash, e kom pasë princip edhe ku jom kanë, 15 minuta akademike, kush vjen vjen, kush s’vjen une a kom forum? Ia kom nisë mbledhjet. S’kom dashtë me pritë kërkon, që don me ardhë hajde, që s’don mos hajde, qashtu edhe në Odë kom bo. Edhe thashë, “Ja, a janë ardhë këta?” Tha, “Janë ardhë krejt”. Pak pa u nisë kur... ah une e dijsa mirë që menjherë kur jom dalë une prej Komitetit, menjherë telefonat kanë punu me Beograd i kanë lajmru, që une po jepi dorëheqje.

A Millosheviqi kërrqysh mos me leju une me dhanë dorëheqje, se i kom vyjtë... i kom vyjtë për qato tubime edhe plane të tina çfare i ka pasë, çka po di une. Thom ja kanë lajmru ata jo ndryshe po helikopterin, me helikopter edhe njo u kanë po më doket i Komitetit Qëndror të Jugosllavisë, tre të Serbisë me... me helikopter në stadionin e Prishtinës. Une tamon po du me ja nisë, ata erdhën. Thashë, “Udhëroni!” Tha, “A bon një pauzë pak, nja pesë minuta të bisedojmë?” “Jo”, thashë, “une s’kom çka me bisedu. Ju jeni të mirëseardhun, jeni ardhë në një Komitet të Republikës, keni të drejtë me ardhë. Urdhnoni, rrini, merrni pjesë. A une me ndërpre mbledhjen nuk e kom ndërmend për kurrfarë pauze, une veç edhe një minutë une ja kisha nisë mbledhjes. Ju urrnoni.” “*A bre Husko, nemoj tako bre*” [Srb.: Husko, mos bre ashtu]. “Le ti”, thashë, “*nemoj tako* [Srb.: mosni ashtu]. Ulu... uluni edhe merrni pjesë”. E panë ata ku o puna edhe u ulën e tona diskutimi u bo qysh u bo. Une e dorëzova ato edhe tash aty nisën jo diskutime.

Serbët, “M’u tranu, kurqysh mos me dhanë dorëheqje”. Shqiptarët krejt, “Po, mirë është, duhet se situata, qe xehtarët, me i ndodh diçka xehtarëve tona... ku është tona situata anej-knej, qysh anej-knej e, edhe mendojm që shumë mirë po bon që po jep dorëheqje.” Dy-tre vetë qashtu, mu më kërsiti filmi... thashë, “A boni me nejt edhe pak ju lutem, une me status kam të drejtë me dhanë dorëheqje të paverokueshme, votim këtu s’ka, as s;po lyp me më votu, as me më përkrahë. Falemnderit për krejt ato që deri tash që kena punu e kena bashkëpunu. Une prej këtij momentit tash me qet konkluzë po i jepim fund. Une po jepi dorëheqje të paverokueshme, nën një. Nën dy, filani ka me më zavendësu sekretari qe këtu, e tona Kryesia ma vonë në procedura ato. Une prej këtij momenti...” E kisha bo çantën gati, krejt ato senet e mija, “Dal prej Komitetit edhe unë ma këtu nuk hy as në ndërtesë. A ka, a s’ka”, thashë, “pyetje që pyetët gjithë, a ka diçka? Ajo pyetje”, thashë, “sot nuk ekziston. Mbledhja u kry. Urime juve suksese, une shkova në shtëpi”.

Dal prej atyhit, ky nifare Kallaba a s’di qysh u konë, po më doket në Radio Prishtina që u kanë... emisioni rrjedh prej gazetarëve, kur emisioni rrjedh me çfarë do teme është tu rrjedh emisioni në televizor, radio, ndëprehet kur është një kataklizmë e madhe, kur vdekë naj kryetar i shtetit... a ky

dosti aty e ndëprenë emisionin e Radio Prishtinës e thotë, “Ndëgjues të dashur, një lajm nga Prishtina, para disa minutave dha dorëheqje Hysamedin Azemi”. Merre me mend etika, gazetarët, etika gazetare. A s’ujte [me prit] m’u kry ai emision e tona meniherë lamroje, qaq u ba ajo! Tona njëqind here më ka lyp tona falje kur e zatetsha në rrugë këtu. Se tona edhe ata u hjekën prej radio, hupën anej-knej, pikë e pesë. Edhe tona lajmet e krejt botës për dorëheqje u bo shumë e madhe, krejt, krejt... ma s’di. Tona kërkesa, tona ju tregova ty në telefon [i drejtohet intervistueses], kom pasë kërkesa prej Deutsche Welle deri te Zëri i Amerikës e gjithkah. Kurrë s’kom dashtë me dhanë asi [deklaratë], as me u angazhu, as me u marrë me këtë sport.

U dëshpërova aq shumë! Po njeri po rrojke, që mu doke me mujt qat moment *tap* {onomatope}, m’u kanë i vdekun e me... mbi vorret e katunit tem janë, nër asfaltt janë qato vorret e Bregajve e kushërinjëve të mi edhe Stanovcit tem, skaj asfaltit janë vorret. Se ma më pati ardhë qetu {prek hundën}, “Hysamedin Azemi, tradhëtar, me këto, ato”. Nuk mujsha me u barazu as me njanin, as me tjetrin. Sidomos me Ali Shukrinë, ku une ni punëtor kesh ni muj, vjet e tre muj Kryetar aty, e ata 40 - 50 vjet më gjetën mu tash me më barazu edhe me njanën me tjetrën me më bo... që mos me mujt me kqyrë as djalin as grun. Por për fat gruja e dike kush jam e çka jam, s’ma kthej shpinën as atëhere. Edhe u dha dorëheqja.

Çantën për dore edhe i thashë, “Urdhnoni në atë zyre”. Po i thom këtëj Sekretarit, “Të lutem qiti ka një kafe, çoji në drekë. Prej tashtit”, ani ata u bojshin qaq për tokë, budallë, “Po, hajde” tha, “të hamë një drekë bashkë, anej-knej”. Thashë, “Me ju a? Ja, falemnderit. Une mo s’kom këtu, kam dhanë dorëheqje. Tash paret e Komitetit s’du me i harxhu, ju jeni mysafirë”, thashë, “që me (qesh)... me Zhika Mitroviqin”, ai Sekretari, thashë, “me Zhikën, hani drekë me kto edhe udha e marë ju koft për Beograd ose rrini këtu në Komitet, çka të doni boni”. E mora çantën, dola.

I kom pasë do dokumenta, budallaki, kom pasë njëfarë libri aty, jonë kanë do farë emra anej-knej. Për budallaki e kom shkatërru e kam sos edhe ato, s’kom lanë kurgjo hiç me durë në xhepa jam dalë prej Komitetit edhe mo kurrë s’jom hi në Komitet. Tona shkova të nesrit te këta në Komitet, ata tona yrysh apet me majt edhe një Kryesi Prishtina, “Me u kthy!” “Qy, qy, me u kthy”. Ishin konkluzat, mbajt mbledhje, shqyrtu, lavdëru mu e, shaj ata, dikush shaj, dikush lavdëru po. Qata tona shqiptarë e serbë, votë që m’u kthy une për kryetar apet.

Qashtu Kryesia e Komiteti Krahinor edhe ajo mban mbledhje edhe lavdrata komuniste, po janë mundu me thanë, jo nacional... nationale por në zhagronin politik, “Je shumë i mirë, komunist, këto anej-knej edhe me u kthy”. Ose masi... ma së mbrami une s’pranoj kurqysh, atëhere me mbetë se une... si kryetar i Partisë të Prishtinës isha njëkohësisht edhe anëtar i Kryesisë Partisë të Kosovës. E bijnë vendim aty tona që une me vazhdu me punu aty në Komitet, si anëtar i Kryesisë pa kurrfarë... veç qaty, më jepshin rrogë.

Edhe tona vazhdova aty një kohë deri që u kryenë krejt punët qysh u krye, dulën xehetarët, dulën këtu, nisi jeta apet. Une mbeta anëtar i Kryesisë thjeshtë qaty me kërkesë që m’u kthy në Elektro-ekonomi. Me ligjet e atëhershme të Jugosllavisë, na kush... personi që shkojke në...në një pozicion, pozitë

politike, aii kur i kalojke, i skadojke mandati atje kish të drejtë me vazhdu punën, domethanë që une isha zavendës-drejtor mu aty. Mirëpo, në Elektro-ekonomi kom pasë të drejtë m'u kthy me ligj. Qashtu u kanë ligji, mirëpo shkun... nuk nejta shumë aty si anëtar i Kryesisë, ma dhanë një zyre qaty palidhje, vijshin do me më ngushëllu, e do vijshin kishe anej-knej. I dijsa mirë që kush ish që po më ngushëllon, kush jo. Nuk u përzijsa mo në politikë. I thashë, "Une mo me politikë s'mirrna".

Erdh propozimi që une të shkoj në qoftë se du për së dyti herë në Odën Ekonomike të Kosovës. Ato... e pranova se e dojsa atë pune, se ish jo politike. Ish organizatë ekonomike edhe më konvenojke me shku, se mendojsa që aty muj me dhanë kontributin tem si njohës i elektro-ekonomisë e krejt ato. Pranova, shkova prapë, më kandidunë, shkova. U zgjodha atje një zani. Veç e di që prej shoferit deri te sekretaresha shumë janë gëzu që jom shku se më kanë dashtë. Në fillim jam kanë shokë me ta, me te tonë, edhe me sekretarshën edhe me bashkëpunutorin edhe me krejt. Unë qasi kontakti kom pasë që e kom kultivu shoqnisht edhe me... edhe ma shumë e kom çmu atë që është në nivel ma të ulët, se ato në nivel të naltë anej-knej.

U zgjodha prapë kryetar i Odës Ekonomike. Tash aty do tu u tutë, tona u m'kanë tregu që jonë nisë pak me u tutë, që tash une i shti Sekretarin e Partisë atje, tona me i përzanë do prej Ode prej Partie, po kalunë do ditë e kalunë do... e kërkush s'i merrke në pyetje, as s'i përjashtojke. Toni e panë që une s'e kom atë detyrë. Deri që ju thashë një dyve, "O jarana, une s'jom ardhë me ju qitë prej Partie kërkund. Dilni vetë kush don", siç tona dulën vetë, "une jom ardhë për kryetar Ode". A Oda është jo politike, nuk lejojsha me mbajt mbledhje [politike] në... në Odë.

Kjo janë vitet '89-'91. '89-tën erdha prapë edhe një mandat dy-vjeçar. Ju thashë, u prita shumë mirë prej personelit. Ata ishin ma pak se 120 punëtorë, prej tyne njiqind janë konë me përvoja të ndryshme ekonomike, juridike, inzhinjera anej-knej, 20 janë kanë këtu nënpunësa, sekretaresha, anej-knej. Një staf shumë i fortë, po e thom me qëllim se tona në fund po du me bo një krahasim. Edhe aty tash po ja nis lufta e re, lufta me Sërbinë, vijnë tona masat e dhunshme, suspendohet kjo... autonomia, vuhën masat e dhunshme në ekonominë e Kosovës, largohen shqiptarët prej pune, i bijnë tyllfarë helaqa për me udhëheqë Trepçën, Elektro-ekonominë, tona "Rilindjen", televizionin, tona... ato sende të cilat une kërrqysh s'mujsha me i përbi.

Mirëpo, u mudojsa qëtë stafin tem me majtë në diciplinë, sepse ju thashë që lidhja, lidhja ime ishte vetëm vertikalisht edhe horizontalisht. Vertikalisht vetëm me Odën Ekonomike të Jugosllavisë, horizontalisht me tona... me fabrika me këto, me Serbi mysafirë jom konë kur më thirrshin në mbledhjet e tyre, mirëpo une dhe kundërshtova edhe qysh tash të shkoj. Une pa u ba kjo kundërshtimi i madh, shkoj në pushim në gusht në Asprovaltë në Greqi, kur atje tash vuhën masat une në pushim. Këta një pjesë e anëtarëve të Kryesisë e jo edhe do... jo bash dashamirës që me nderë me thonë qe me ma bo mu lojën, ndoshta dikush prej tyne, e bonën një letër e shkrunë ku e kundërshtojnë Serbinë për që i kanë vnu masat e dhunshme, pa prezencën teme, pa më marrë mu edhe në telefon barem anej-knej, se ka pasë telefon, kanë mujt me telefon po s'kanë dashtë e kanë ba ato. Kush e di çfarë



mendimi e kanë pasë, po s'kanë mujt me ma... qata që kanë dashtë me ma ba lojën s'kanë mujt, se une tona vehten e kom vërtetu çka është, ku është.

Une e marr, si e ni lajmin... e marr një laps e një telegram e ja shkruaj "Rilindjes" një telegram ku thom që, "Une jam në pushim në Greqi, e përkrahi letrën e anëtarëve të mi të Kryesisë Odës edhe... edhe nuk i pranoj këtë masat e dhunshme të Serbisë edhe i përkrahi këta... Odën" edhe telegramin e çoj në "Rilindje". "Rilindja", falemnderit shumë qato që ma kanë bo, e kanë faqen e parë po më doket e kanë qitë telegramin, "Hysamedin Azemi distancohet prej pushimit, i bashkëngjitet anëtarëve të Kryesisë të Odës Ekonomike edhe s'i pranon këto masat e dhunshme". E tash kur u ktheva mbas nja dy tri dite u ktheva, menjëherë çka ndodh tash a po më qet dikush, a po më len me hy në Odë, s'dijshja qysh do të shkojë ajo punë.

Erdha mbas dy-tri dite shkova pak si më vonë se gjithë shkojshja para shtatve, para tetonve. Po shkoj, s'po ka kërkush me më ndal, hyna, hyna në Odë, hyna në zyre, porosita kafën. "Çka ka?" Me sekretarëshën, "Çka ka tre? Çka ka?" "Qe valla", tha, "jom kanë në do farë takime", tha, do farë mbledhje", krejt me na i bo mirë. E thirra une tona Kryesinë teme, atëhere e kanë lexu tona edhe këto. "Ju falemnderova", thashë, "që e keni bo atë letrën, ma mirë që e keni bo se mos ta kishit bo, se mos e kishit bo ju atë letër une as s'e kisha ni për ato, une s'kisha reagu. Ju keni reagu edhe une reagova. Jena bashkë edhe po vazhdojmë jetën qitu në Odë qysh mundemi". Nisën tash trazime mes serbëve aty. Serbët shkojshin nëpër tubimet... në Beograd, ju s'i dini ato [i drejtohet intervistueses] me autobus shkojshin në protestën në Beograd.

**Anita Susuri:** Po, në mitingje.

**Hysamedin Azemi:** Po, në mitingje të ndryshme. Ti po dishe se ke pasë nevojë me kqyrë ato [i drejtohet intervistueses]. Mitingje, une s'mujshja me i ndalë, por tash u bonë tash... qysh me ja ba tash këtu? I ndalojshja, nuk lejojshja aktivitete politike as shqipëtare mbledhje partiake, sindiklae, anej-knej, sindikale, as serbe. "Kush don me mbajtë çfarëdo mbledhje, mbas orës tre, edhe me më lajmru mu edhe sekretaren me ju leju që me mbajt mbledhjen. Gjatë kohës së punës s'ka kurrfarë aktiviteti, as serbët as shqiptarët, as kërkush në Odë. Kush nuk i përmbahet kësaj, ka me dalë prej Ode". E u duhtën me pranë se e dijshin ai që une edhe ato e boj kush nuk më ngon. Na jena organizatë jo-politike, na jena Odë Ekonomike, na e kena punët tona, programet tona, partia, sindikati e ato i kanë punët e veta, le t'i zgjedhin. Ju që jeni anëtarë mundeni me i ngu, une s'muj, s'kam nevojë as me i ngu se une këtë moment si kryetar i Odës jam apartiak.

Edhe, tash po du me lidhë me... këta shkojshin u banë ato greva [Hajrullah] Gorani<sup>12</sup> që i bani, mbani në mend, grevat e mëdhaja që nëpër Prishtinë që dalshin, që... demonstrata nëpër Prishtinë për këtë. Para se me u bo, po thotë ai Gorani, thotë, "Qeshtu, qeshtu Hysamedin" ai ish konë në Odë para meje

<sup>12</sup> Hajrullah Gorani (1931-2020) profesor, sindikalist shqiptar dhe ish i burgosur politik nga Peja. Ai ka qenë kryetar i Bashkimit të Sindikatave të Pavarura të Kosovës, dhe njihet si udhëheqës i grevës së madhe të punëtorëve shqiptarë që u mbajt më 3 shtator, 1990.

kryetar... a bashkëpunëtor s'di. Thotë, “Shok kryetar, kurrfarë problemi s’ka. Une me dalë edhe une me gjithë qejf, po ti mirë e din që Oda Ekonomike është apolitike, une s’du me i dhonë material tash këtu me ardhë këta me më qitë me dhunë prej këtu që i kom ba naj... naj gabim, jo politik, po s’kom të drejtë ato sene me i bo se jam apolitik, jam Odë, mirrna me ekonomi. Se nuk o problem me dalë edhe une, po une në qoftë se dal aty me ty në greva.”

Që dulën punëtorët në grevat e Prishtinës, janë kanë greva të mëdhaja janë kanë, Sindikati i pat organizu, Gorani, “Tash une atëhere s’kom çka me u kthy këtu, s’kom tona mo autoritet se këtu kam edhe serbë edhe shqiptarë. Unë mendoj që ma mirë ashtë une me nejt në Odë qitu e me vazhdu punën, sesa me dalë e me metë Oda tash në dorë të tyne” tha, “Ke të drejtë”, a thashë, “punëtorëve i kom thanë kushdo mundet me dalë, lirisht e keni”, por për me ba tash nifarë barazimi, se serbët tona më kundërshtuan, thashë, “po në rregull është. As s’po ju ndali, as s’ju kom nalë juve që shkoni në Beograd, po sa here shkoni kam me ju hjek meditjen. As shqiptarëve, as ktyne s’kom me ju ndalu me dalë. Mirëpo ai që shkon jashtë për çfarëdo proteste në kohën e punës nuk e ka meditjen. A ju”, thashë, përditë dilni, ju knej, ju anej u kry puna”. E kryva punën me personelin tem edhe e dhashë qashtu.

Tona këta... edhe këta pak u ndalën se s’dojshin me ju hjek meditjen. Tona u bon do tjera sene edhe ma të lezeteshme. Shkojnë tash u afrojke zgjedhja ime, më kalojke mandati. Një grup i jaranave, ata pa dijen teme, se të mençëm, e formojnë Odën Ekonomike Shqipëtare. Nuk je në dijeni, çfarti, [i drejtohet intervistueses]. E formojnë tona pak valla po më duket e kanë hangër njëfarë burgu anej-knej. E jetë tash... po nisin zgjedhjet, une tash po i lus këta, i thashë, “Qysh po ja bajmë tash? A po jeni tash t’i bojme zgjedhjet?” Normal, se na aty ishim në Odë në Kryesi, 17-18 a 19 vetë, janë kanë nja dy-tre serbë, e njo ke musliman e anej-knej, tjerët jena kanë shqiptarë. “A po... çka po bojme?” “Jo”, tha, “na e kena Odën tonë”. “A? Po a? Ani”, i thashë, “Odën tonë”.

Puna e shqiptarve tash, logjika tash, situata. Atëhere gjo s’mujshin me bo me atë Odë, kurrfarë kontakti, me konë me bo? As me Shqipninë s’mujke me bo. Oda Ekonomike e Re e Shqipëtarëve, po kërkun, pa kurrfarë baze kurgjo. “Ani”, thashë, “ju në rregull. Une tash duhet me vazhdu zgjedhjet, po as une... masi ju s’po doni me marrë pjesë zgjedhjeve atje po ja dorzoj” thashë, “serbëve këto le t’i bojnë zgjedhjet” edhe qashtu edhe e boj, këta s’dojshin. Une atëhere, i lo këta m’u organizu, mu më lutën me mbetë apet kryetar une edhe prej Beogradit, “Jo, veçse me metë ti kryetar”. Thashë, “I kujna kryetar? Kryetar i serbëve a? Jo bre”, thashë, “une ma së pari”, thashë, “une, une s’e pranoj as masat, s’pi pranoj as këto. E tash une me pranu me u ba kryetar i Odës? Jo! Une”, thashë, “që e kom mandatin, shokët le t’i formojnë zgjedhjet”.

Këta serbët i bonën zgjedhjet. Shkunë nëpër organizata i zgjedhën serbë e s’e di a u kanë... mos me humbë shpirtin naj musliman a s’di, nashta edhe u kanë. I zgjedhën këta delegatët pa asnji shqiptar, une qaty rrisa në zyre, qaty bojsha seri. Naj telefon bojsha hala me këto, kurrë mo nuk guxojsa me shku as në Odë Ekonomike, të Serbisë mo hiç, Jugosllavisë po. Edhe tona qaty vazhdon ajo jeta ma tutje.

## Pjesa e Tetë

**Hysamedin Azemi:** Tash mbas këtij telegrami të ardhjes prej pushimit e aktivitetit matutjeshëm, une edhe zyrtarisht disa here u pronocova, si edhe tona edhe në biseda tjera nëpër Jugosllavi që ma këto asnjihere nuk i pranoj edhe kurrë në jetë nuk kam me i pranë. Edhe i ndëpreva tona mardhaniet me tona organizatat ku ish... ishte organi i dhunshëm, nuk bojsha kurrfarë kokumunikimi me ta, as me Odën Ekonomike të Serbisë, vetëm me Odën Ekonomike të Jugosllavisë. E, e u munojsha me bo kontakt me qeverinë e Jugosllavisë me Ante Markoviqin<sup>13</sup>, të cilin e njifsha, po ata ma shumë më njifshin se une ata. Se në atë moment na s’kishim mo në Kosovë kërkush që mujke dishka zyrtarisht me kontakt, se nuk kish mo. I vetmi shqiptar me qat’ funksion që u kanë Oda Ekonomike, isha une. I vetmi insitucion i cilli ish i Kosovës krejt, ish Oda Ekonomike.

E u munojsha me gjojtë... m’i zavendësu këto organet e tjera diqysh, sa mujta, sa mujsha e bona kontaktin e parë e kërkova kryetarin e qeverisë së Ante Markoviqit me më pranë me disa drejtora. Drejtorin e Bankës, të Tepçës, do... dihet kush janë kanë ata. S’po ja qëlloj emnave, tona po gaboj. Te Ante Markoviqi në Beograd, ai boni pritjen me disa anëtarë të qeverisë aty. Aty u konë në qeveri edhe Nazmi Mustafa, po pse s’ka marrë pjesë s’di. E unë atje me këta drejtora, u ulëm po presim, ky kish thirrë edhe prej Serbie, kish thirrë Markoviqi edhe të Odës edhe të qeverisë. Po si të ja nisim, a të ja nisim, a spo ja nisim? Po presim diçka, une sen s’dijsa çka po pritnin. Ja nisëm pak kështu me thanë jo zyrtarisht, po nisa me i thanë Markoviqit situata është katastrofike, masat nuk janë për me zgjidhë situatën ekonomike, jo prodhmi ato, jo fuqi punëtore tepër me hjek anej-knej, po është krejt diçka tjetër. “Përcjelle”, tha, “*Dobro* [srb.: Mirë], veç pak prit” tha deri të vjen p’e presim”, valla gati dhetë minuta.

E pijmë kafën, kur po vjen po kqyri po vjen Kiro Gligorovi, Kiro Gligorovi u kanë tana fazat edhe Titos, gjithë qaty afër sidomos në ekonomi. Ante Markoviqi e kish bo si këshilltar kryesor të tina. E ky Ante Markoviqi bojke do, nisi me bo do reforma, nisi se Jugosllavia nuk pat borxhe në momentin që... me Titon edhe krejt borxhet kanë shku, s’ka pasë Jugosllavia naj borxh të madh. Krejt ia falshin ata, kur shkojke me anije, u kthehke ja falshin borxhet. Po tash ky erdh Gligorovi, une... ja kishin thanë edhe ai më tha që me u ungj [ulë] një ai... protokollit tyne mu më qiti edhe ma poshtë, se une u çudita pse po më shtynë, se une jom ardhë te Markoviqi, po ata e banë vendin për Gligorovin.

Erdh Gligorovi u përshëndet me... me Antën edhe me mu u përshëndet. Tha “*Čekali smo te* [Srb.: Të pritëm]”, e pritëm pak. Jam msu do sene serbisht, po çka me bo kajherë, une kom nisë me harru se s’po flas (qesh). Tha, nisi me më tregu “Situata shumë keq”, tha. Për Zotin, mos lëkundsha prej këtuhit. Tha, “Ante”, tha, “*šta ti Husamedin kaže, ja njega znam kao još omladinca, još od prve konferencije SKJ. Kad je pred Maršalom kritikovao*” [Çfarë po të thotë Husamedini, unë atë e njoh që nga rinia, që prej mbledhjes së parë të LKJ-së. Kur para Marshallit ka kritikuar] (qesh) tha, “*sve one velike ljude i predlog da se to smanji i nacionalizam bilo koji i tako dalje*” [të gjithë ata njerëzit e mëdhenj dhe ka propozuar

<sup>13</sup> Ante Markoviqi - Serb.: Ante Marković (1924 – 2011) ishte politikan, biznesmen dhe inxhinier kroat dhe jugosllav. Markoviq shquhet më shumë për atë se ka shërbyer si kryeministër i fundit i RSFJ-së.

që të zvogëlohet çfarëdo lloj nacionalizmi dhe kështu me radhë] tha, “*njemu sve verujem šta kaže*” [atij i besoj çkado që flet]. Thashë, “*Hvala družē Kiro*” [srb.: Faleminderit shoku Kiro].

Ja nisi, Ante e çeli pak [takimin], “Qeshtu, qeshtu, Hysamedin Azemi, kryetar i Odës”, une kisha përgaditë një tekst, e lexova, i tregove krejt cilat ndërmarrje i kanë... i kanë qitë organet e dhunshme. Qysh për shembull, në Trepçë e kanë bo shefin e garazhdës automobilje, drejtor. Tham... për Trepçë, thashë, “Une jam i Trepçës i lindun në Trepçë, e rritë, Trepça ka pasë serbë e malalazezë, inxhiniera e eksperta, tona janë ardhë shqiptarët. [Minir Dushi](#) e tjerë doktorra të shkenca e anej-knej, qata janë kuadrat e Trepçës kanë ardhë. Po në fillim edhe serbët janë kanë eksperta të mëdhenjë në Trepçe, e tash qysh e degradut tash deri...” thashë, “more te kishit pru naj ekspert prej Insitutit të Xehetarisë e prej ndërmarrjes e Obrenovcit e dikon me pru. Përnime me pru dikon i cili don me rregullu situatën, se s’po shkon prodhimi anej-knej. Tona, a kokan tepricë e s’po punojnë, veç shqiptarët a ka aty edhe serbë edhe turq edhe muslimanë edhe goranë”, qesi ja futa une, edhe krejt qato ishin të vërteta, që kena pasë çka dush.

Tona edhe do vene tjera, i mora [si shembull] qeto Ballkanin e Suharekës, jo “Rilindjen”, jo televizionin, jo krejt i mora që edhe ma së mrami Elektro-ekonominë. Në Elektro-ekonomi u ardhë njëri, s’mujsha me thanë i keq se ish i fortë, u kanë Sekretar i Komitetit Krahinor të Kosovës njëfarë vakti, Pera Kostiqi. Autotokton i Prishtinës, u konë serb krejt këto, po s’u konë njeri i keq. “Perën e kanë...” thashë, “që e keni qit është edhe politikan edhe ekonomist. Mirëpo, une për herë të parë”, thashë, “po qet ti njerëzit, prej Beogradi po e çoni njerin që s’din as ku është gjeografikisht ka ka me shetitë, ku është reparti, ku o kjo kjo, kjo... e p’e boni drejtor. Çka është ajo?” Tona rend qeshtu krejt... krejt, e dhashë një, jo kritikë, një realitet. Mirë thashë, tona e diskutum me ata. Serbtë kundra, “*Hučko izmišlja* [Srb: Husko po shpif], nuk është e vërtetë. Aty s’po punohet, p’e bojkotojnë punën. A duhet me gjetë njerëz që punojnë? Po tash s’po dojnë me punu na duhet, s’kanë punu në Bellaqevc”, qe o Ujëmiri tash, Bellaqevc u thirrë përpara. Tash po më duket Ujëmirë, shqip e kanë përkthi.

Thotë, “Po na u duhtë me çu prej Obrenovcit, tana me punu njerëzit”, edhe tona ata më kundështun krejt këta. Une mo nuk hisha aty. Thashë, “Qeto janë fakte, mundemi me i vërtetu kur të doni. Mirë ish konë”, thashë, “në qoftë se ju...” Ky shoku, atëhere ishte shoku, shok ishim hala, “Shok kryetar, ju s’keni kohë, as s’po ju thërras, po kishit mujtë me çu një... disa anëtarë të juj, zavendës anej-knej, le të vjen... le të vijnë Kosovë edhe le te kqyrin vetë, me sy të veta le te vizitojnë organizatat, edhe une jam dakord që ata vijnë e thojnë që s’kam të drejtë. Unë atëhere kërkoi falje”. Edhe qashtu u konkludu që situata është e vështirë, ka [është] problematike, u përzi edhe politika.

Ante Markoviqi ishte me neve, ishte mik i jonë si kroat që tregojshin, si Stipe Mesiqi si edhe do të tjerë. Edhe tha, e krym na mbledhjen, më luti, tha, “Me folë me shefin e kabinetit diçka”. Thashë, “Ja, jo s’kam kohë.” “Për drekë?” Nuk u ndala. Thashë, “Kom... shumë punë kom edhe më duhet me u kthy menjëhere prej këtuhit”, ju falemnderova shumë atina edhe Gligorovit. Edhe Gligorovi foli edhe na përkrahi krejt, krejt... çka osht’, osht’, une s’muj me i thon. Tona ti mundesh thone, tona do thojshin

maqedon ai Gligorovi kështu, Gligorovi ashtu. Ai maqedoni e pshtoi [Maqedoninë] pa asnjë plumb, ai Gligorovi.

E tona u ktheva në Prishtinë, ai premtoi që do të çon një grup. Edhe përnime mas disa ditëve vjen delegacioni me, u konë... zavendësi i tij, njëfarë Pregli, Pregli po më doket, Anova ke diçka, nënkryetar i Këshillit Ekzekutiv slloven, ai edhe me disa bashkëpunëtorë të tina erdhën. Edhe aty une e bona një, bukur mirë një fjalim, edhe [ishte] mbledhje e hapun, gazetarët e krejt kush don, me argumente me krejt, diskutim do të... ai slloveni, goxha përkrahke po nuk guxojke bash kështu haptazi, “Duhet me kqyrë e me bo, nuk është mirë nëse kështu, nëse anej...” Po kryesisht ishim dakord me ato çka i thashë une.

Edhe kjo tona mori bujë shumë në gazetatat tona në “Rilindje” këta, shumë pozitiv për mu tash si ai i xehetarisë, që po muj punët mirë po tash po del knej as serbt gurë e dru ndaj meje, ndaj këto. Ata kundër, këta kundër. Etash u kry edhe ajo po shkon jeta. Deri tash një ndërmarje edhe një ndërmarje e bona. Që e luta... që në Kryesi të Jugosllavisë, i luta kolegët e mi të Sindikatit dhe të Odës që diqysh, që në nivel të Kryesisë të Jugosllavisë të diskutojmë këto. Edhe mas një kohe jo shumë gjatë, u thirrë ajo mbledhje, po ata nuk hezitun hiç se aty Serbia kish plane që me ndihmën e Sindikatit të Jugosllavisë e Odës Ekonomike të Jugosllavisë, e me do të tjerë, me e rrëxu qeverinë e Ante Markoviqit.

Ante Markoviqin dojshin me e rrxu. Jo për mu, që une kisha qejf me u mbajt ajo mbledhje, po për qejfin për fatin tem u ba ajo mbledhje në të cilën merrsha normalisht edhe une pjesë si kryetar i Odës. Edhe si kryetarë i Odës së Kosovës, por edhe si anëtar i Kryesisë së Odës të Jugosllavisë. Se dy here në dy mandate jam kanë shumë aktiv, jom kanë nëpër botë, delegacione të ndryshme të Odës Ekonomike të Jugosllavisë, më kanë respektu, më kanë ndihmu, sidomos slloventë, malazezët, boshnjakët, e krejt. E tash në atë mbledhje, hapet tash diskutimi ekonomik se ky ish ministër, dojshin me hjek këto, është puna ekonomike. Normalisht që marr fjalë edhe une qito senet që i thojsha Markoviqit, Preglit shumicën i përsërita.

Aty tona u kthy në debat kundër meje, serbtë e krejt këta, çka me ba? Gati u bashkojshin krejt kundër. Për Slloveni ashtu ishte Stipe Mesiqi si nënkryetar, ai ishte nënkryetar i Kryesisë, ai Joviqi u kanë kryetar i Kryesisë së Jugosllavisë, i Serbisë, Joviq. A Stipe Mesiqi o nënkryetar i qeverisë... i Kryesisë Jugosllavisë në ato momente ‘88-‘89-ta, cila po i bjen? Tona dulën kundërshtimet e tina, pajtimi i tij me mu, tona shkum goxha larg me replika të ndryshme. Në një moment une u bana nervoz me këtë kryetarin e Sindikatit, se ja kom harru qysh e ka pasë emrin, u kanë i joni i Kosovës, malalzez a serb. Thashë, “Po a ishe bo ti kryetar me të propozu une, nashta i kisha zgjidhë këto probleme?” Edhe tona ai u ba nervoz ja nisi... (qesh) tu më nemë, tu më shajt, e krejt. Kryesorja po shkon, qysh shkojke mbledhja na kundërshtarët Mesiqi edhe Azemi edhe thojshin gazetatat, “Tandem Mesiqi-Azemi” t’u kundërshtu Serbinë edhe politikën e tyne edhe krejt këto që i kanë bërë.

në një moment tona ata e zgjatën pak që atëhere e kish mbledhja... atëhere kish nisë Kroacia me mbledhë do armatime, do kallashnikova anej-knej edhe nisën ato sene m’i përmend të cilat nuk ishin

më me mu, në një moment pak një pauzë bohet. E kom pasë shok të mirë edhe që u kanë serb edhe krejt aleatët e Serbisë, u kanë një profesor-doktor, bile më thotë, “Hučko”, tha, “a ke plan ti, a do të rrijsh a do të shkojsh?” Thashë, “Valla, une kisha shku”. Tha, “Në qoftë se më ngon mu, se pauza ke e shkurt e sa e di po kryhet mbledhja. Hypi kerrit e fishlloja për Prishtinë”. Thashë, “Ani de.” Kush e di çfarë informate ka pasë ai. Pak edhe u tuta të drejtën me kallxu, pse? Thashë ky po më thotë fishlloja, thashë, te tona, tona... tona dula atje konkludimet e krejt që... i ra konkludimet i zbuti, “Duhet me bo këto, e jo me ra qeveria”.

Kryesia nuk pruni kurrfarë qëndrimi, po edhe ky krejt me një konkluzë të butë e bani edhe për neve që ndërmora masa që ekonomia m’u forcu, jo Kosova e masat. Po kështu në përgjithësi me punu në atë drejtim që m’u aftësu ekonomia, anej-knej edhe metë me një... përfundim palidhje. Ky me dy-tre rreshta, nuk harroj, nuk e arriti suksesin Joviqi. U kry mbledhja, u kry ajo mbledhje a une jam kanë në rrugë. Babën hala e kisha pasë gjallë ai ish i urtë shume... kur ja mrrina, ai u gëzu shumë që u ktheva prej atje. Mirëpo, unë nuk kom pasë naj problem ndaj meje, une s’e kom hetu as rrrugës as kurgjo, s’muj tash me hup shpirtin une. U ktheva normal me shoferin, vonë erdhëm, po erdha në shpi. Edhe kështu që me qeto aktivitete u munova diqysh me, me bo njëfarë partneriteti me kto diçka, se kurgjo s’kishim na, s’kish kurrfarë organi tjetër.

E erdhëm tona në atë situatë që thashë pak ma pare. Shqiptarët nuk dashtën me ba zgjedhje, serbët i bonën zgjedhjet, e zgjedhëm s’po mbjen mend u kanë kryetar i “Agro-Kosovës” njëfarë serbi. S’po më bjen në mend emni. Edhe nuk dul i keq, une kisha qejf me ardh qasi dikush ose ai, Pera, që nuk i qet prej pune njerëzit anej-knej Për fat të keq si... për fat të mirë, ai nuk ndërmurë ato masa, i përjashtoi nja dy-tre, po jo shumica 110 mbetën aty në punë ose nuk ndërmurë asi masa drastike. Mu ma dhanë një vjet, kisha të drejtë dy vjet, po njëfarë Aca, njëfarë shovinsiti nacionalisti u kanë i këtij Gjilanit, ai u pat bo Sekretar i Odës aty. Ai m’i hjeki dy vjet. Tha, “Veç një vjet ke të drejtë”. Se kur të kalojë ky mandat, si qitash që po marrin [të ardhura], kisha të drejtë dy vjet të merrja rrogë, edhe që s’isha në punë. Ai ma zvogëloi në një vjet.

E tash une i kisha 53 vjet, a i kisha 33 vjet punë, pensioni i përkohshëm... i parakohshëm atëhere u kanë, 30... 55 vjetë moshë, 35 vjetë me i pasë stazh. Une s’i kisha edhe dy vjet, as njëra as tjetra. Dola mas një vjete me marrë rrogë po, po rrugaq, rrugëve, pa punë. Njeri i papunësor isha, Hysamedin Azemi mas gjithë këtyne vite, e gjithë këto funksione i papunë. Më lutshin tona ata... më çojshin në do farë vena palidhje, une m’u kthy tash te Elektro-ekonomia, nuk ma dojke inati se shumë u duhke me shku qaty me pranu organin e dhunshëm, a une punëtorëve edhe kjo... është, po më duket s’e kom thanë shumë e vlefshme për këta... për këtë Kostiqin edhe për Elektro-ekonominë, për punëtorët, s’di a e thashë, por p’e përsëris se s’ka gajle.

Ata kur u banën masat e dhunshme në Elektro-ekonomi, une shkova te ky Pera Kosiqi me bisedu për mos me i qitë punëtorët, “Çka kanë punëtorët?” “Qitni...” ata thojshin m’i largu disa udhëheqës. Aty s’mujsh me u përzi te udhëheqës, thashë, “në rregull i hjekni do udhëheqës cilat doni. Por, punëtorët, bageristin, e elektriçistin mos i largoni”. Ai tha, “Kqyr ti, Hučko, fol ti me këta të

Elektro-ekonomisë që i ke pasë kolegë e shokë”, tha, “kjo janë dhetë pika, nëntë pika janë me Ligjin e Punëve të Bashkuara ku duhesh me bë këto...” Ke të drejtë, ka të drejtë, thashë, ai me qitë tjetër vend pune krejt. “Qekjo pika e dhetë, a nimdhetë s’ka cila është, është qajo që këta s’po dojnë me pranë, është që e pranë organin e dhunshëm edhe e nënshkruan edhe qaty është problemi. Secili që e bon këto”, tha, “vazhdon punën, që s’e bon largohet prej punës. Ti e din mirë që unë këto [vendime] s’i bi, po p’i bjen dikush tjetër. Une po i zbatoj edhe une s’kam qare pa i zbatu. Mirëpo”, tha, “atë letër merreni, fshini hundët me nderë me thanë edhe puno”.

Qe si elektranat nuk e bonën atë punë, mirë është që nuk e bani atë punë. I qitën disa drejtorë, po punëtorët metën. Në elektrana metën punëtorët, se une kisha qëllimin me ndejtë punëtorët deri veç që të përzen me zor. Qashtu edhe... edhe në Odë e kam ba, asnjani, as shoferi, as sekretarësh, as... “Keni me ndejt, që të përzen tjetër është”. Shoferit i kom thanë, “Si me vozitë ato, si mu, kryetar”. I kish gjashtë çika, një djalë. Thashë, “Ti rri!” “O qysh une me nejt e ti po shkon”. “Po une po shkoj se po duhet me shku, a ti s’duhet me shku. Une e kom veç një djalë e një grue, a ti duhesh me mbajt familjen. Që të përzen kryetari të hjek, atëhere s’kom çka me bo”. Qashtu fola me krejt organizatën, “Asnjoni mos u largoni vetë! Që ju largojnë, atëhere s’ke ma”. Edhe për Zotin veç dy-tre vetë janë largu. Krejt janë metë edhe kanë vazhdu edhe ma së shumti kanë vazhdu me punu në Odën Ekonomike. Prej meje po, e tjetër është une qysh... qysh ajo Odë Ekonomike, tona qysh u përdorë, a ka mujt shumë ndryshe me u përdorë.

E nuk... une mbeta pa punë që ju thashë hina me njonin, jo me punu, po një Sekretar i jem ai e lëshoi Odën, edhe përpara se e kish firmën e vet, e boni firmën e vetë e i paguva nëpërmjet firmës tina kishe po punoj te ai, e pagujsha qito dy vjetë stazhin e paguva. E mas dy vjetëve dola në pension 35 vjet, 55 vjet, pensioner i ri pa kurrfarë angazhimi. Oferta kom pasë çfare të dush, sidomos prej ndërmarrjeve të ndryshme të Sllovenisë, Kroacisë, se dojshin me dhanë me pasë përfaqësitë e tyne këtu. Une nuk dojsha se s’guxojsha. Edhe s’kisha guxim edhe s’dojsha. Meta njeri pa punë, me pension. Ma vonë edhe ai pension shkoi. Tona erdhën pensionet tona për të cilat nuk janë pensione po lëmoshë. Edhe jeta tona po vazhdojke ashtu qysh...

E vetëm edhe një, pos krejt tjerave edhe... ça është tjetër njeriu. I nihmova në një... i bana nja dy shokë të mi ka fundi i stazhit qetij temit, pa punë kur isha. Për këmbim blejshim markat, e tona ata bojshin lidhje, ata i kishin lidhjet me Beograd i çojshin markat e merrshin dinarë, ata shticungun<sup>14</sup> i thojshin, e i bjen mend dikujna atëhere çka më kanë bo mu, se tona mu këta më thanë, tonë kohën më thojshin “tradhëtar i popullit”. Tana serbët u kthyen më bonën “shpiun i Shqipnisë” e çka s’më bojshin, “Grunë e ka prej Shqipërie, ky o shpiun, u konë gjithë i tyre. A po shihni qysh tash p’e kundërshton Serbinë e krejt këto”. Tash këta më sulmojshin edhe ma bonën një edhe një të mirë mu, tyne, me njo, një grup i burgosën i bonën nëpër Serbi e gjithçka, me konë në krye të atij grupi që po bahen qito shticunge edhe Hysamedin Azemi.

<sup>14</sup> Term gjerman, *stützung* që ka kuptimin e mbështjtes. Mirëpo, në kontekstin aktual, shqiptuar si shticung ka kuptimin e këmbimit të valutës gjermane me atë jugosllave: nga markat në dinarë.

Më burgosin midis Prishtine edhe më çojnë në polici, qetu tash ku është edhe e jona, aty tona patën hi këta, më majtën aty gjithë natën, nesrit më çunë për Beograd bashkë me një bashkëpunëtor. Lidhun. “Armik i popullit”, me s’di çfarë neni që me hongër burgun kush e di qysh. Më çunë në Beograd te gjykatësi e kishin rregullu që mos me konë gjykatësi, “Nuk o gjykatësi, nuk vjen”, e majtën deri diku. Dikur në mbramje apet nëkerre e në burgun e Beogradit. Atje më rrasën, qaty e përjetova edhe ato qysh ish në burg, me të fotografu e me të shkru, e me nënshkru, me t’i marrë krejt kaishin, me t’i marrë krejt ato.

**Anita Susuri:** Në cilin vit u konë ngjarja?

**Hysamedin Azemi:** Ky krejt fundi ‘89-tës.

**Anita Susuri:** ‘98?

**Hysamedin Azemi:** Jo, ‘89 kur e kryjsa e dola prej Ode pa punë. E tona me ta punojsha, e tona më nxunën në qato edhe kishe qato, çka dijsa une çka është ajo, e më vunë në qeli... e tona ata më njihshin krejt kush jom. Thotë, ky drejtori i burgut thotë... po thotë atyne rojeve po i thotë, “A po më leni pak me to?” “Çka është kjo?” “Po”, thashë, “çka po di une, kjo osht’ *menjači* [Srb.: këmbyes], po bojnë këmbime në bazë të ligjit është e licensume e ka lejen kjo organizatë punuese. S’kom ditë që është diçka jashtë ligjit”, tha, “Tash këto s’di, s’mirrna vesh”, tha. Po tha, “Diçka të kisha lutë, mos dil prej qelie, le të bijnë aty çkado. Kur të bohet pauza që dalin me shetitë”, tha, “mos dil, se ktu ka”, tha, “njerëz që munden me të bo keq, e dinë kush je...” “Shkurt”, tha, “mos dil jashtë prej qelie”. Une nejta gati një javë në qeli, nuk guxojsha me dalë se thojshin... më shajshin prej do qeliave anej-knej. Thojshin, “Aha, ke kullotë boll edhe ti” edhe... kështu që mas shtatë ditëve dola në gjygj. Mora një shok të vjetër në Beograd, ma gjeti një avokat të mirë. Mbas shtatë ditëve dul që s’kom kurrfarë, s’kom bo kurrfarë kundërvajtje edhe që lirohem me këtë që, në qoftë se ka nevojë do të thirrna prapë nej... si dëshmitar a qysh kështu.

Mas një jave edhe ato e kom përjetu edhe në burg jom kanë, shtatë ditë, përnime po m’u ka dok si 77 vjetë. Shumë keq ish kanë me kanë në burg. Kur i shihsha ata vetëm ni qebe aty, kurgjo tjetër. Atë tasin e... si ushtarët para Luftës së Parë Botërore porcijat ato ushtarake. Qaty ta bijke një bukë krejt ta gjujke për atë birën atje, nevojën qaty. Tylifarë shkrime aty të burgosunit që kanë shkru {bën sikur shkruan me dorë}, s’dishe a o nata, a o dita. Kurrë s’e harroj! Shtatë ditë, si shtatë vjetë m’u ka dokë. Kështu që edhe ato e kom përjetu. Kështu që shpirti jem i vogël, qeshtu jam me trup me këto, po, në botën tonë gjithçka kom përjetu, edhe këto edhe ma së mrami edhe burgun.

## Pjesa e Nëntë

**Anita Susuri:** Kisha dashtë me folë edhe pse për të ‘90-at nëse keni diçka me shtu me folë për luftën edhe përjetimin e juve, ku keni qenë?



**Hysamedin Azemi:** Për qato deshta me ju lutë që me vazhdu edhe me qato.

**Anita Susuri:** Po.

**Hysamedin Azemi:** Tash para lufta, para lufte... ajo pune më nxuni në Prishtinë. Para kësaj ju thashë që mu më vdiq bashkëshortja, une mbeta... '96 ajo vdiq, meta vetë. Djalin e kisha në Londër, se që edhe ato e kalova. Agroni kur i boni... kur u bonën këto situatat që i merrshin në ushtri, ai kish 17 vjeç. Më dhanë informata të duhuna, të sigurta. Tha, që më thanë, "Djalin e ki 17 vjeç është i rritun e kështu". E thirrën kisha në nifarë rekrutimi në Nish. Por, më thanë, "Në qoftëse e çon atje, ma s'ki me pa. Ta çojnë meniherë në front atje", e une shpejt e shpejt e ika djalin për Londër. E sigurova biletën e këto, kështu që, e çova djalin në Londër. Ai më shpëtoi për pak, se tona mas dy-tre atëhere apet erdhën me bo me çu në rekrucion, rekrutim me polici. Une thashë, "Që keni nevojë..." "Ku osht'?" "S'di, e di që u shku dikund jashtë. Ku u shku as s'e di as ato". Kështu që e shpëtova djalin s'e di çka kish ndodhë me to, kush e di çka kish ndodhë, po shkoi në Angli.

Kështu që, une mbeta vetë. Po, kom pa mendu që nuk do të martohna kurrë, po nuk mujke njeri vetë me rru, sidomos burrat. Isha 58-9 vjet... une s'dojsha po dashtën këta të mijtë me më martu. U lajmrojshin tylyfarë, për të cilat tona çova dorë prej asaj. Kujtojshin që jam pasanik a naj, s'dishin se s'jam kurrfarë pasaniku. Tona pata fat, motra ka pasë do të burrit atje në Gjakovë. Ma gjeti një zonjë të mirë, një mësuese. Edhe kjo ke mëseuse si e para, shumë e mirë prej një familje të mirë, familje të njoftun e Gjakovës, Thaçi. Axha është Ali Thaçi, kardiolog i njoftun kosovar. Baba Qamil, një familje shumë e mirë gjakovare. Ma propozunë, ramë dakord shpejt e shpejt. Për dy-tre javë u njoftum, me 1 mars, tona para 22 viteve u martum.

Po mendoj që hezitoshja me u martu, po prapë mirë që kom pasë fat që apet kom ra në një gru të mirë, në një bashkeshorte të mirë, me një shoqe të mirë, e cila... për të cilën kisha nevojë si me atë të parën me më përkrahë, se apet hyna në lojna edhe telashe të mëdhaja edhe në Odë edhe mbeta pa punë edhe krejt. Edhe hina me tona... diçka... mbrapa, një e mrapshtë m'u dha prej asaj që bana... zaherë hina në gjynah, jo zaherë, hina në gjynah me xehetarët, e tona krejt puna më shkoi mrapshtë. Kështu që, mësuese s'mujke me u inkuadru, se me punu ka punu me një çerdhe disa vjet e bankës qësaj, qësaj qysh thirret, Bankës ProCredit. Nuk mujke m'u punësu kërkun. Dy sene i pengojshin, një që dulën këta udhëheqësat e rijë krejt, diqysh, gratë mësuese e arsimtare, u dukte m'u punësu. Këto [gruan time] s'e pranojshin, njo... jo po edhe i pengojke që ish gruaja jeme, po mendoj që po. Kështu që, u martova shpejt e shpejt.

Nisën këto situatat e luftës, ajo që ndodhi në Prekaz e krejt këto, mu më gjeti në Prishtinë. Bile, kena pasë edhe probleme prej Gjakovës me ardhë, post-bllloqe gjithkah, na ndalshin na... qasmos, si tana që i kishin. Mirëpo, kur ja nisi ajo, une isha me gru këtu tash. U ndëprenë ato komunikacionet me Gjakovë. Ajo e kish krejt familjen atje, e ka ni vëlla edhe tri motra, babë e nanë. Tash me shku dikun ajo nuk dojke, na mujshim me shku se e kisha une djalin në Londër, shumë lehtë mujshe me shku deri në Shkup. Kisha oferta me më çu në Shkup e prej Shkupit veç me i thanë atyne humanitarëve, "E kom

djalit [në Londër]”, ata tona lehtë i çojshin edhe tjerët kur... që e kish dikush atje atëhere ma lehtë ja jepeshin me shku, mirëpo vendosëm mos me u largu prej Prishtine.

Qëndrum stoikisht në Prishtinë, me krejt atë kiametin, dilshim gati përditë me ble një bukë a diçka. Banesën e kom pasë shumë në vend të keq, në ndërtesën e parë që është, ku kanë banu edhe Mahmuti në të njejtën hymje, meniherë afër shtëpisë së Veli Devës. Në shtëpi Veli Devës e kish bo ai... Arkani<sup>15</sup> kish bo qendrën me veti, aty u kanë një kukull e madhe me sari kështu {tregon madhësinë me duar} me plis në kokë, e kryqin në plis, qaty i bojshin, i nalshin. Është një parking aty, s’di a e dini [i drejtohet intervistueses], është një, ku është kjo tash që e ka maru sot ndërtesën e madhe ky. Dashta me ja thanë emrin, po s’po e thom, ndërtesën e madhe që e kanë maru aty. A dini ku e ka shtëpinë Veli Deva? [I drejtohet intervistueses]

**Anita Susuri:** Jo, s’e di.

**Hysamedin Azemi:** Rruga Agim Ramadani ku fillon.

**Anita Susuri:** Në Aktash, apo?

**Hysamedin Azemi:** Po, mbrapa meniherë në qyshe e ka pasë shtëpinë Veli Deva, qaty. Aty është mas kësaj ndërtese pesë-gjashtë katëshe me katër hymje, është një parking i madh i mirë, aty i nalshin krejt kerret e mira që ishin ju merrshin njerëzve, i plakçitshin, ça s’bojshin, ishin do banesa përdhese e podrume aty i merrshin i majshin qaty qato farë... ato s’guxojshim as roletën me kqyrë nijshin bombardimet e këto u mshefshim në podrume, atje poshtë. Krejt hymjën që e pata, te tonë ikën, Mahmuti shkoi e, familja Dervish Urzaj, krejt qasi janë në atë hymje edhe njëfarë doktor Kozmaqi, e doktor tjetër ky... Lumezi e plot, krejt qasi jonë aty. Se une e kom ndrru banesën teme me ni të Beogradit, qaty dashta tona me ju tregu atë historinë.

E tash vijshin na përzojshin me armë jashtë. Një kohë tona dulëm te një vëllau i jem, e ka pasë banesën në këto soliterat poshtë, përballë Armatës ato, në qendër aty. Soliteri i Elektro-ekonomisë aty. Ai ish veç me grun aty, e tona një kohë aty nejtëm, dilshim, bombardojshin... bombardimit i ikshim në podrume. Kur kalojke ajo, vazhdojshim qato blejshim bukë. E pata ba ni friz me bukë me jep, kajherë s’na jepshin as bukën. Thojke, “Le t’u jep NATO, shkoni me ju jep NATO”. Nuk pata kurrëfarë problemi, dikush... edhe që dilsha nuk um ka ngucë kërkush edhe nuk e ngucshin as tjerët se kom pa edhe Adem Demaqin, e shihsha se... as ato se ngucshin. Kena pasë tortura boll. Qitke me automata me dalë jashtë disa herë, herë na përzojshin e herë u kthejshim. Shumë zor e kam përjetu si tonë populli.

<sup>15</sup> Zhelko Razhnatović - Srb.: Željko Ražnatović (1952-2000), i njohur si Arkan, ishte komandant i një force paramilitare serbe gjatë luftërave në Jugosllavi. Ai ishte në listën e më të kërkuarve të Interpolit në vitet 1970 dhe 1980 për grabitje dhe vrasje të kryera në disa vende anembanë Evropës, dhe më vonë u padit nga Gjykata Penale Ndërkombëtare për ish-Jugosllavinë për krime kundër njerëzimit. Grupet e tij paramilitare kishin kryer edhe krime në Kosovë. Razhnatović ishte vrarë në Serbi në vitin 2000.

Edhe tona e bonë një regjistër krejt kush është në Prishtinë, a e dini ato, jo? [I drejtohet intervistueses] Krejt jo, ato jo, krejt jena dalë na. Në rend pritshim me na regjistru me tregu adresën e regjistrimit, se aty u konë edhe një plan likfidimi. Po s’di, patëm fat na diçka nuk ju shkoi, se krejt u bo [regjistrunë] kush janë në Prishtinë që s’janë ikë e kanë pa bo regjistrin, krejt... kështu që, relativisht Prishtina kaloi mirë qysh ka mujt me ndodhë, se ka pasë shumë në Prishtinë që s’janë dalë. Atë e pamë na të nesrit kur hynë Rusët, vloi Prishtina. Ata [qytetarët] s’mujtën me ardhë meniherë, po në Prishtinë ishin. Dulëm prej podrumeve, prej shpijave të ndryshme, kish pasë goxha shumë. Janë ikë po edhe goxha shumë janë kanë, mbetën këtu në Prishtinë që s’janë largu prej Prishtine. Edhe tona me të kallxu drejtë, tona ish një gëzim krejt qaty tu u pa.

Ndër dritare tona e vranë një serb aty, se e kundërshtoi KFOR-in. E vranë qaty ndër terracë teme. Atëhere ni vëlla vijke kajke çdo ditë aty. I kundërshtoi, ata e vranë. A qat’ ditë që janë hi Rusët, atë ditë e kanë plaçkitë sendet e Veli Devës, dhomat, çfarë, atë ditë i kanë bajtë, këta nuk reagojshin, këta veç kqyrshin. Ata thojshin, “Po i bajmë sendet tona”, ata rrijsin kqyrshin. KFOR-i këta me u bajtë nuk bojshin problem, “Veç shkoni, merrni çka të doni. Veç shkoni!” Nuk dijsin ata që po marrin mobiliet e shqiptarit, po mendojshin që të tyne, se aty ish rezidenca e atyne e Arkanit e krejt. Rusët hynë, qysh e dini, të parët. Tona edhe aty i patëm tutat shkuam se po hyjnë rusët qa do të bëhet? Mirëpo, ata vetëm depërtun e shkun, tona erdhën anglezët. Krejt tona shkoi, qysh krejt shkoi puna, lufta. Krejt kishim informata, po edhe s’kishim fort informata, ça po bohet e qysh po bohet. Hijshim, dilshim, ikshim, u tutshim po na vrasin. Shumë herë jena kanë me automat në fyt, po metëm gjallë.

Tash çka e keqja e të keqe, s mas disa ditëve kur u çlirim, erdhën tona me do libeza. Thojshin, “Jena policia e UÇK-së. Kujna kjo banesë?” Une i thashë, “E jona”. “Gjithë kjo banesë, a veç ju dy jeni a?” “Po, na dy jena. Por e kom djalin me fëmijë jashtë e këto, po e jemja është. Ani çka ka lidhje që jom dy?” Tha, “Valla mirë ish konë”, tha. “E ngat meje”, thashë, “e serbëve, e ka veç qekjo, ngat meje garsionerkë o e serbve, këto tjerat jane krejt shqipëtare”. Ja nisa rend, {numron me gishta} “Banesa e këtij ish rektorit, Mahmut Bakallit, ky filan doktori, filan, filan, filan”, krejt krejt ishin njerëz. Tha, “Mahmuti?” Thashë, “Mahmuti momentalisht s’është aty, po sa e di ksajde osht’, vjen”. Dojshin me hy në banesë të tina, me ja thy banesën.

Tona po du me thanë, s’guxojsh me kundërshtu, me të mirë [duhej me ju folë]. Tona edhe shti edhe gruja jeme me ju dhanë bukë me hangër, anej-knej, se po na qesin s’e dijsim kush jonë. Ato jonë, po flas për dy ditë, tri të parat, s’dishe as ku m’u anku, as çka me ba, as kurgjo. Veç në dorë të Zotit që thojshin pleqtë. Hynë qaty, nejsë në atë garsonjerkë hinë, banesën e Mahmutit e thynë njëhere, hyn do. Tona ma vonë dulën, që erdhi dhondri i tina, e krejt kështu që... tona hajde tash të kaloi ajo tuta, tash tutu prej tondit, “Se neve na ka kallë krejt”, tha, “dilni ju qitu në këtë garsonjerkë, se ju veç dy jeni, se na jena edhe 15 robë”. Por, për fat edhe ajo kaloi, kaloi mbetëm në banesën tonë. Falë edhe qasaj që ishin këta pak edhe të njoftun, Mahmuti e krejt këta.

Tona kenë ata edhe njoni që më njihke mu, u bojke që s’po më njeh edhe une u bojsha kishe s’pe njoh, po, ai m’i hjekën qafe. Meta në banesë teme, se po tona në liri me më qitë prej banese. Po ajo jom... po

flas për dy-tri ditët e para, se tona s'kena pasë kurrfarë problemi me... mendoj me pushtetin që erdh nuk patëm probleme. Mirëpo, u bojshin qato hupshin do njerëz anej-knej. Tona edhe mu më thanë do mos me dalë shumë... mos me ato, po... une s'i kom ngu, përditë jom dalë. Mu s'më murr kërkush, as kurgjo s'më bani. Kështu që, s'muj tash une me shpikë, kanë tentu e jam tutë e këtu anej-knej, kërkush, kërkush s'më ka ba kurrfarë presioni, kërkush s'më ka ngucë.

Me grunë jetojsha, me punu jo, penzi jo, i kisha do pare që patën metë. Edhe aty e kom pasë një problem kur kam shku në Angli te djali, më kanë hy, më kanë vjedhë shumë sende. Ari i djalit, gruja që i ka ba gati, sa zinxhiri, sa perflirja, po ato ata serbët mu më konsiderojshin si kundërshtar i Serbisë se e kanë pasë policinë e aftë i nxjeshin shumë shpejt. Mu s'mi gjetën hajnat, kanë vjedhë edhe shumë pare, shumë të madhe, mbeta tangall. Kur don me shku mrapshtë, shkon, shkoi e shkoi, e shkoo e, qashtu që tona nisi kadaldale jeta m'u rregullu.

Këta në Odë Ekonomike më thirrën me shku për kryetar prapë, se një numër i drejtorave që ishin kanë përpara u kthyn, do shokë të mi. Në qat' fillim, se tona u ndrrun edhe ata, po në fillim shkun. Po une nuk pranova, se aty veç PDK-ja ish hi, Hashim Thaçi e kish zyrën, tash po thom zyrën tem... zyra e kryetarit Odës. Edhe tash janë aty shumicën e pjesës së Odës është PDK-ja, ajo ndërtesa e Odës Ekonomike u konë, krejt ajo ndërtesë, qajo hymja e qajo pjesë. Une i përshëndeta, i thashë, "Tona të mirat, po une e kom kry. Ka edhe do njerëz që janë kanë në burg për qat' Odë, edhe le të bohën ata kryetarë të Odës. A jam në disponim..." që hala kish mundësi me kontakti edhe me këtë Odën e Maqedonisë se ish i njejt, edhe Sllovenisë ish i njejtja Odë, mujsha me ndërmjetësu diçka me ndihmu.

Ata nuk u interesun ma kurrë as një kafe me ma qitë, se te na është edhe puna, shqiptari e din, "Dyjeja nis prej meje, une kur vij krejt prej fillimit", i ndërrojnë këto, a une ato s'e kom bo. U ne edhe kur vijsha as shoferin s'e ndrojsha, as sekretareshën s'e ndrojsha, ata rrijshin që janë kanë. E kisha mandatin, shkojsha apet veç në qoftë se dojke me shku vetë që dojke. Kurrë s'kam ndërru as sekretaresh, as shofer, as... kurgjo, kurgjo, tavolinën e qet ktu ose aty. Veç mos me konë ashtu qysh u konë, se prej tina po ja nisë dyjeja. Çka dashta tash diçka me thanë si e parafundit edhe në fund kam diçka me thanë, në qoftë se pranon, qoftë se jo, s'ka problem.

**Anita Susuri:** Po, urdhëroni?

**Hysamedin Azemi:** Është puna kjo që... na, kur hynë fuqitë e huja edhe EULEX-i edhe kjo, gabimin ma të madh e ka ba veç Kosova. Asnji udhëheqësi, Sllovenia, gati krejt kanë mbetë, Kroacia, Maqedonia, krejt. Une s'po thom na kishin ndalë mu e shokun Fadil, sidomos, a mu. Na jena konë për shembull ja njëqind udhëheqësa, une i fundit. Hajt po thojmë 200, përmbi hajt, se edhe 500 po thojmë jena konë. Çka janë në komunë, anej-knej, me qindra mijëra njerëz na kena pasë, që janë kanë të aftë në çdo pikëpamje me udhëheqë menjëherë Elektro-ekonominë, me fabrikat të cilat... të cilat janë kanë. Na mundem me thanë çkado, s'ka pasë komunë në Kosovë që s'ka pasë fabrikë, se une i kom ndërta jam kanë kryetar i Odës, me programin e zhvillimit të Kosovës, mas kushtetutës të re shumë ndërtime janë ba të fabrikave, me i aktivizu fabrikat.

Por, EULEX-i erdh u ba zotëri, une tash jam këtu, pasuria krejt është e jemja, une udhëheqi, une thom a mundesh me ble, a mundesh me shitë. Une garantoj edhe sot nuk pagujnë qira, edhe sot qata që janë metë nuk kanë qira, pa qira rrijnë, nashta po gaboj. E bonën hotelin e këtij... Pejës, e kanë bo Qendra e Ushtrisë Italiane. Shkollë, nëpër shkolla hyjnë ushtria, çka ke ti? Ushtria me hy nëpër shkolla! Ki gjithëkund, ushtria bon kampe, bon shatorre, jo në shkollë, jo në hotele. I gjetën njerëzit i bijshin, u bojke drejtoresha, EULEX-i e bojke drejtoreshën e spitalit një indiane, me jadranka shkojke, me Shkollë të Naltë Medicinale. A na kishim doktorra sa dush që s'kishin punë, rrijshin.

Qashtu në Elektro-ekonomi me dheta inzhinjera, ekonomista metën pa punë. Erdhën njerëz prej tjera veneve që dike ndoshta pak gjuhën edhe e kryjke një kurs një javë, e bojke udhëheqës aty. Deri prej e pruni me udhëheqës Elektro-ekonominë prej Irlandë njerin. Ai gjeografikisht s'dijke as ku është mihja, as ku është bageri, a ku osht' elektrana. A tu pasë njerëz, jo veç Hysamedinin. Une po thom jo edhe njëqind bashkëpunorë të Hysamedinit të thojmë, po njerëz inxhinera krejt të ndershëm të aftë, që te tanë u afrunë.

Ju thashë ma vonë, që krejt remontet krejt këto na vetë i bojshim, me kuadrot tona na... çu u bo? U bo që krejt qeta të aftë e panë që s'munden me punu mo në elektrana, se erdhën njerëz që s'dijke çka osht' elektranat. Erdh për mihje sipërfaqësore, s'dijke çka o bageri. E murrën e po s'ishin të aftë... e krejt une s'po thom... E tonat, i dumë tonat fabrikat. Gabimi kryesor është që jonë tjetërsu krejt fabrikat, për një natë e kom pa... e kom pa fabrikën e tapetave të premtën, të hanën mo s'ka ekzistu, e kanë rrëxu. U maru soliteri i parë që nisi me maru qaty. Shitën Amortizerat [aty] e bën televizionin Klan. E ky s'dijke prej dreçnillakut çka me bo, se aty është lartësi shumë e madhe për vinqa anej-knej, e shkoi Batoni e maroi me shkallë me shku kështu, në ato bisedat ku i bojke ai, a e dini? [drejtohet intervistueses]

**Anita Susuri:** Po.

**Hysamedin Azemi:** A fabrika dhe atë ditë kur u shitë ka prodhu amortizera. Në vend se me u lidhë me shtetet qaty, gabimi, u dashtë këta shokët tonë, luftëtar tonë, UÇK-ja. Une ju përkulna, sidomos atyne që kanë dhënë jetën [lëviz vendit] a për shumë sene ma vonë që i kanë shfrytëzu veç per veti, jo. Po ata kanë pasë për shembull gatshëm 120 njerëz në Odë Ekonomike, s'i kanë shfrytëzu... po me ekonomi u marr njëri që nashta parën here u ardhë në Prishtinë, as Prishtinën s'e ka njoftë. Është një punë që qaty na kena hup ma së shumti, në njerëz, në kuadra. Krejt kuadra kena pasë na me ringjallë, krejt edhe me ju... me ju kundërvu edhe EULEX-it edhe këtyre se s'kanë mujt, s'kish mujt mo ai zezaku, ata që erdhën.

Mu, i cili jam shku në Washington e New York, e Bankën Ndërkombëtare e nëpër krejt botën, nëpër banka të ndryshme, nëpër Paris e Gjermani për elektranat. E me eksperta të mi me lujt mejtap, po siç ka lujt me këta që s'kanë ditë kurgjo. U shkatërruan krejt, u shitën krejt. Jo tash m'u shitë e me bo si ka bo do shtete tjera, e ka shitë për ni dinar. Po e ka kushtëzu që me punësu qikaq punëtorë me vazhdu punën me prodhu qato që ka pranu ai krejt. Na shite, ai maro Klanin. Shite, ai maro depot... o sa toka atje u shitë e tjerrëtorës "Predionicës". Qeshtu shqip që i thojshim, aty krejt... nejtë ato maqinat të

këtina amortize... amortizerave, ai kush s'di kush e ka pranë, pronari i ka pagu me hekrat që i ka çu në... në shkëmborin e Shkupit. Qashtu fabrika në Pejë, me qata hekra të fabrikave që i ka shitë në Shkup e me llamarinë, e ka ble aty, u ba tash edhe Shtëpia e Bardhë atje të territorit, stili me Shtëpi të Bardhë.

U bamë krejt... domethanë u rrëxu fabrika, në vend të tyre badihava... u, u banë u tjetërsunë për pa kurgjo. U shitën tash tokat që po thotë ky, "Për dy-tri euro", e krejt ato. Qajo është tragjedia e Kosovës, qajo s'falet kërkun në histori, historia s'ka me falë ato. Që gjithë ato fabrika, gjithë ata njerëz e me metë e me punu nëpër... treg t'u shit anej-knej, ose shumica e tyre janë jashtë. Janë shku jashtë se kanë mujt me punu kudo. Janë konë zanatli, kanë punu në elektrana, ka punu me bagera, u shku mirë, Gjermani sa Poloni, e ka marrë rrogën dhetë herë edhe ma të madhe edhe kanë metë në... në përjashtë. A na metëm këtu me... me EULEX-in e UNMIK-un, me gazdallarë, me njerëz që, nashti ata njerëz të mirë që kanë pasë merita, po qe ka merita jepja more, a o gjeneral? Bone gjeneral. A meriton me marrë pensionin jetësor? Jepja pensionin. Po ai s'mundet që u konë luftëtar e gjeneral tash me udhëheqë me një firmë, me udhëheqë me një digaster e anej-knej. Hina fell, po s'ka gajle a?

**Anita Susuri:** (qesh) S'ka gajle.

**Hysamedin Azemi:** E tona qaty është puna, qaty na kena hup shumë, shumë. A qeto tash që po ndodhin tash, ndryshimet këto, këto krejt o në rregull, por në të kalmen kena shumë gjynahe, shumë ma të mëdha janë se historia, s'ka qare pa e gjyku një ditë, se veç Kosova i ka humb krejt fabrikat, si ka hup as Serbia, krejt i ka përtri i ka shit Kinës e këtina... Rusit e krejt i ka shit Serbia, pare të mëdhaja krejt janë. Edhe fabrika e automobilave Serbisë punon e prodhon, i ka shku në Itali, fabrika punon në Kragujevc, krejt i ka punu. Qashtu në Maqedoni, qashtu në Mal të Zi, qashtu në Kroaci, Slloveni, fabrikat e vjetra s'janë shkatërru, krejt janë, shumica janë renovu. Veç në Kosovë s'janë rinovu, veç Kosovë. Na thanë neve, "Ju ikni, boll kullotë me serbët... ju jeni..." Na s'guxojshim me çelë gojën se meniherë thojke, "Ju jeni serbofila, ju jeni Serbi. Na tash kena me rregullu anej-knej". Eh, po, po shihet që 20 e kusur vjet qysh e rregullum. Edhe këtë universitet që e kena pasë, s'e kena.

E kena një fakultet të shoqërisë së tretë, qato ndërtesa janë, i ki ti dyqan... ndërtesat që i kanë pasë qito, akademisë e këto? Po, po harrojmë që qajo gjeneratë me Fadil Hoxhën, me Kolë Shirokën, e me shumë tjerë. Prej analfabetit që baba jem u konë, Hysamedini në klasë të parë në Mitrovicë, e bomë popullin shqiptar me pasë Akademinë e Shkencave në gjeneratën e parë, ku ka ajo në botë? Te na djali, Dervish Rozhaja, doktori ma i ri i shkencave u konë në Jugosllavi në Ballkan. Babën s'di çka e ka pasë, diçka në Pejë atje, njëfarë zanatlije. Ose plot akademikë me prejardhje të parë, ose naj profesorit të mësuesit ose naj fshatarit, që me ja arritë prej analfabetizmit total shqiptari, deri tek shkencat akademike, deri tek tash me magjistra e doktorata, me inxhiniera. Po qato se ka ba qeky 20 vjeçari, e ka bo ai 30-40 vjeçari atje, pse me ja hup qato?

U konë sistemi qysh u konë, u konë politika, s'u konë mirë, u konë qysh u konë e vërtetë është, po domethanë tash ti gjuje krejt, kërkush s'e gjunë. E ki fabrikën? Renovu e vazhdo. Jo tash rrëxojë fabrikën, maro ni soliter, fito... fito pare. Se kurgjo ata, qita ndërtimearia e jonë qashtu u... u rritë.

Shpinë, pllacin, ti një banesë, ti një banese. Ti rrymën që po ma bon dy banesa. Ti që e more ato tre banesa. 60-70 përqind banesat i ka dhanë atyne që po ndërtojnë. 40 copa i kanë mbetë atij [ndërtuesit] kështu, pa dinarë të vetin e pa mund të vetin, qashtu u bo. E tash pse e kena leju?

Na kena fat, fatin qashtu edhe me UNMIK-un edhe e falëm. S'mundemi kurrë me ju dalë haku as Amerikës, as Anglisë, as NATO-s që na ka ndihmu, as ktyne UÇK-së. Sidomos atyne që kanë dhanë jetën, as ktyne që janë hala t'u lyp [të humburit] nëpër tokat e kushedi kujna. Atyne çdo lavdëratë, çdo meritë. Por na kena mujt edhe vet ndryshe me punu, ndryshe me vepru, jo veç me bo gjithë fajtorë, fajtor serbi... çka po ja rritë me gjithë? Une kom thanë, injoro gjithë. Edhe tash, pa e përmend s'bon. "Po do të na sulmojë, po..." Ku ka me të sulmu këtu, me sulmu NATO-n a? Pse po ja rrit morrin kishe kaq koka e fort e po të tutna, nashta më sulmon, hajt hajdeni tash NATO me mbrojt. NATO-n qetu e ki. Ishalla hijmë meniherë në NATO. Çka ka me të mbrojtë? Por tuta. Hin me meritë anej-knej.

Edhe sa ja kena pa hajrin qetyne UNMIK-ave ktyne, ja kena pa sherrin. Për mu, ata janë fajtorët ma të mëdhenjë që na jena metë pa zhvillu, se jo populli. Na kanë lonë, ai thojke, "Po na jep UNMIK-u". Kishe po shet, kishe po dënon, po bon dosje, kërkujna kurgjo. Hajde qetash duhet ti dënoni ju, e ku me i dënu ata kokan... kishe po të presin këtu me i denu, ata nëpër Serbi e nëpër botë, ti tash dënoj që i kanë vra këtu e që kanë kallë e këto. Qaty është një, një humbje e madhe kadrovike, aty le të flet kush çka të don, kërkush s'po hyn në këto punë, as une s'du, veç me juve. S'du me hi në punë, po që nuk jonë angazhu, jo kuadrat njerëzit që janë kanë burim apolitik që s'janë kanë në atë regjimin e komunistit qysh ata po thojnë.

Po u kanë regjim ajo e vërtetë është, na kena mujt me u tërhjekë e me ja lëshu krejt, po a u kanë ma mirë, ma mirë qashtu me rezistu e me ba çka kena ba [që është] univeristetin. Atëhere thojshin vetë... ju kena marrë pushkat e ju kena vra, ju kena dhanë univeristetin. Kush e pruni universitetin? Qata kuadra. Kolë Shiroka për mendimin tim ka shumë meritë të madhe. Unë jom kanë edhe atëhere i anagazhum vonë në Univeristetin e Prishtinës, "I keni dhanë", tha, "areoplana, raketa, çfarë pushke? Që keni marrë pushkat, ju keni dhanë univeristetin". E sot, sot tash i kena njerëz me mijëra, me qindra mijëra me... edhe para atyne podrumeve edhe nëpër podrume tu punu anej-knej, duhet tash me i hup krejt ato se je konë [komunist], po jom konë. A pak ka ata edhe që janë kanë?

**Anita Susuri:** Zotri Hysamedin nëse doni...

**Hysamedin Azemi:** Edhe një diçka.

**Anita Susuri:** Po me shtu?

**Hysamedin Azemi:** Dashta vetëm edhe diçka me thanë. Po flas si njeri këtu. Une jam qasi kuadri i cili me forcat e veta s'jom kanë asnjë klan, as shoqëri, as përkrahje, as familjare, krejt këto 12-13 funksione i kom arritë vetë me punën teme. As s'jom kanë djali i kushedi kujna, as i një luftari, as i një pasaniku, as përpara edhe tash. I xehetarit fukara, me punë prej zanatit, e krejt ato i kom bo që i kom bo. Të dytën po du me tregu, une kur jom shku e kom dorëzu banesën dy dhomëshe Elektro-ekonomisë, e

kom pasë vllaun, ti anej-knej që me vjet s'më kanë folë se i kom lanë, kanë pritë që m'i dhanë une atë [banesë]. Më kanë kritikë s'ma kanë harru kurrë, sepse shumica e ka... e kom marrë banesën në Beograd, edhe atë banesë në Beograd më kanë lutë, Stanbolliqi konkretisht më thojke, "Leje këtë banesë, mos bo ndrrim. Leje se djali të rritet e nashta vjen këtu me u shkollu, anej-knej. A ti po shkon atje për zavendës-drejtor, kanë banesa ata Elektro-ekonomia me ta dhanë një banesë."

Shumica e njerëzve që kanë qenë edhe shkojnë, kanë qenë edhe përpara edhe tash, anej-knej i kanë rujt edhe ato banesa këtu që i kanë pasë ose shtëpi, i kanë rujt edhe ato banesat që i kanë pasë në Beograd. Une e kom pasë në Beograd të Ri, a ma jepshin banesën në Topçider, kojshi me këtë Sekretarin. Une e kom pasë veç një djal edhe grun, e s'më ka lanë morali me bo ato. E kom ndrru banesën teme me një, Huzoroviqi u konë mjek këtu, se banojke ndër Mahmutin e s'e lejojshin gjithëkush me ardhë aty. E kom ndrru banesën e Beogradit me qetë banesë që e kom në Prishtinë. Para asaj të thashë që banesën që e kom pasë tani e kom dorëzu. Jom bo drejtor, zavendës-drejtor anej-knej, me qindra banesa me oborr me këto ju janë dhanë njerëzve jo fort kështu, inxhinierëve e këtu e kuadra, kom mujt për veti me dhanë qat' banesë dy dhomshe me marrë njo me oborr e me këto që shumica e kanë marrë e tash e gëzojnë. E gëzojnë fëmijët e tyne se fatkeqisht do kam shokë, më kanë vdekë shumë anej-knej.

Po mu ajo as s'më ka shku ndër mendm me marrë një banesë me oborr anej-knej e me dhanë këto. Kështu që një djalë e gruaja, boll e kom dy dhomshe anej-knej, edhe sot jom në qato. Një banesë dy dhomshe, domethanë dy dhoma janë edhe kuzhina me qito qysh po i thojnë sallon. Kurgjo s'kom prej pasunie, as një bicikletë, as bicikleta, a e dini çka o bicikleta? Ani bicikletë, as veturë, as bicikletë, as kurrfarë prone, pos qësaj banese të cilën e kom ble që e shitke shteti i atëhershëm ato. Qat banesë e kom... edhe grun e kom edhe banesën edhe kurgjo s'kom. Po du këtë me përcjellë pak këto, me ditë njerëzit që une, i cili qito vjet... gjithë këto vjet jom kanë në qasi funksione ku kom mujt veç me gisht në Dragodan me thanë, qetu maroma një shtëpi, ma kishin maru. Ose isha zavendës-drejtor, i dajsha banesat me marrë një banesë me oborre me krejt në dy katëshe, kurrë s'e kom bo. Kurrfarë dugoje s'kom, kurrfarë Fiqe<sup>16</sup> s'kom, s'kom as bicikletë.

E pak me kqyrë edhe ata, se nuk jena kanë edhe na krejt qashtu tash me u qitë në pleh. A dikush po bohet veç me një mandat, këtij deputetit po bohet me shtëpia, me miliona me këto. Une gjithë këto funksione i nditë, kom mujt secilën prej funksioneve me shfrytëzu me pasë barem një shtëpi. Se shumë punëtorë, jo udhëheqës, me qindra në Dragodan e knej janë të Elektro-ekonomisë të cilëve kanë marrë kredit edhe i cili edhe une si zavendës-drejtori i kom dhanë. Nuk po ankohna se jam i kënaqun, jom me ndërgjegje të pastër. Kurku, veç mundet me ma ngjitë edhe tash mundet veç me i cakat në derë me më të vetë diçka ose gabimisht. Ndërgjegjjen e kom të pastër krejt çka kom punu.

<sup>16</sup> Zastava 750 ishte një makinë supermini bërë nga prodhuesi serb i makinave Zavod Crvena Zastava në Kragujevc. Në botën shqipfolëse, Zastava 750 njihet gjerësisht me nofkën "Fiqa", që vjen nga personazhi kryesor i një komiku të botuar nga gazeta "Borba" gjatë viteve të para të prodhimit të makinës.



Kom punu me qëllim që mirë me bo edhe popullit e tonëve, e tash sigurisht s'ja kom qëllu gjithë se kom pasë edhe une gabime, si këto që e kom pasë për të cilën edhe e kom kry karrierën qysh s'duhet me kry. E tash hygjym njerëzve me u pasunu e me ba këto, a mundet tash dikush me ma bo qysh ma kanë ba? Me më lanë pa punë, me më lanë pa pension... nejtse pensioni, çfarë pensioni 255 euro... me fakultet. Falë edhe djalit po më ndihmon, falë edhe mirëkuptimit të grusë, une po jetoj një jetë shumë... modeste, se modest jam konë edhe kur jom konë në qato funksione. Shumë modest jam kanë, nuk pi as duhan, as raki, as qatëhere s'kom pi. E bojmë një jetë modeste, nuk po hjequ keq, nuk po ankohna. Kom boll, për mu e për grun. Mos me pasë e kom djalin të cilin më ndihmon edhe jom i kënaqun.

Po nuk jam i kënaqun me krejt qito sene që kanë ndodhë, me krejt këto ngecje që i kena. Sidomos në zhvillim, në ekonomi, në këto krejt që kanë ndodhë, me të cilat kanë pasë dorë, jo veç një grup njerëzish po shumë, shumë njerëz, të cilët janë pasunu, do janë pasunu, do janë këtu. Une jam njeri i cili flej rahat edhe me ndërgegje shumë jom në rregull. Me shëndet masi sot i bona 83 vjet... mirë jom, jo mirë po shumë mirë jom, e tash sa zgjatë le te zgjatë, dëshiroj që... Edhe djali parën here kur pat ardhë i pata thanë ma së paku 20 vjet këtu kurgjo s'mundet me u ba. Tash po thom që, une jom tash optimist, besoj që edhe pak disa vjet duhen totalisht të rinjët me marrë këtë në dorë.

Ju të rinjët që jeni shkollu, jeni të mençëm, kena rininë fantastike. Une mendoj që mundet Kosova shumë shpejtë edhe ekonomisht edhe kulturalisht edhe kjo me u forcu. Mirëpo, duhem që të mijtë edhe pak ndër rrmu... me shku bre vëlla si une qysh jom shku, une jam shku para kohe, ata kanë kohën me shku në pensione. Le t'i lirojnë rinisë, le të vjen rinia e re. Le t'i marrin në dorë edhe besoj që ju keni me, me rregullu Kosovën, me bo përnime shtet për... se jena të aftë, jeni të aftë, jeni të mençëm, edhe besoj edhe besoj që tash shumë shpejtë kanë me shku edhe që tash... edhe tash, edhe momentalisht ka probleme, mirëpo mendoj që për disa vjet kanë me u tejkalu.

**Anita Susuri:** Faleminderit shumë!

**Hysamedin Azemi:** Ju dëshiroj tana të mirat popullit, rinisë, për ta ishalla bohet ajo çka po... edhe une po kërkoj edhe çka meritojmë si popull.

**Anita Susuri:** Faleminderit edhe unë ju dëshiroj shëndet juve.

**Hysamedin Azemi:** Faleminderit! Faleminderit!